Aktualisht janë aplikuar 65 praktika për institucionet arsimore në qytet.Per 50 praktika kemi marrë konfirmimet nga ASHK dhe jemi duke plotësuar dokumentacionin për Këshill Bashkie dhe mandej për certifikim.

Ndërkohë kemi aplikuar edhe për objekte që i kanë kaluar Bashkisë Vlorë me VKM, si Institucioni i Rrugeve Rurale.

Ndërkohë do të vijojmë më pronat që përdoren për ushtrimin e funksioneve ne fushën e shëndetësisë.

3.Në sektorin e shpronësimeve

Spektori i shpronësimeve funksionon në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar dhe VKM-së nr.138, datë 23.03.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar. Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve harton dosjen me dokumentacionin e nevojshëm, për të paraqitur më tej kërkesën për shpronësim publik, pranë ASHSH Tiranë.

Problematikat siç janë bëtë me dije janë të mbartura, pasi nga drejtoria e Urbanistikës janë miratuar lejet e ndërtimit/infrastrukturore, të cilat janë tenderuar pa u përcjellë dosja për shpronësim pranë DPPMA, janë bërë investimet, madje një pjesë e projekteve janë marrë edhe në dorëzim.

Sot jemi para faktit që qytetarët kërkojnë likuidimin përkatës, ndërkohë që investimi është kryer pa VKM shpronësimi.

Kemi kërkuar konsulencë ligjore për këto problematika, në Drejtorinë Juridike të Bashkisë Vlorë, Agjencisë Shtetërore për Shpronësimim dhe Fondin Shqiptar të Zhvillimit.

Objektivi është që deri në datën 31.12.2024, të kemi përgatitur dosjet ligjore me kërkesat për shpronësim pranë ASHSH Tiranë dhe shpalljen e kërkesës për shpronësim për projektet:

- Kërkesë për shpronësim për shtesa të VKM-së nr.20 datë 24.01.2024 “Lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar” Vlorë
- Kërkesë për shpronësim për shtesa të VKM-së nr.414, datë 27.05.2020 “Për shpronësim për interes publik, të pronarëve të pasurive pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Menaxhim i integruar i mbetjeve të ngurta të rajonit të Vlorës”, Bashkia Vlorë.
- Krijimi i database për fillimin e punës për projektin “Lungomare 3” që fillon nga tuneli dhe përfundon në Orikum,
- Janë bërë urdhërat përkatës për fillimin e procedurës së shpronësimit për projektin “Leje rikonstruksioni të ndërtesës së dëmtuar , pa shtim apo ndryshim volumi për projektin përforcimi i pallatit 1300” Vlorë, bazuar në shkresën nr.871 prot datë 20.01.2025
- Janë bërë urdhërat përkatës për fillimin e procedurës së shpronësimit për projektin “Rigjenerim urban i bulevardit të Palmave dhe Agrumeve, përgjatë shkollës “Halim Xhelo” në drejtim të bulevardit “Ismail Qemali” Vlorë.

4.Sektori i plazheve

Në mbështetje të VKM 171 Datë 27.03.2019 si dhe Udhëzimeve të AKB “Mbi procesin administrativ ”Për menaxhimin e sezonit turistik për vitin 2025

Objektivi është:

- Eshtë përgatitur lista e plazheve dhe harta përfundimtare.
- Rakordimi i hartave Bashki - Ministri –Agjensi Kombëtare e Bregdetit
- Stacione plazhi për vitin 2024 janë 236, ne vlerë 60377310 lekë
- SPL 2024, janë miratuar kërkesat e paraqitura nga subjektit në vazhdimësi.

Drejtorja e Burimeve Njerëzore

Veprimtaria në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore bazohet në: Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligjin Nr.152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjin Nr. 9131, datë 8.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, Ligjin Nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e

informimit”, Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 138/2015, datë 17.12.2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Për periudhën **01.01.2024 – 31.12.2024** ju raportojmë:

Me VKB nr. 92, datë 24.11.2023 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të Deleguara – 2024” me ndryshime, është miratuar numri i punonjësve i cili është:

Në administratën e Bashkisë Vlorë – 406 pozicione, në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike - 396 pozicione, në Qendrën Kulturore - 28 pozicione, në Teatrin Petro Marko - 30 pozicione, në Klubin Shumësportësh “Flamurtari” - 18 pozicione, në Qendrën e Zhvillimit PAK - 22 pozicione, në Ndermarrjen Publike per Menaxhimin e Mbetjeve Urbane - 39 pozicione, në Qendrën e Shërbimeve me Baze Komunitare per Femijet me Aftesi te Kufizuara - 11 pozicione.

Pjesë e kësaj strukture janë edhe funksionet të transferuara në Bashkinë Vlorë pas Reformës Territoriale: Arsimi parashkollor / punonjësit jomësior (sistemi 9 vjeçar) - 355 punonjës, Arsimi i mesëm punonjes jomesior - 51 punonjes, Sektori Bordit të Kullimit - 17 punonjës, Sektori e Pyjeve dhe Kullotave - 6 punonjës, Sektori e Rrugëve rurale - 5 punonjës, Sektori i MNZSH - 50 punonjës.

Me VKB nr. 26, datë 28.03.2024 “Për një ndryshim në VKB nr. 92, datë 24.11.2023 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të Deleguara - 2024” janë bërë ndryshime me qëllim ristrukturimin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike.

Bazuar në nenin 64, pika j, të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, me vendim të Kryetarit të Bashkisë janë miratuar 3 Struktura për vitin 2024:

Vendim Nr. 1, datë 30.01.2024 i Kryetarit të Bashkisë Vlore “Për miratimin e Strukturës organizative të Bashkisë Vlorë, Institucioneve vartëse dhe funksioneve të deleguara – 2024”,

Vendimi Nr. 42, datë 18.04.2024 “Për disa ndryshime në Strukturën organizative të Bashkisë Vlorë, Institucioneve vartëse dhe funksioneve të deleguara – 2024”.

Vendimi Nr. 133, datë 09.09.2024 “Për disa ndryshime në Strukturën organizative të Bashkisë Vlorë, Institucioneve vartëse dhe funksioneve të deleguara – 2024”.

Me VKB nr. 101, datë 03.12.2024 “Për miratimin e nivelit të pagave të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të deleguara - 2025” është miratuar niveli i pagave të Bashkisë Vlorë për vitin 2025.

Me VKB nr. 102 datë 18.12.2024 “Për krijimin e Ndërmarrjes së Pastrimit dhe Ndërmarrjes së Gjelbërimit në vartësi të bashkisë Vlorë dhe për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara – 2025” është miratuar numri i punonjësve të Bashkisë Vlorë për vitin 2025 dhe krijimi i Ndërmarrjes së Pastrimit dhe Ndërmarrjes së Gjelbërimit.

Në këto struktura ka pozicione të Shërbimit Civil, ndihmës/mbështetës dhe funksionarë politik. Bazuar në ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil” për periudhën 01.01.2024 – 31.01.2024 janë shpallur 23 procedura konkurimi për pozicione të Shërbimit Civil të cilat kanë përfunduar me fitues dhe disa prej tyre janë . Në përfundim të procedurave janë kryer 24 emërimë si nëpunës civil me procedura konkurimi sipas Ligjit të Shërbimit Civil, prej të cilëve 16 emërimë në pozicione të kategorisë ekzekutive, 3 emërimë në pozicione të kategorisë së ulët drejtuese, 1 pozicion i kategorisë së mesme drejtuese dhe 2 emërimë në pozicione në nivelin e lartë drejtues.

Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile

Në zbatim të Ligjit Nr .152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2024, në Drejtorinë e MZSH-së Bashkia Vlorë, personeli i zjarrfikëses është mobilizuar për të përmbushur misionin e vet për mbrojtjen e jetës së njerëzve dhe pronës nga zjarri dhe fatkeqësitë e tjera natyrore.

Janë sensibilizuar qytetarët vazhdimisht me anë të mediave dhe shtypit të shkruar për rëndësinë që i jep shteti mbrojtjes së jetës dhe pronës, si dhe dëmet që mund të sillte zjarri duke pasur parasysh se Vlora është një zonë turistike dhe si e tillë kërkon një angazhim dhe kujdes më të madh.

Gjatë vitit 2024 është bërë një punë e mirë në forcimin e disiplinës në punë, të zbatimit të orarit të veprimeve gjatë shërbimit si dhe përgatitjes profesionale të personelit, kjo erdhi edhe si rezultat i përqendrimit të drejtorisë në një objekt të vetëm, prania çdo ditë pranë personelit zjarrfikës bëri të mundur rritjen e kërkesës së llogarisë për zbatimin sa më mirë të orarit të veprimeve si dhe të eliminimit në kohe të difekteve të konstatuara në mjetet zjarrfikëse.

Para fillimit të sezonit të verës, që përkon edhe me sezonin e zjarreve të shumta në sektorin e ndërhyrjes u bë riorganizimi i shërbimit, nxjerrja e urdhërave të gatishmërisë, mënyra e organizimit të gjithë personelit në rastet e situatave të pazakonta.

Rëndësi e veçantë i është dhënë mirëmbajtjes së mjeteve zjarrfikëse, riparimit të difekteve, mirëmbajtjes së teknikës dhe paisjeve zjarrfikëse si dhe mbajtjes pastër të ambienteve në stacionin e zjarrfikëses.

Me personelin operues është zbatuar me përpikmëri programi i përgatitjes profesionale dhe kryesisht janë punuar temat që kanë të bëjnë me zbatimin e disiplinës në punë dhe bazat e organizimit të punës për shuarjen e zjarreve në një kohë sa më të shkurtër.

Në zbatim të Ligjit Nr .152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” si dhe të urdhërave të ardhura nga Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së “Për Marrjen e Masave Përgatitore për Përballimin e Emergjencave verore të mundshme“, nisur edhe nga eksperiencat e viteve të kaluara, Drejtoria e MZSH-së Bashkia Vlorë, mori të gjitha masat e nevojshme për përballimin me sukses të situatave që mund të krijohen si rezultat i temperaturave të larta gjatë periudhës së verës.

Për ti paraprirë stinës së nxehtë u bë një punë e mirë për njohjen e zonave të quajtura të vështira dhe të rrezikshme për të ndërhyrë në rast zjarri, gjë e cila dha efektet e veta kur ndërhyrë për

shuarjen e zjarreve në këto zona, ku ndërhyrja ishte e shpejtë, e menjëhershme, me forca e mjete të mjaftueshme dhe dëmi ishte shumë herë më i vogël se sa në rastet e mëparshme.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024 nga Stacioni i zjarrfikses Vlorë janë bërë **1056** ndërhyrje operacionale nga këto **819** janë zjarre **237** ndërhyrje shpëtimi dhe emergjenca të tjera.

Ndërhyrjet kanë qenë si më poshtë: **708** zjarre në pyje dhe kullota, barishte, mbeturina, kablllo dhe gabina elektrike, **44** në banesa dhe në biznese, **237** ndërhyrje shpëtimi dhe emergjenca të tjera dhe **44** zjarre në automjete.

Numri i zjarreve me dëme në pyje, kullota dhe në ullinj ka qënë më i ulët se viti paraardhës , kjo erdhi si rezultat i marrjes së masave organizative të mira nga ana jonë dhe intensitetit të shirave në fillim të Shtatorit 2024.

Me gjithë punën parandaluese të bërë nga sektori i Inspektim-Parandalimit si dhe nga informimi i bërë me mediat për rrezikun që ka zjarri si edhe bashkpunimi i mirë me Policinë e Shtetit dhe me institucionet e tjera. Zjarret e këtij viti kanë qënë kryesisht në vendgrumbullimin e mbetjeve urbanë të qytetit te cilat kanë marrë dhe kohën më të madhe.

Kjo erdhi edhe si rezultat i punës së mirë të stacionit të zjarrfikëses ku me marrjen e sinjalit për zjarr bëhej vlerësimi i situatës, organizimi i punës me forcat dhe mjetet e duhura dhe ndërhyrja e menjëhershme dhe në kohën e duhur.

Në Bashkinë e Vlorës dëmet kanë qënë kryesisht në kullotë, pyje, ullishte e drurë frutorë.

Këtu mund të përmendim zjarre të rrezikshme dhe të përmasave të mëdha në Radhimë, Orikum, Qafe Llogarasë, Dukat-Fushë, Njesia Administrative Orikum,ullishtja e Nartës, ullishtja në Qafë Topit,fshati Kërkovë, Mali i Shashices i përsëritur disa here, njesia Administrative Qëndër, në fshatrat Poro,Bishan,Fitore njesia Adminisrtative Novosele, dhe në vendgrumbullimin e plehërave të Bashkise Vlorë si dhe zjarret e shumta që kanë rënë në territorin e Bashkisë Selenicë ku shërbimi zjarrfikës Bashkia Vlorë u ka shkuar për ndihmë në shumë raste,në ndihmë kemi shkuar gjithashtu në Bashkinë e Gjirokastrë dhe Delvinë.

Bashkëpunim të mirë kemi patur me Njësitë Administrative të Bashkisë si dhe me Administrimin e Zonave të Mbrojtura dhe Drejtorinë e Mjedisit për cdo zjarr të rënë.

Sektori i Inspektim-Parandalimit ka kryer kontrole të vazhdueshme për marrjen e masave parandaluese sidomos në pikat e tregëtimit të karburantit dhe të gazit të lëngshëm.

Janë bërë kontrole në shkolla, çerdhe, magazina të përpunimit të lëndëve drusore, rrobaqepësi e objekte të tjera që prodhojnë artikuj të ndryshëm.

Në prag të sezonit të verës rëndësi u është kushtuar kontroleve në të gjitha hotelet e zonës për paisjen e tyre me mjetet e mbrojtjes nga zjarri për të eliminuar ndonjë rast të mundshëm zjarri. Inspektorët e parandalimit kanë qënë prezent dhe kanë marrë pjesë në kqyrjen e ngjarjeve të djegies së pronës në bashkëpunim me Inspektorët e Drejtesisë së Policisë.

Bashkëpunimi me institucionet e tjera në përgjithësi ka qenë i mirë në të gjithë Bashkinë Vlorë. Kemi bashkëpunuar me shtabin e emergjencës të Bashkisë Vlorë, me shtabet e ngritura për përbullimin e situatave të përmbytjeve në Bashkinë Vlorë. Kemi bashkërenduar punën me Drejtorinë e Policisë për të gjitha rastet e zjarreve të rëna jo vetëm për shuarjen e zjarreve por

edhe për shpëtim, si dhe në veprimet e proceduriale për procedimin e personave të dyshuar për zjarrvënien sidomos në kullota.

Gjatë këtij sezoni parashikuam me detaje plan-vendosjen e mjeteve zjarrfikëse në vijën bregdetare dhe në mjediset me rrezik të shtuar dhe për rrjedhojë ju përgjigjëm në kohë çdo situatë dhe pasojat në zjarret e rëna ishin minimale.

Për çdo njoftim zjarri kemi shkuar menjëherë dhe kemi bërë veprimet në kohë.

Kujdes i vaçantë ju është kushtuar mirëmbajtjes së automjeteve zjarrfikëse dhe pajisjeve të tjera ndihmëse megjithëse ato janë mjete të vjetra nga mirëmbajtja dhe kujdesi i treguar të gjitha janë në gadishmëri .Sektori I Inspektim-Parandalimit gjatë gjithë vitit ka ushtruar aktivitetin e tij në të gjithë territorin që mbulon Bashkia jonë duke ushtruar kontrolle në të gjitha objektet që janë pjesë e punës tonë. Janë zhilluar kontrolle pothuajse në të gjitha objektet që paraqesin rrezik nga zjarri.

Parësore në kontrolle kanë qënë objektet me rrezik të shtuar. Pika të tregtimit me shumicë dhe pakicë të Hidrokarbureve (karburanteve), pikat e tregtimit të GLN-së (gazit të lëngshëm), objektet ku prodhohen dhe tregtohen bojra vaji, pikat e prodhimit dhe tregtimit të pajisjeve për mobilimin e objekteve dhe banesave me lëndë druri lehtësisht të djegshme, objektet didaktike (shkolla,kopshte,çerdhe), objektet akomoduese (hotele,motele,gabina plazhi), objekt i kontrolleve kanë qënë zyra ku ruhen dokumentacione si: Zyra e Regjistrimit të Pasurive, Arkivat dhe Kartotekat e institucioneve. Ky sektor më mirë duhet ta organizojë punën në kontrollet mbas përpilimit të akt-kontrolleve dhe afateve të lëna për plotësimin e mangësive të konstatuara, të ndjek afatet e lëna dhe në konstatimet e të metave të vendosin sanksione për çdo parregullsi në paisjen e objekteve me mjetet e domosdoshme për MKZ-në. Përsa u përket veprimeve të tjera të kryera këtë periudhë kjo zyrë ka qënë e ingranuar në çdo rast zjarri duke bërë kqyrjen në vendin e ngjarjes dhe veprimet e duhura proceduriale për rastet e zjarrit si dhe përcjelljes së materialeve Prokurorisë për ndjekje penale. Në të gjitha rastet e fillimit të procedimeve penale janë bërë Aktet e Ekspertimit dhe vërtetimet e zjarrit.

MASAT									
	Konstatime me procesverbal (denim me gjobë)	Gjopa me vendim	Blokime	Kallëzim penal	Akte Ekspertizë për zjarret e rëna	Çertifikatë e mbrojtjes nga zjarri	Ripërtëritje (Çertifikatë) e mbrojtjes nga zjarri.	Vërtetime zjarri	Miratim projekti për MZSH
JANAR	-	-	-	-	1	5	4	1	16
SHKURT	-	-	-	-	-	7	4	3	15
MARS	1	-	-	-	1	4	1	1	18
PRILL	3	-	-	-	1	12	2	2	16
MAJ	5	-	-	-	1	13	4	-	18
QERSHOR	3	-	-	-	1	4	5	-	12
KORRIK	4	-	-	-	1	6	5	2	13
GUSHT	7	-	-	-	-	5	1	4	7
SHTATOR	2	-	-	-	2	7	1	1	11
TETOR	-	-	-	-	30	1	1	1	16
NENTOR	-	-	-	-	3	14	1	-	13
DHJETOR	-	-	-	-	1	26	1	1	8
TOTAL	25	-	-	-	42	104	30	17	163

INSPEKTIVE

	Objekte, aktivitete Civile (banimi)	Objekte, aktivitete shërbimi (dyqane, Salla, magazine, etj.	Objekte, aktivitete akomdu ese turistike	Objekte, aktivitete didaktike (shkolla, kopshte, çerdhe)	Objekte ku ushtrohet aktivitet tregtimi me lëndë lehtësisht të djegshme	Objekte, aktivitete artizanale	Objekte historike, artistike të destinuara (muze, galeri, ekspozita)	Objekte, të destinuara për impjante sportive	Depozita gazi të fiksuara me kapacitet deri në 5m³	Depozita gazi të fiksuara me kapacitet mbi 5m³	Impjante për shpërndarjen e karburantëve	Objekte administrative
JANAR	1	22	4	1	-	-	-	-	1	-	2	-
SHKURT	-	21	3	-	-	-	-	-	1	1	4	2
MARS	1	9	7	-	-	-	-	-	-	-	13	1
PRILL	3	12	6	-	-	-	-	-	1	-	7	6
MAJ	2	4	20	-	-	-	-	-	1	-	8	1
QERSHOR	-	-	33	-	-	-	-	-	-	-	7	1
KORRIK	2	2	27	-	-	-	-	-	-	-	10	-
GUSHT	2	2	30	-	-	-	-	-	-	-	6	-
SHTATOR	2	1	14	-	-	-	-	-	2	2	2	1
TETOR	-	-	11	14	-	-	-	-	-	-	5	-
NENTOR	-	7	13	7	-	-	-	-	-	-	5	-
DHJETOR	1	-	26	13	-	-	-	-	-	-	5	-
TOTALI	14	80	194	35	-	-	-	-	6	3	74	12

Treguesit ekonomiko-financiare janë realizuar nga Drejtoria Menxhimit Financiar të Bashkisë

Vlorë, për të gjitha detyrimet që jepte ligji, për të gjithë personelin si pagat, sigurimet shoqërore e shëndetësore, orët suplementare etj.

Detyra për të ardhmen

- 1- Do të mundohemi të plotësojmë kushtet sa më mirë për personelin zjarrfikës.
- 2- Do të rristim më tepër kërkesën e llogarisë për disiplinën në punë dhe zbatimin sa më efikas të orarit të veprimeve gjatë 24 orëshit.
- 3- Do të zbatohet me përpikmëri programi i përgatitjes tekniko-profesionale ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme.
- 4- Duhet të bëhet kujdes me urdhërat që dalin nga të gjitha organet drejtuese të MZSH-së të cilat janë të mbështetura në ligjin 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.
- 5- Mjetet zjarrfikëse duhen të reja, pajisje për të luftuar me zjarrin, ndërtimi i Stacionit të ri të zjarrfikëses sipas kushteve, uniformë, status, paga sipas ligjit etj.
- 6- Paraqitja e jashtme, marrëdhëniet zjarrefikës-qytetar, komunikim i mirë, kulturor, qytetar dhe ligjor, njohja me zonat e rrezikshme, rrugët dhe mënyra për të ndërhyrë, mirëmbajtja e automjeteve zjarrfikëse, pajisjeve dhe ambienteve ku rrimë e punojmë etj.
- 7- Ne si forcë e specializuar e gatishmërisë të përhershme përveç ndërhyrjes në zjarre kemi si detyrë ndërhyrjen në raste emergjence si: përmytje dhe fatkeqësi të tjera natyrore (tërmete, rrëshqitje etj.)
- 8- Duke parë zhvillimin që ka Qarku i Vlorës dhe në vençanti Bashkia Vlorë si në sektorin e turizmit e industri, rritja e qyteteve si nga popullsia dhe nga ndërtimet shumëkatëshe, universitet, shkolla, portet dhe bizneset e shumta, duke parë edhe gati dyfishimin e popullsisë në sezonin e verës, mundësitë edhe rrishtin e rrethit të zjarrit janë më të shumta, ndaj edhe kushtet të diktojnë që edhe shërbimi zjarrfikës duhet të forcohet edhe më shumë si në shtimin e forcave njerëzore, por më tepër në domosdoshmërinë që shërbimi zjarrfikës të ketë dy automjete zjarrfikëse të sakta e të kohës dhe një autoshtetë bashkëkohore.

Rëndësinë dhe mbështetjen që i jep qeveria zhvillimit të turizmit në Qarkun e Vlorës kërkojnë edhe një shërbim zjarrfikës bashkohorë .

Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike

I-SEKTORI I STREHIMIT

Gjatë vitit 2024 nga sektori që mbulon çështjet e strehimit janë kryer të gjitha procedurat e përcaktuara për strehimin social në aktet ligjore në fuqi dhe në rregulloren e brendshme të bashkisë, mbi funksionet, përgjegjësitë dhe kompetencat e këtij sektori. Konkretisht, 1-Është përgatitur project-vendimi dhe është miratuar në Këshillin e Bashkisë me Vendimin Nr.6, datë 29.01.2024 “Për miratimin e listës emërore të familjeve dhe individëve, që përfitojnë banesë me kosto të ulët në apartamentet e ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave në lagjen”

Kushtrimi” tek ish-frigoriferi Vlorë”. Kopje të këtij vendimi i kemi përcjellë për vazhdimin e procedurave në kompetencë Entit Kombëtar të Banesave Drejtoria e Përgjithshme Tiranë dhe Drejtoria Rajonale Vlorë.

2-Është përgatitur project-vendimi dhe është miratuar në Këshillin e Bashkisë me Vendimin Nr.13, datë 26.02.2024 “Për miratimin e deklaratës për bashkëfinancim drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për “Programin e përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe ta pafavorizuara”

3-Është përgatitur project-vendimi, është paraqitur për miratim në Këshillin e Bashkisë dhe është miratuar me VKB Nr.14, datë 26.02.2024 “Për miratimin e listës emërore të familjeve përfituese për programin “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”

4-Është hartuar projekti teknik, dosja me dokumentacionin e plotë të aplikimit dhe janë paraqitur pranë MEK&I në afatin e përcaktuar.

5-Është hartuar project-vendimi dhe është paraqitur për tu miratuar në Këshillin e Bashkisë, me VKB Nr.12, datë 26.02.2024 “Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve, që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë dhe vlerat e subvencionit për çdo rast”. 16 familjet e para për vitin 2024, ku për hartimin e project-vendimit është plotësuar dhe shqyrtuar dokumentacioni i familjeve, verifikimi faktik në terren, është kaluar në komisionin e strehimit të bashkisë etj.

6-Është hartuar project-vendimi dhe është paraqitur për tu miratuar në Këshillin e Bashkisë, me VKB Nr.36, datë 30.04.2024 “Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve, që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë dhe vlerat e subvencionit për çdo rast”. 7 familje dhe individë, grupi i dytë. Është plotësuar dhe shqyrtuar dokumentacioni i familjeve, verifikimi faktik në terren, është kaluar në komisionin e strehimit të bashkisë etj.

7-Është përgatitur project-vendimi dhe është miratuar në Këshillin e Bashkisë me Vendimin Nr.37, datë 30.04.2024 “Për miratimin e privatizimit dhe të vlerës së privatizimit të banesave shtetërore të paprivatizuara”.

8-Është përgatitur projektvendimi dhe është miratuar në Këshillin e Bashkisë Vlorë me Vendimin Nr.59, datë 27.06.2024 “Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve, që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë dhe vlerat e subvencionit të qirasë për çdo rast”.

9-Është përgatitur projectvendimi dhe është miratuar në Këshillin e Bashkisë Vlorë me Vendimin Nr.68, datë 30.07.2024 “Për trajtimin me pagesat e qirasë sipas programeve për

strehimin social të znj.Rukije Shabani, për shkak se banesa e saj preket nga zbatimi I projektit “Lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar Vlorë”.

10-Është përgatitur projektvendimi dhe është miratuar në Këshillin e Bashkisë Vlorë me Vendimin Nr.88, datë 26.09.2024 “Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve, që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë dhe vlerat e subvencionit të qirasë për çdo rast”.

11-Është punuar sëbashku me rajonet administrative në qytet për mbledhjen e të dhënave për tregun e qirasë së banesave në qytetin e Vlorës gjatë këtij viti, në funksion të përgatitjes së projektvendimit për miratimin e qirasë mesatare në treg të lirë dhe subvencionit maksimal që përfitojnë familjet pa të ardhura.

12-Është përgatitur projektvendimi dhe është miratuar në Këshillin e Bashkisë Vlorë me Vendimin Nr.107, datë 18.12.2024 “Për miratimin vlerave maksimale të qirase ne treg te lire dhe te subvencionit maksimal te qirase qe perfitojne familjet pa te ardhura”.

13-Kemi evidentuar banesat, të cilat në bazë të kërkesave të qytetareve janë përfshirë në projektet e “Përmirësimit të kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”. Në bazë të urdhërit të Kryetarit të Bashkisë kemi dalë në cdo banesë, kemi informuar qytetarët për dokumentacionin e përcaktuar në aktet ligjore dhe kushtet e kriteret e përfitimit nga këto projekte.

14-Në bazë të vendimeve të marra nga mbledhjet e Komisoinit të Strehimit kemi përgatitur të gjithë dokumentacionin teknik dhe ligjor për të aplikuar pranë ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit brenda datës 31 janar 2025, afat I përcaktuar në shkresat e ministrisë.

15-Në bashkëpunim me rajonet dhe njësitë administrative bëjmë verifikimin në terren për të gjitha kërkesat e qytetarëve në lidhje me programet dhe projektet e strehimit

16-Çdo ditë bëhet pritja e qytetarëve për kërkesë-ankesat e ndryshme, kthim përgjigje kërkesave me shkrim, komunikimi shkresor dhe verbal me institucionet për problematika të ndryshme të strehimit, etj.

II - SEKTORI I TRANSPORTIT

Sektori i transportit zbaton me përpikmeri të gjitha dispozitat për nxjerrjen e liçencave dhe çertifikatave për transport rrethqytetes , qytetës ,taksi ,agjensi transporti dhe licencë tregtim karburanti.

Licensimi i subjekteve bëhet në bazë të Ligjit 8308 datë 18.08.1998 ”Për transportet rrugore” , i ndryshuar, VKM dhe udhëzimeve të MIE.

Gjatë vitit 2024 është bërë licensimi i të gjithë atyre subjekteve të cilët kanë paraqitur kërkesat për licensim.

1-Taksi 4+1 janë licensuar gjithsej 55 subjekte, nga këto 13 subjekte me afat 2 vjeçar dhe 42 subjekte me afat 5-vjeçar.

2-Çertifikata për transport mallrash për llogari të vet janë 91 subjekte, për transport mallrash për të tretë janë 33 subjekte, licence transporti mallrash për të tretë 1 copë, me afat 5-vjeçar.

3-Çertifikata mjetesh rrethqytetase 43 subjekte.

4-Agjensi transporti ndërkombëtar 2 subjekte.

5-Çertifikatë udhëtarësh për llogari të vet janë 12 subjekte.

6- Drejtoria DIIP pajis me licence tregtim karburanti subjektet të cilat tregtojnë karburant. Në vitin 2024 janë pajisur me licencë 5-vjecare 8 subjekte. Subjektet të cilat nuk u ka mbaruar afati i licensimit paraqiten në momentin e përfundimit të licences për tu pajisur me licencë. Ndërsa për subjektet që nuk janë të pajisura dhe nuk kanë shlyer detyrimin ndaj Bashkisë Vlorë si dhe detyrimet që ka lënë KLH janë bërë njoftimet përkatëse dhe i ka kaluar për trajtim sektorit të borxhit te Drejtoria e të Ardhurave Vendore.

7-Sherbimi i transportit urban në qytet kryhet nga subjekti “Urban Trans Vlora”. Në këtë shërbim i është kushtuar vëmendje e veçante rritjes së cilësisë së transportit urban duke u shërbyer sa më mirë komunitetit.

8-Taksa e parkimit është vjelë nga të gjithë subjektet në momentin që subjekti pajiset me lic+certif, dhe vlefata e taksës parkimit bëhet në bazë të VKB .

Të gjithë subjektet të cilat kërkojnë parkim para subjekteve të tyre paguajnë taksën e parkimit me pagesë, në bazë të një kontrate të lidhur me Bashkinë Vlorë me nje afat një vjeçar dhe pagesa sipas VkB, per vitin 2024 janë lidhur kontrata me 111 subjekte.

Për të bërë të mundur rritjen e të ardhurave nga transporti, Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike ka bashkepunuar me Drejtorine Tatim Taksave, dhe Policine Bashkiake, po megjithatë këtu ka vend për përmiresime që këto kontrole të jenë më të shpeshta.

Sektori i transportit ka një korespondencë të mirë me institucionet përkatëse si me DRSHTRR Vlorë, MIE dhe institucione të tjera.

Puna në lidhje me qytetaret pathuajse ka qënë e mirë, është gjetur një bashkepunim i mire me ta, duke mos patur probleme në këtë drejtim dhe duke bërë të mundur zgjidhjen e problemeve të tyre.

III- SEKTORI I INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Sektori i Infrastrukturës dhe Investimeve Publike përfshin dy sektor, atë të Infrastrukturës dhe Investimeve. Gjatë periudhës vjetore 2024 janë kontrolluar nga sektori i Investimeve projektet e dorëzuara nga Drejtoria e Urbanistikës, Projekt-buxheti i Bashkisë.

A. Janë hartuar proces-verbalet e argumentimit të kriterëve dhe përgatitur gjithë dokumentacioni që i është përcjellë njësisë së prokurimit për të vazhduar me

proçedurat e prokurimit. Konkretisht janë hartuar dokumentacionet për objektet si më poshtë:

1. Rikonstrukcion i rrugës së fshatit Radhimë
2. Rikonstrukcion i rrugës së fshatit Drithas
3. Rikonstrukcion i rrugës Petro Marko
4. Rikonstrukcion i rrugës Gani Bejkosala
5. Rikonstrukcion i rrugës Ded Gjon Luli
6. Rikonstrukcion i banesave të shtresave në nevojë
7. Rikonstrukcion i shkollës “Hasan Pulo”, “Jani Minga”, tualeteve të shkollave “Ismail Qemali”, “15 Tetori” dhe kopshtit 5, kopshtit Nr.14.
8. Rikonstrukcion i kopshtit Nr.10
9. Blloku i banesave në lagjen “Partizani”
10. Rikonstrukcion i rrugëve të fshatrave ; Rruga e varrezave në fshatin Cerkovinë, “Petro Llambro” Skrofotinë, rruga e shkollës në fshatin Babicë e Madhe.
11. Rikonstrukcion i rrugëve, “Rrga pas Bashkisë”, “Donika Kastrioti”, “Meno Gjoleka”, “Harun Panaja”, “Malo Beqari”, “Përbll shkollës Naim Frashëri”, “Shtjefen Gjeçovi”, “Haxhi Xhyheri” dhe “Rrjeti rrugor pranë Komisarariatit të Policisë”
12. Zyrë informacioni me një ndalesë “ONE STOP SHOP
13. Rikonstrukcion i rrugës Ish Fabrika e Çimentos
14. Barriera metalike mbrojtëse për këmbësorët përgjatë rrugës “Transbalkanike dhe Ali Demi”
15. Rruga te ish Pusi i Mezinit (rrugët Myslym Gjoleka, Ahmet Lepenica, Hysni Muka” në lagjen “Kushtimi “Vlorë.
16. “Mirëmbajtje Kanali Ujitës Tragjas- Radhimë dhe Vepra Arti”
17. Mirëmbajtje Dig ate Rezervuarët Bestrovë, Panaja, Bunavi”
18. Rehabilitim i kanalit Kallafet dhe Babicë
19. Mirëmbajtje vepra arti dhe saraçineskë të rezervuarit Bestrovë, Panaja, Kaninë.
20. Shtesë për pallatin 1300
21. Rikualifikim i hapësirave të gjelbërta të qytetit.
22. Rikonstrukcion i rrugës së 7 (shtatë) Pallateve.
23. Rikonstrukcion i kanalit Mifol
24. Rikonstrukcion i rrugëve “Zonja Çurre” dhe “Alhem Mehmeti”, fshati Tragjas.

B. Janë kontrolluar dhe është mbajtur korrepondenca me kontraktorët dhe supervizorët për objektet që janë në faze punimesh konkretisht:

1. Rikonstrukcion i shkollës 9-vjeçare “Avni Rustemi”.
2. Rikonstrukcion i rrugëve të brendshme të Njesisë Administrative Orikum.
3. F.vendosje ndriçimi në qytet
4. Ndriçim i rrugës “Rruga e Pishave-Zvërnec-Manastir’.

5. Rikonstruksion i Palestrës së qytetit Multifunksionale Flamurtari.

C. Janë kontrolluar dhe janë marrë në dorëzim sipas urdhërave të ngritur objektet.

1. Çertifikatë e marrjes në dorëzim përfundimtar objekti: “ Rikonstruksion i rrugës së Fshatit Kërkovë”.
2. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të përkohëshëm objekti: “ Furnizim Vendorsje, pajisjesh për ndriçimin rrugor”.
3. Çertifikatë e marrjes në dorëzim përfundimtar objekti: “ Rikualifikim urban në njësinë Administrative Qendër (Nartë + Sherishtë).
4. Çertifikatë e marrjes në dorëzim përfundimtar objekti: “ Punime për rikonstruksionin e kopshtit Nr.11, Vlorë, i bazuar në masat e efijencës së energjisë”.
5. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të përkohëshëm objekti: “ Rikonstruksion I rrugës së Fshatit Drithas”
6. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të përkohëshëm objekti: “ Rruga e Pishave-Zvërnec-Manastir”.
7. Çertifikatë e marrjes në dorëzim përfundimtar objekti: “ Ndërtim i Ujësjiellësit në rrugën Transballkanike, Vlorë”.

D. Është mbajtur korrespondenca me institucionet dhe popullin për problematika të ndryshme në lidhje me infrastrukturën dhe investimet.

E. Sektori i Infrastruktues dhe Investimeve ka ushtruar funksionet e veta dhe ne zbatim të kontratave të lidhura ka dorëzuar sheshet e ndërtimit kontraktoreve si dhe po kontrollon në mënyrë periodike punimet në objektet me poshte:

1-Dorëzim i sheshit për segmentin rrugor "Ded Gjon Luli"

2-Dorëzim i sheshit për segmentin rrugor "Gani Bejkosala"

3-Dorëzim sheshi për segmentin rrugor "Petro Marko"

4-Dorëzim i sheshit të rrugës Radhimë

5-Dorëzim i sheshit për investimin për përmirësimin e banevesave të shtresave në nevojë

6- Rikonstruksion i rrugës së fshatit Drithas

7- Rikonstruksion i shkollës “Hasan Pulo”, “ Jani Minga”, tualeteve të shkollave “ Ismail Qemali”, “ 15 Tetori” dhe kopshtit 5, kopshtit Nr.14.

8-Rikonstruksion dhe shtesë anësore 3 kate në shkollën 9-vjeçare “ Lef Sallata”.

9- Rikonstrukion i rrugës Ish Fabrika e Çimentos

10- Barriera metalike mbrojtëse për këmbësorët përgjatë rrugës “ Transbalkanike dhe Ali Demi”.

11- Shtesë për pallatin 1300

Gjatë kësaj periudhe është bërë verifikimi në terren , Korrik-Gusht për gjendjen e institucioneve arsimore të qytetit Vlorë dhe sipas problematikave të vecanta kemi qënë pjesë e grupit të punës për evidentimin e problematikave të konstruksioneve si shkolla 9-vjeçare Llakatundë, etj. pas verifikimit është hartuar raporti dhe i është përcjellë DU.

Gjatë kësaj periudhe, në zbatim të VKB, janë dhënë leje infrastrukturore OSSH dhe Ujësjiellës kanalizimeve sipas problematikave të ardhura në Bashkinë Vlorë.

Është mbajtur korrespondenca me institucionet.

Jemi pjesë e grupeve të punës për inventarizimin e pronave të Bashkisë Vlorë.

IV-SEKTORI I PASTRIMIT

Në Njesinë Administrative Orikum nga dt.03.07.2023 shërbimi i pastrimit, realizohet nga kompania “Silver”, e cila ka fituar tenderin 1-vjeçar për pastrimin e Njesisë Administrative Orikum me vlerë 23 651 889 (njëzetet e tre milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh, ose 28 382 266 (njëzet e tetë milion e treqind e tetëdhjetë e dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë me tvsh.

Nga ana e kompanisë realizohen keto shërbime:

1. Largim transport mbeturinash
2. Fshirje e rrugëve
3. Latje e rrugëve
4. Sistemim mbeturinash

Fshirja e rrugëve , trotuareve, shesheve dhe blloqeve të banimit kryhet 1 herë në 24 orë dhe 6 ditë javë, në një sipërfaqe prej 29 000 m² me punëtor me fshesë dhe 68400 m² me autofshesë. Zbrazen koshat e vegjël në shetitore dhe bulevard.

Çdo ditë hiqen 10 t mbetje urbane e shpërndara në 200 konteniere në rreth 120 pika grumbullimi. Mbeturinat hiqen 1 herë në 24 orë pas orës 22:00 në 7 ditë të javës. Gjatë sezonit turistik mbeturinat urbane në 50 pika në zonën turistike largohen dy herë në ditë, për të mos pasur konteniere të tejmbushur. Mbetjet e papranueshme (inerte, elektroshtepiake, krasitje kopshtesh etj) pranë konteniereve që evidentohen edhe nga Njësia Administrative, largohen nga kompania e pastrimit. Kontrata ka përfunduar në dt.03.07.2024, dhe ky shërbim po kryhet nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

Për periudhën deri më 3 korrik 2024 shërbimi i pastrimit është realizuar sipas kontratës dhe janë paraqitur çdo muaj situacionet e punës së kryer dhe akt kontrollit ditore të mbajtura nga supervizori.

V-SEKTORI I DEKORIT

Një shërbim që i ofrohet qytetarëve është dhe shërbimi i dekorit , me kontratën me objekt “Shërbimi i dekorit të qytetit “, i cili është realizuar nëpërmjet firmës “ **Endri Karaboja**” e kontraktuar nga Bashkia me afat 1(një) vjeçar dhe fond 2 986 900 (dy milion e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind) lekë pa TVSH,ose 2 986 900 (dy milion e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind) lekë me TVSH.

Ky shërbim është ofruar për qytetin e Vlorës dhe njësitë administrative që janë në varësi të Bashkisë Vlorë.

Shërbimi është ofruar për të gjitha festat të cilat janë të parashikuara në kontratë dhe për çdo rast tjetër të kërkuar nga Kryetari i Bashkisë (në rastin e 100 vjetorit të vdekjes së Avni Rustemit në dt.23.04.2024).

Shërbimi i dekorit për këtë kontratë është realizuar,duke paraqitur për çdo muaj situacionet mujore dhe akt-kontrollet të cilat janë mbajtur nga mbikqyrësi i shërbimit në prani dhe të administratorit të firmës kontraktore.

VI-SEKTORI I NDRIÇIMIT.

-Ndrichim i ri rruga “Ali Demi”, Lagjja “Partizani”, me llampa ekonomike, shtylla në të dy anët e rrugë, shtrim linje, pra investim total, gjithsej 60 shtylla me llampa Led.

- Rruga “Dush Strati”, Lagjja “Pavarësia”, zëvendësim i ndriçuesve 250 Ëatt me llampa inkandeshente, me ndriçues të rinjë Led, gjithsej 40 copë si dhe riparim të linjave të dëmtuara.

-Rruga “Jeronin De Rada”, Lagjja “28 Nëntori”, zëvendësim i ndriçuesve 250 Ëat me llampa inkandeshente, me ndriçues të rinjë Led, gjithsej 18 copë si dhe riparim të linjave të dëmtuara.

-Rruga “Fiqerete Musta”, Lagjja “28 Nëntori”, zëvendësim i ndriçuesve 250 Ëatt me llampa inkandeshente, me ndriçues të rinjë Led, gjithsej 13 copë si dhe riparim të linjave të dëmtuara dhe zëvendësimin e një shtylle të dëmtuar(të goditur).

-Rruga “Riza Salati”, Lagjja “Rilindja”, zëvendësim i ndriçuesve 250 Ëatt me llampa inkandeshente, me ndriçues të rinjë Led, gjithsej 17 copë si dhe riparim të linjave të dëmtuara dhe zëvendësimin e dy shtyllave të dëmtuara.

-Rruga “Andrea Varfi”, Lagjja “1 Maji”, zëvendësim i ndriçuesve 250 Ëatt me llampa inkandeshente, me ndriçues të rinjë Led, gjithsej 50 copë si dhe riparim të linjave të dëmtuara dhe zëvendësimin e tre shtyllave të dëmtuara.

-Rruga “Miss Durhan”, Lagjja “1 Maji”, zëvendësim i ndriçuesve 250 Ëatt me llampa inkandeshente, me ndriçues të rinjë Led, gjithsej 40 copë si dhe riparim të linjave të dëmtuara .

-Rruga “Gjergj Araniti”, Lagjja “Pavarësia”, zëvendësim i ndriçuesve 250 Ëatt me llampa inkandeshente, me ndriçuesa të rinjë Led, gjithsej 80 copë si dhe riparim të linjave të dëmtuara.

-Zëvendësim i ndriçuesve Led të dëmtuar në lagjen “Pavarësia”, ish-Kombinati, me ndriçues të rinjë Led, gjithsej 30 copë.

-Rruga “Hajredin Dervishi”, Lagjja “1 Maji” & Rruga ”Osman Haxhiu”, Lagjja “24 Maji”, zëvendësim i ndriçuesve 250 Ëatt me llampa inkandeshente, me ndriçuesa të rinjë Led, gjithsej 25 copë.

-Rruga “Gjon Boçari”, Lagjja “24 Maji”, zëvendësim i ndriçuesve Led të dëmtuar , me ndriçuesa të rinjë Led, gjithsej 40 copë si dhe riparim të linjave të dëmtuara.

-Investim kapital, llogaria ekonomike, 231, në rrugën “Pisha-Zvërnec-Manastir”, me vlerë 16.333.800 lekë, pa TVSH, që konstiston në infrastrukturë dhe vendosje të 300 shtyllave metalike me lartësi 8.8m e xinguar me krah 1m .

- Rruga kryesore në fshatin Nartë, Njësia Administrative Qendër, zëvendësim i ndriçuesve 250 Ëatt me llampa inkandeshente, me ndriçuesa të rinjë Led, gjithsej 70 copë.

-Vendosje e 35 ndriçuesish 250 Ëatt, llampë inkandeshente, rrugët e brendshme të fshatit Sherishtë, Njësia Administrative Qendër. Po në këtë qendër banimi, jemi në procesë pune për vendosjen e 12 shtyllave metalike (jo të reja, por në gjendje të mirë teknike, të hequra nga rruga “Pilo Begaj”, lagjia “28 Nëntori”).

-Vendosje të 50 ndriçuesve Led në Orikum, Njësia Administrative Orikum, si dhe vendosjen e ndriçuesve në fshatrat e kësaj Njësie sipas nevojës për zëvendësim, riparim.

-Zëvendësimin e 50 ndriçuesave 250 Ëatt me llampa inkandeshente, me ndriçuesa të rinjë Led, në Njësinë administrative Novoselë, rruga kryesore e fshatit Novoselë, aksi i ish-rrugës nacionale.

-Zëvendësimi i ndriçuesave Led të dëmtuar, në rrugët lidhëse që të nxjerrin në shëtitoren Lungomare, “Rushit Gorishova”, “Mehmet Agalliu”, “Reshat Osmani”, Lagjia: “Ujë i Ftohtë” , gjithsej 50 copë ndriçues Led.

-Investim kapital “Furnizim-Vendosje ndriçuesh në shëtitoren “Lungomare”, në proces prokurimi. Sapo të mbarojnë procedurat ligjore dhe të lidhet kontrata, fillojnë punimet.

-Zëvendësimi i 30 ndriçuesve në fshatin Risili.

-Montimi dhe çmontimi i dekorit për festat e fundvitit.

-Zëvendësim i 10 ndriçusave përball me spitalin Rajonal Vlorë.

Riparime të ndriçuesave 250 Ëatt-ësh, në qytetin e Vlorës, sipas raportimeve të qytetarëve, apo strukturave të Rajoneve.

Në kuadër të Efiçencës Energjitike, uljes së konsumit të energjisë elektrike, synimi ynë ka qënë vendosje e ndriçimit Led, me kosto më të lartë investimi fillestar, por me kosto mirëmbajtje dhe shfrytëzimi rreth 60% më të ulët se ndriçimi inkandeshent. Ky proces do të vazhdoje në rajone dhe njësi Administrative.

Policia Bashkiake

Me fillimin e vitit Policisë Bashkiake ju bë një riorganizim i ri duke krijuar tre sektor . Sektori i kontrollit të territorit , Sektori qarkullimit , Sektori i shërbimeve mbështetëse dhe administrimit të sistemit E-Gjoba.

Për mbarvajtjen e sezonit turistik kemi bërë propozimit konkrete Komisionit dhe drejtorive përkatëse si më posht.

- 1- Rishikimi i stacioneve të furgonave ,duke i larguar ata nga qëndra dhe rrugët me fluks të lartë levizje dhe duke i cuar në pikat hyrëse të qytetit . (Nuk është bërë)
- 2- Reduktimi i orareve të furnizimit të bizneseve nga furgonat gjat sezonit turistik (është bërë)
- 3- Vendosja e sinjalistikës rrugore sidomos në akset kryesore të qytetit cilindra plastike tabela (nuk është bërë)

• Për Plazhet

Në zbatim të Planit të masave të Bashkisë Vlorë , “Për kontrollin dhe monitorimin e hapësirave publike dhe private si stacion plazhi” Nr 4883. Prot datë 25.04.2023 , Urdhërit të Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë Nr 127 datë 25.04.2023 , “ Për kontrollin e hapësirave publike si Stacion Plazhi ”, Policia Bashkiake ka marr në monitorim të gjithë vijën bregdetare në territorin e Bashkisë Vlorë ,duke e ndarë atë në pesë sektorë dhe duke e mbuluar me kontrole të përditshme gjithë territorin.

Në zbatim të Urdhërit të Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë Nr 82 datë 04.04.2024 , “Për ngritjen e grupit të punës për manaxhimin e hapësirave publike për stacione plazhi dhe përgatitjen e plan-vendosjeve përkatëse për cdo parcelë” , në bashkëpunim me specialistët e Drejtorisë Aseteve është bërë matja në terren e sipërfaqes që do të shfrytëzohet si stacion plazhi. Ky proces nuk u realizua deri në fund për shkak të mungesës së vazhdueshme të topografeve .

Në zbatim të VKM Nr.1172 datë 24.12.2020 për disa ndryshime në VKM Nr.171 datë 27.03.2019, “ Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së

stacionit të plazhit” të ndryshuar Neni 14 pika 8 gërma a “Dorëzimi i hapësirës së plazhit bëhet, si më poshtë vijon”. a) Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës, topografi i njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore ndan me procesverbal në terren koordinatat e stacionit të plazhit dhe njofton Policinë Bashkiake për monitorimin e veprimtarisë.

Policisë Bashkiake i është dorëzuar një numër i vogël stacionesh plazhi . Për të parandaluar cdo ngjarje të jashtëzakonshme ,prej datës 17.06.2024 Policia Bashkiake filloi kontrollin në të gjithë stacionet e plazheve përgjatë gjithë vijës bregdetare nga Hidrovori Akërnri deri te Postoblloku në Pashaliman, ku u bë një kontroll të gjendjes fakt të kushteve të sigurisë në stacionet e plazhit . Nga kontrollet tona kemi konstatuar se një numër jo i vogël i stacioneve të plazheve nuk i plotësonte kushtet e sigurisë. Per kete shkelje sherbimet e Policisë Bashkiake kanë mbajtur Akt – Kontrollet përkatëse duke lënë detyrat dhe afatet për të plotësuar cdo mangësi. Për mospërmbushjen e këtyre kërkesave janë marr masat administrative sipas VKB Nr.76, date 30.09.2022 neni 9 pika 2 ne 15 raste .

Te gjitha hapsirat e parashikuara për plazh publik në gjithë vijën bregdetare janë mbajtur të lira përgjat gjithë sezonit turistik.

Vija bregdetare është ndarë ne pesë sektorë.

Spektori Hidrovor (Akërnri) ushtrojnë aktivitet 3 stacione plazhi.

Spektori Hundë Plakut (Zvërmec)- Plazhi i Vjetër ushtrojnë aktivitet 58 stacione plazhi .

Spektori Lungomare – Jonufër ushtrojnë aktivitet 67 stacione plazhi .

Spektori Jonufër - Moli Bacit (Radhimë) ushtrojnë aktivitet 58 stacione plazhi.

Spektori Moli Bacit – Postoblloku Pashalimanit ushtrojnë aktivitet 61 stacione plazhi.

Gjithsej, përgjatë vijës bregdetare në territorin e Bashkisë Vlorë janë duke ushtruar aktivitetin 245 stacione plazhi.

Janë konstatuar mungesa të kullave (pikave) të vrojtimit apo kompletimi i tyre, mungesa e vendosjes së tapave kufizues .

Falë kontrolleve te vazhdueshem te të gjithë subjektet stacion plazhi ka bërë që në vijën bregdetare të Bashkisë Vlorë të mos ketë asnjë ngjarje të jashtëzakonshme gjatë gjithë sezonit turistik (humbje jete) .

• Në fushën e mjedisit

Policia Bashkiake është e angazhuar me shërbim 24 orë për evidentimin e zjarreve të qëllimshme, apo në riaktivizimin e tyre në pikën e grumbullimit të mbetjeve urbane , ku dihet vështirësia pasi sipërfaqe e pikës së grumbullimit të mbetjeve është e madhe dhe parrethuar. Pothuajse përditë, konstatohet aktivizimi i shumë vatrave të zjarrit, ku është punuar nga të gjitha strukturat për fikjen e tyre . Ne tre rastet që ka agravuar zjarri është konstatuar mungesa e skrepistit.

Vëmendje të shtuar Policia Bashkiake sidomos përgjatë sezonit turistik ka pasur ndaj subjekteve apo individëve që hedhim mbetje jashtë koshave të mbetjeve urbane , duke u bërë një shqetësim i vazhdueshëm për komunitetin dhe shërbimet e pastrimit . Për këtë në zonat me prioritet turistik

ku dhe rrisi i këtij fenomeni është më i lartë kontrollat e shërbimeve të Policisë Bashkiake kanë qënë pothuajse përgjatë 24 orëve. Ndaj rasteve të konstatuar për subjekte dhe qytetarë të ndryshëm janë marrë 109 masa administrative.

Muzika e lartë sidomos nga bizneset që operojnë në zonën bregdetare është një nga prioritetet e Policisë Bashkiake përgjatë sezonit turistik. Kemi ndërhyrë me Drejtorinë e Buqesisë dhe Mjedisit për cdo ankesë të ardhur apo problematik të kostuar.

- **Hapësirat Publike**

Prioritet i punës tonë ka është kontrolli i territorit të Bashkisë sidomos shfrytëzimi i hapësirave publike. Në zbatim të urdhërit të Kryetarit të Bashkisë në periudhën Mars-Prill në bashkëpunim me inspektorët e DAV është bërë matja reale e sipërfaqes në terren. Janë bërë kontrole të përditshme vetëm ose në bashkëpunim me Inspektorët e DAV, ku për shkeljet e konstatuara kemi marrë masa administrative përkatëse në 25 raste. Për subjektet që nuk përmbushin detyrimet ligjore për shfrytëzimin e hapësirave publike apo dhënia e tyre cënon lëvizjen e këmbësoreve apo krijojnë problematika të ndryshme i kemi drejtuar DAV për moslidhje kontrate.

Lirimi hapësirave publike të zëna nga tregtarët ambulant, nga subjektet që operojnë në katet e para të pallateve apo ndërtesa në rrugët kryesore të qytetit dhe njësisve administrative etj ka qënë një detyrë e përditshme dhe është ndërhyrë në mbi 350 raste.

- **Qarkullimi**

Me integrimin e Policisë Bashkiake në sistemin E - Gjoha është zgjidhur përfundimisht problematika e hasur prej vitesh në këtë drejtim. Prej datës 20.02.2024 e në vazhdim gjokat e Policisë Bashkiake janë pjesë e këtij sistemi. Aktalisht, për këtë periudhë 20.02.2024-31.12.2024 janë maturuar 25999 masa për kundravajtje rrugore, si dhe janë marrë 35 masa administrative për sigurinë rrugore. Rezultatet në këtë drejtim janë të dukshme ku parkimet, qëndrimet e gabuara të mjeteve janë ulur ndjeshëm.

Menaxhimi trafikut pranë shkollave ka qënë një detyrë e përditshme e Policisë Bashkiake deri në përfundimin e vitit shkollor.

Një problematikë e pazgjidhur ende është për mjetet që parkohen në rrugët e qytetit për qëllime biznesi (makina që shiten apo jepen me qira), problematikë që kohët e fundit është shtuar shumë. Kodi Rrugor i RSH nuk parashikon masa administrative për raste të tilla, VKB e trajton si zënie të hapësirës publike. Për lirimin e kësaj hapësire duhet që të kemi një shërbim karroatreci dhe një pikë bllokimi të sigurtë për këto mjete. Për këtë i kemi drejtuar Drejtorisë Juridike, Ndërrmarjes së Shërbimeve Publike, Drejtorisë Financës dhe Buxhetit që brenda ambjenteve të NSHP të krijohet një pikë bllokimi e siguruar me rrethim dhe monitorim të vazhdueshëm (rreth 200 m/2), si dhe lidhja e një akt-marrveshje me një subjekt privat të

licencuar që ofron shërbim karroatreçi sipas nevojave të Policisë Bashkiake. Aktualisht, kjo çështje ende ska marrë zgjidhje .

Një pasqyrë e gjobave të Policisë Bashkiake

- 1 - Për periudhën 01.01.2024-31.12.2024 janë marrë në total 184 masa administrative , nga këto 70 gjoba janë arketuar pranë Qendrës Ekonomike . 113 i janë derguar DAV Vlore për ekzekutim , ku nga keto një gjobë është anuluar me vendim të Kryetarit të Bashkisë .
- 2 - Për periudhën 20.02.2024-31.12.2024 janë maturuar 25999 masa administrative per kundravajtjet rrugore nga këto janë arketuar 22044 masa me vlerë në total 16687449 lekë (përfshir kamatë vonesa) .

- **Te ndryshme**

Janë zgjidhur në kohë të gjitha ankesat e ardhura nga qytetarët , Policia e Shtetit si dhe Platforma e Bashkëqeverisjes në rreth 900 raste .

Është ndërhyrë si strukturë apo në mbeshtetje të IMT, njësi administrative e rajoneve për parandalimin e ndërtimeve pa leje apo prishjen e tyre në 50 raste.

Është mbuluar me shërbim Tregu në Novoselë cdo ditë të enjte .

Është bërë sigurimi i mbarëvajtjes së aktiviteteve të ndryshme social kulturore që ka organizuar Bashkia Vlorë përgjatë kësaj periudhë në jo më pak se 400 raste sidomos të aktivitetet në kuadër të “ Vlorë Qyteti European i Sportit” dhe ato te sezonit turistik.

Është bërë siguria e aktiviteteve sportive që Klubi Sportiv “ FLAMURTARI ” dhe “ORIKU” kanë zhvilluar sipas kalendarit sportive të tyre.

Policia Bashkiake është angazhuar në krijimin e kushteve optimale për punën që kryejnë firmat zbatuese të projekteve të shumta që kryhen në qytet. Gjithashtu kemi bashkëpunuar cdo ditë me drejtoritë e Bashkisë UK , NSHP , DIP, sipas kërkesës së tyre duke ndërhyrë në largime mjetesesh që bëhen pengesë për punime dhe bllokime segmentesh rrugore në vartësi të proceseve të punimeve.

Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit

Në zbatim të ligjeve organike dhe Rregullores se Brëndshme, IMT Bashkia Vlorë ka kryer detyrat funksionale të saj në kontrollin e Territorit, dhe marrjen e masave për ndërtimet pa leje.

Për periudhën dymbëdhjetë mujore Janar –Dhjetor 2024 ju informojmë si më poshtë:

Janë konstatuar 199 kundërvajtje të cilat janë shoqëruar me procedurat ligjore

Vendime për dënim me gjobë 132

Vendime për prishjen e objektit 165

Kallëzime Penale 80

Janë marrë Vendimet për prishjen e objekteve në zbatim të VKM “Për shpronësim për interes publik që preken nga gjurma e Projektit “Lidhja e Rrugës Transballkanike me Portin Detar” Vlorë” (37 vendime),është kryer gjithë procedura ligjore e njoftimit të qytetarëve për këto vendime shoqëruar me kërkesën për shpallje pranë Drejtorisë së Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun si dhe Rajonit Nr.4 Jemi ne pritje te kryerjes së procedurave te shpronësimit te disa objekteve qe pengojne vijimin e zbatimit të këtij projekti

Eshtë mbajtur korrespondenca (kthim përgj dhe kërkesë për informacion) me Instucionet e tjera për bashkëpunim dhe koordinim të punës dhe konkretisht :

Për Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë 105 shkresa (kthim përgjigje dhe dërgim të dhënash)

Për Inspektoriatin Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit 60 shkresa (kthim përgjigje dhe kërkesa për bashkëpunim)

Për qytetarët 380 shkresa (përgjigje të ankesave, njoftimet për aktet administrative) Për Institucione të tjera 53 shkresa (kerkesa dhe dhenie informacioni)

Është mbajtur korrespondenca me Gjykatën e Shkallës së Parë Vlorë dhe atë Administrative Lushnje 75 shkresa (parashtrime, ankimime)

Ndjekje të Proceseve Gjyqësore (80 procese)

Janë dërguar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje 190 kërkesa për kthimin ne Urdhëra Egzekutive te Vendimeve të Gjobave te pa arkëtuara.

Janë ekzekutuar disa objekte të ndërtuara prej kohësh (kryesisht garazhe) të cilat kanë zënë hapësirat publike si dhe ekzekutimet e vendimeve të prishjes për zbatimin e projektit “Rruga lidhëse e transballkanikes me portin detar Vlorë”.

Inspektoriati I Mbrojtjes së Territorit Bashkia Vlorë ka monitoruar vazhdimisht territorin e saj duke konstatuar dhe parandaluar kundërvajtjet e kryera nga qytetarë dhe subjekte.

Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve

Në përgjigje të shkresës juaj nr.635 prot. datë 15.01.2025 “Mbi analizën e punës për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024 “ ju dërgojmë informacionin si më poshtë vijon :

Ndërmarrja Publike Bashkiake për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane gjatë vitit 2024 ka pasur në fokus

- përgatitjen e komponentëve të Planit të Biznesit të MIM Vlorë për vënien në funksionim të impianteve dhe aktivitetëve rajonale;
- ndërtimin e strukturave në qendrën rajonale të menaxhimit të mbetjeve në Sherishtë;
- organizimin e marrjes në dorëzim të pajisjeve dhe mjeteve të reja në kuadër të programit *Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve të Ngurta në Vlorë, Shqipëri*;
- mirëmbajtjen preventive të infrastrukturës, pajisjeve dhe mjeteve të vendosura në Landfillin e Sherishtës;
- zhvillimin e kapaciteteve të stafit;
- rritjen e ndërgjegjësimit të publikut.

1. Raportimi financiar

Me VKB nr. 92 datë 24.11.2023 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara – 2024” dhe me Vendimin nr. 1 datë 30.01.2024 “ Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Vlorë ,institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara – 2024” për Ndërmarrjen Bashkiake për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane janë miratuar 39 punonjës.

Për të përmbushur funksionet e ndërmarrjes MIM Vlorë në administrimin e vend depozitimit sanitar dhe impiantit të rikuperimit të materialeve, aktualisht janë rekrutuar 17 punonjës për disa pozicione, në përputhje me aktivitetet e parashikuara në fazën e parë të funksionimit, duke paraprirë aktivitetet gjatë periudhës së vënies në punë, testimit, dorëzimit/marrjes dhe fillimit të operimeve në landfill.

Ndërmarrja Publike Bashkiake për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane për vitin 2024 ka kryer transaksione financiare sipas tabelës së mëposhtme:

Grupi	Titulli	Kapitu	Llog.	Plan	Fakt	Mbetje
0	5100	1	600	12,000,000.00	11,470,369.00	529,631.00
0	5100	1	601	3,000,000.00	2,112,558.00	887,442.00
0	1710	1	651	1,320,000.00	795,797.52	524,202.48
0	1710	1	166	9,000,000.00	9,000,000.00	0.00
0	5100	5	600	5,500,000.00	2,366,273.00	3,133,727.00
0	5100	5	601	570,000.00	197,638.00	372,362.00
0	5100	5	602	15,500,000.00	15,208,749.33	291,250.67
0	1710	5	651	0.00	0.00	0.00
0	1710	5	166	4,704,000.00	2,551,330.00	2,152,670.00
0	5100	5	231	392,000.00	196,239.00	195,761.00
Shuma				51,986,000.00	43,898,953.85	8,087,046.15

Ecuria e punimeve në Qendrën Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve në Sherishtë

Ndërtimi i landfillit sanitar ka përfunduar 95% të punimeve ndërtimore të ndara sipas lot-eve si më poshtë:

LOT 1

- Qeliza 1 – Kanë përfunduar punimet e dherave në të gjithë qelizën 1. Kanë përfunduar shtrimi i shtresave të izolimit në skarpat dhe bazamet, shtresat që përbëhen nga Geo Sintetic Clay, HDPE, dhe Gjeotekstil. Ka përfunduar shtrimi i tubove të gazit në të gjithë perimetrin e qelizës. Ka përfunduar puna për mbushjen me material drenazhi (50 cm zhavorr lumi i larë). Ka përfunduar mbushja e qelizës 1.1 dhe qelizës 1.2. Ka përfunduar shtrimi i tubove HDPE PN 16 DN 355 që shërbejnë për mbledhjen e leksiviatave. Rrethimi i të gjithë objektit ka përfunduar.
- Qeliza 2 – Kanë përfunduar punimet e dherave në të gjithë qelizën 2. Ka përfunduar dhe shtrimi i shtresave izoluese. Ka përfunduar shtrimi i tubove të gazit në të gjithë perimetrin e qelizës. Ka përfunduar shtrimi i tubove HDPE PN 16 DN 355 që shërbejnë për mbledhjen e leksiviatave.
- Leachate storage pond (LTP) – Kanë përfunduar punimet e dherave dhe shtrimi i shtresave të izolimit. Ka përfunduar dhe mbushjen e sheshit me cakull. Është dorëzuar në kantier fabrika e trajtimit të leksiviatave. Kanë përfunduar lidhjet hidraulike të rrjetit të qarkullimit të ujit të ndotur në impiant. Kanë përfunduar lidhjet elektrike të impiantit të trajtimit të ujit. Është bërë testimi i lidhjeve elektrike. Është punuar për testimin dhe kalibrimin e pjesës hidraulike dhe mekanike të impiantit LTP.
- Ndërtesa e Administratës – Kanë përfunduar punimet e betonit, elektrike, anti zjarri, kanalizimet dhe muratura. Kanë përfunduar linjat e brendëshme hidraulike dhe elektrike. Ka përfunduar instalimi i sistemit kapot dhe grafiato, aktualisht mungon lysterja, dyert dhe dritaret e objektit. Ka përfunduar shtrimi i trotuarëve me pllaka përreth godinës së administratës.
- Ndërtesa e Oficinës (workshop) - Kanë përfunduar punimet e betonit, elektrike, anti zjarri, kanalizimet dhe muratura. Kanë përfunduar linjat e brendëshme hidraulike dhe elektrike. Ka përfunduar instalimi i sistemit kapot, janë vendosur qepenat dhe aktualisht mungon vetëm grafiato, lysterja dhe dyert e dritaret e objektit.
- Ndërtesa e parkimit (Canopy Hangar) – Kanë përfunduar të gjitha punimet.

- Sheshi administratës dhe MRF – Kanë përfunduar të gjitha punimet e dherave. Kanë përfunduar shtrimi i linjave nëntokësore si elektrike, IT, sistemi i kamerave, ujësjellësi, sistemi kundra zjarrit, kanalizimet. Ka përfunduar testimi i linjave të ujësjellësit, sistemit kundra zjarrit dhe sistemit të vaditjes, dhe po punohet me testimin e linjave kanalizimeve. Ka përfunduar shtrimi i sheshit me asfalt.
- Rruga e aksesit – Kanë përfunduar të gjitha punimet e dherave dhe të strukturave mbajtëse (muret). Kanë përfunduar betonimet e kanaleve anësore dhe vendosja e shtyllave elektrike nga Sherishta deri në landfill. Ka përfunduar shtrimi i rrugës me asfalt.

LOT 2

- Ndërtesa MRF – Kanë përfunduar punimet e dherave dhe të betonit. Kanë përfunduar të gjitha punimet metalike. Ka përfunduar shtrimi i linjave elektrike, IT, kundra zjarrit, kanalizimeve etj. në brendësi të sheshit të MRF. Ka përfunduar shtrimi i sheshit me beton të armuar dhe rifiniturat përkatëse.
- Kanë ardhur dhe montuar në kantier në masën 95% makineritë e MRF.

LOT 3

- Janë porositur makineritë e parashikuara sipas kontratës për LOT 3 nga të cilat ka ardhur në kantier kompaktori, buldozeri, skrepi CAT dhe priten ardhja e të gjitha makinerive të mbetura.
- MIM Vlorë ka bashkëpunuar ngushtë me Kryetarin e Bashkisë për llogaritjen dhe argumentimin fondit të nevojshëm, për shlyerjen e detyrimeve doganore dhe detyrimeve të tjera financiare, për makineritë dhe pajisjet me të cilat duhet të furnizohet Bashkia Vlorë dhe për përgatitjen dokumentacionit të nevojshëm për këtë qëllim gjë që është finalizuar me sigurimin në muajin nëntor, të financimit në vlerën 37.000.000 lekë nga fondi rezervë i Ministrisë së Financave.
- MIM Vlorë ka përgatitur dokumentacionin ligjor dhe financiar dhe relacionin përkatës për prezantimin përpara Këshillit Bashkiak të Projektvendimit “ Për një ndryshim në VKB nr.100, datë 29.12.2023 " Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë për vitin 2024" në lidhje me pagesën e detyrimeve doganore dhe detyrimeve të tjera financiare, për makineritë dhe pajisjet e destinura për Bashkinë Vlorë dhe fondi i pakushtëzuar vënë në dispozicion për këtë qëllim nga Ministria e Financave" pas miratimit të të cilit , u mundësua shlyerja e detyrimeve doganore dhe detyrimeve të tjera financiare të prapambetura.

- Në bashkëpunim me KfW dhe me Konsulentin teknik , është punuar për përgatitjen e projekteve për pjesën e mbetur të punimeve të ndërtimit , e cila i hap rrugë procedurave te prokurimit për realizimin e këtyre punimeve.

2. Monitorimi i mbetjeve

MIM Vlorë ka përpiluar qasjen konceptuale të monitorimit të mbetjeve referuar kërkesave ligjore për monitorim dhe raportim (Ligji për Mbetjet, VKM-të, Rregulloret specifike). Cikli i monitorimit vlerëson performancën dhe ndikimin mjedisor.

Monitorimi i parametrave do të realizohet nga një program kompjuterik, i cili do të shërbejë edhe për planifikimin e burimeve të ndërmarrjes, për menaxhimin e të dhënave sasiore dhe financiare në sistem. Ka përfunduar vendosja, testimi dhe kalibrimi i peshores në landfill. Peshorja do të shërbejë për të matur sasinë e mbetjeve që gjenerohen nga rajoni Vlora-Veri, sasinë e mbetjeve që riciklohen dhe sasinë e mbetjeve që depozitohen në landfill.

3. Riciklimi dhe kompostimi

Ndërmarrja MIM Vlorë është përfshirë në aktivitetet e planifikimit për skemën pilot të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve me kontenierë depo në rajonin nr. 3 të qytetit të Vlorës, të drejtuar nga ekspertët e Konsulentit Institucional. Në fazën e parë të testimit është propozuar të instalohen 10 stacione me 3 kontenierë depo për lloje të ndryshme materialesh (kanaçe, shishe, kartona, ambalazhe). MIM Vlorë ka ndërmarrë aktivitetet e para të ndërgjegjësimit mjedisor me disa shkolla në qytetin e Vlorës.

Në funksion të studimit të tregut për materialet e riciklueshme janë vendosur kontakte me disa kompani riciklimi në Tiranë për të parë interesin dhe potencialin për bashkëpunim kur të fillojë puna në impiantin e ndarjes së materialeve.

Ka përfunduar plani mbi pikat e vendosjes së kontenierëve për mbetjet e riciklueshme në Rajonin Numër 3. Kontenierët për mbetjet e riciklueshme kanë ardhur dhe po punohet për shpërndarjen e tyre në qytet.

4. Mirëmbajtje e infrastrukturës , linjave dhe mjeteve teknologjike në landfill

Mirëmbajtja preventive e cila zhvillohet në landfillin e Sherishtës është një proces i rëndësishëm për të siguruar që pajisjet dhe sistemet të funksionojnë në mënyrë optimale dhe të shmangen defektet e papritura. Kjo përfshin inspektime të rregullta, pastrime, lubrifikime.

Proceset e mirëmbajtjes në landfillin e Sherishtës kryhen në baza ditore dhe përfshijnë një spektër të gjerë aktivitetesh teknike. Këto aktivitete përfshijnë mirëmbajtjen dhe pastrimin e kanaleve të drenazhimit të ujit të shiut nga aluvionet e grumbulluara, si dhe kryerjen e ndërhyrjeve të nevojshme riparuese në zonat e dëmtuara. Gjithashtu, përfshihet pastrimi nga vegjetacioni dhe mirëmbajtja dhe kontrolli i saraçineskave dhe komponentëve të tjerë të sistemit të largimit të ujërave sipërfaqësorë për tu siguruar që janë në gjendje funksionale optimale.

Mirëmbajtja e pajisjeve dhe mjeteve përfshin kontrole të rregullta për identifikimin e dëmtimeve, testimin dhe vendosjen në punë me parametra minimale operative, për të shmangur avaritë dhe për të siguruar gatishmërinë e tyre të vazhdueshme për qenë operacionale në momentin e fillimit të aktivitetit në landfill.

Vëmendje e veçantë i kushtohet kontrollit dhe shërbimeve ndaj mjeteve teknologjike që ndërmarja administron, gjendja teknike e të cilave për specifikat që kanë si mjete , kërkon monitorim të vazhdueshëm deri në vënien në punë me kapacitet të plotë sipas funksionit që kryejnë.

5. Masa paraprake për garantimin e sigurisë dhe shëndetit në punë për personelin e MIM

Përveç aktiviteteve të mirëmbajtjes së infrastrukturës , mjeteve dhe linjave teknologjike , të sistemeve të ndryshme të instaluar në impiant, është punuar në drejtim të sigurimit të kushteve optimale të punës për personelin që do të punojë në impiant, për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, konform kërkesave të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, Ligjit “ Për sigurinë dhe shëndetin në punë ” dhe akteve të tjera ligjore në fuqi.

Ne kemi tashmë, të përcaktuar një set të plotë të pajimeve të mbrojtjes personale, me karakteristika teknike rigoroze konform standarteve ndërkombetare ISO dhe EN dhe atij shqiptar SSH, i cili do t’i garantojë përdoruesve mbrojtje të shëndetit dhe siguri në punë.

Përveç kesaj kemi të konsultuar me specialiste të fushës dhe të përfunduar skemën e mbulimit me shërbimin 3D të infrastrukturës dhe objekteve në impiant, e cila do t’i garantojë personelit përveç kushteve të punës dhe një ambient të mbrojtur.

Gjatë kësaj periudhe MIM Vlora , ka realizuar dhe prokurime në vlerën **2.083.283 lekë** të disa shërbimeve dhe furnizimeve bazike për mundësimin e aktivitetit të saj, duke u kufizuar në shërbime që garantojnë sigurinë e impiantit, dhe në furnizime me materiale të nevojshme për aktivitetin administrativ dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës , linjave teknologjike dhe automjeteve në administrim.

6. Rritja e ndërgjegjësimit dhe marrëdhëniet me publikun

Ndërgjegjësimi dhe ndryshimi i sjelljes në raport me mbetjet urbane, është një sfidë por dhe një mision që ka marrë përsipër Ndërmarrja Publike Bashkiake për Menaxhimin e Mbetjeve Vlorë, nëpërmjet sensibilizimit të nxënësve të arsimit parauniversitar dhe fëmijëve të kopshteve të qytetit të Vlorës.

Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar disa aktivitete ndërgjegjësuese me miratimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) në zonën e projektit pilot në Rajonin nr 3, ku ndodhen shkollat dhe kopshtet e mëposhtme :

- Shkolla Artistike “Naim Frashëri”
- Shkolla 9 vjeçare “Lef Sallata”
- Shkolla 9 vjeçare “Ismail Qemali”
- Shkolla 9 vjeçare “Teli Ndini”

- Shkolla 9 vjeçare “Muco Delo”
- Kopshti “1 Maji”
- Kopshti “ nr 10”
- Kopshti “nr 8”
- Kopshti “nr 11”
- Kopshti “nr 5”
- Aktivitet në Kampin Veror me Qendrën e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën e Familjen.

Temat dhe informacionet të cilat janë trajtuar me nxënësit :

Prezantimi i Ndërmarrjes Publike Bashkiake për Menaxhimin e Mbetjeve, qëllimi dhe objektivat e saj

Informimi për zonat në të cilat do të vendosen koshat për ndarjen e mbetjeve të diferencuara

Informimi i nxënësve mbi mënyrën e trajtimit të mbetjeve

Shfaqja e materialeve edukative dhe informuese për ndarjen e mbetjeve në burim

Shpërndarja e fletëpalosjeve me informacione mbi riciklimin

Krijimin e materialeve të reja me produkte të riciklueshme

Fushatat sensibilizuese, aktivitetet me nxënësit dhe informacionet që janë përcjellë audiencës për grumbullimin e veçantë të lëndëve të riciklueshme publikohen edhe në faqet e rrjeteve sociale instagram e facebook.

Me fillim e vitit shkollor këto aktivitete do zhvillohen më tej, duke përfshirë të gjitha shkollat dhe kopshtet e tjera të Bashkisë Vlorë, qendrat sportive,etj.

Do të vazhdojnë fushatat sensibilizuese nëpërmjet shpërndarjes të fletëpalosjeve tek banorët, bizneset, me objektivin për të krijuar gradualisht bindjen që Vlora duhet të jetë jo vetëm një qytet i bukur turistik por edhe një qytet i pastër banorë e të cilit kujdesen dhe për mjedisin.

Shërbime publike vendore

Pastrimi i kanaleve kulluese dhe ujitëse

Gjatë vitit 2021 nga janari deri në dhjetor të këtij viti janë parashikuar këto volume pastrimi të kanaleve kulluese dhe ujitëse nga sektori i Bordit të Kullimit me mjete të renda eskavator nga vetë ndërmarrja.

Duke u mbështetur me planifikimin vitit 2021, pastrimet me mjetet eskavator nga vetë ndërmarrja me 2 Volvo dhe 1 Fiat-Hitachi krahegjatë është planifikuar:

1) Pastrim i kanaleve kulluese të I dhe kanale kryesore ujitëse	km	6	m ³	18,000
2) Pastrim i kanaleve kulluese të II dhe të III	km	119	m ³	191,500
3) Të tjera kanale	<u>km</u>	<u>11</u>	<u>m³</u>	<u>22,000</u>
Gjithsej	km	136	m ³	231,000

Realizimi gjatë kësaj periudhe janë në këto shifra gjithsej 74.43 km dhe 132,555 m³.

Realizimi në përqindje km kanal është: 55 %.

Në m³ është: 57,4%.

Volumet e kryera janë në:

Njësitë Administrative Novoselë 34.03 km me një volum 72,534 m³.

Nj.A. Qendër janë 11 km me një volum 21,905 m³.

Nj.A. Shushicë janë 12.92 km me një volum 6,650 m³.

Nj. A. Orikum janë 10.1 km kanal me një volum 11,388 m³.

Qyteti janë 6.38 km kanal me një volum 16,318 m³

Të tjera volume 3,760 m³ që janë kryer në dispozicion të pastrimit të vaskës së hidrovorit dhe kanalit kryesor që derdhen në det si dhe kanali para hidrovorit.

Mos realizimi vjen nga difektet që kanë shfaqur mjetet dhe nga temperaturat shumë të larta të kësaj vere.

Në vazhdimësi mjetet kanë qenë në gatishmëri të plotë.

1 eskavator Volvo ka qenë në shërbim të Sh.A. Ujësjellës Kanalizime Vlorë që nga fillimi i muajit shtator duke realizuar pastrimin 3.9 km kanal i II kullues me një volum 7800m³. 1 eskavator Fiat-Hitachi në pastrimin e kanalit KUZ Qytet-Hidrovor me gjatësi 1.81km dhe një volum 5225 m³, si dhe kanal in Hidrovor-Det me një gjatësi 0.67km dhe volum 3293 m³

Problematike është zona e ultësirës së Vlorës në pastrimin e kanaleve që vijnë nga Narta në Hidrovor edhe kanale të tjera të tokave të ulëta Panaja, Oshtimë, Bestrovë.

Është bërë një ndërhyrje emergjente më kërkesë të Njësisë Administrative Novoselë, dhe Urdhër të Kryetarit të Bashkisë për ngritjen e argjinaturës Mifol-Novoselë në kanal in ujitës nr.1 në buzë të lumit Vjosë me një volum rreth 10000m³ dhe gjatësi 1.8km me shkallë vështirësie të lartë (2 hedhje).

Gjatë periudhës së përmbytjeve nga dalja e lumit Vjosë në dhjetor gatishmëria e mjeteve ka qenë e lartë. Të tre mjetet kanë qenë në zonën e Novoselës ku dallohet për punë të palodhur në këto ditë eskavatoristi Luan Dalipaj.

Po ashtu detyrë tjetër që na është dhënë nëpërmjet shkresës së Ministrisë së Bujqësisë nr. 3418/1 datë 17.05.2021 për vënien në gadishmëri të infrastrukturës së kullimit rreth aeroportit të ri të Vlorës në Akërnin për kanalet e I, II dhe të III që kërkon impenjim in tonë.

Në zonën e Myzeqesë në fushën e Akërnisë dhe rreth aeroportit të Akërnisë sipas shkresës që na ka ardhur nga Ministria e Bujqësisë ku është kërkuar mirëmbajtja e sistemit kullues të fushës së Akërnisë janë bërë përlllogaritjet dhe janë pasqyruar në buxhetin e vitit 2022 dhe në projekt-buxhetin AFM 2022-2024 me vlerën 13.000.000 cdo vit të cilën Bashkia duhet të vendosi të bëhet me prokurim apo më shtesë të mjeteve pastruese. Në këtë zonë janë filluar punimet që nga muaji Tetor e në vazhdim ku po punohet dhe aktualisht me 2 eskavatorë Volvo rreth Fushës së Aviacionit Akërnin që kanë dekada pa u pastruar.

a) Gatishmëria e hidrovorit të qytetit

Gatishmëria e hidrovorit të qytetit në vitin 2021 ka qenë e mirë

Është përballuar rënia e reshjeve si dhe ujërat e përditëshme që dalin nga qyteti i Vlorës.

Baseni në të cilën grumbullohen këto ujëra në hidrovor është rreth 4100 ha të cilat kanë nevojë për pastrimin e gati 10km kanale të I dhe të II. Deri tani janë pastruar 70% e kanaleve siç janë

ato të kanaleve kulluese që vin nga lagjia “Çole”, Kume, Fusha e Aviacionit, K.U.Z. e madhe, Kanalet që vinë nga shkolla “Ibrahim Kushta” etj.

Për sa i përket pompave aksiale të hidrovorit:

-Nga 4 pompa punojnë 3

-Kapaciteti nga 16m³/s në 11.5m³/s

-Gatishmëria 72%

Arsyet janë këto:

-Amortizimi i lartë i pompave

-Difekt i rëndë në pompën 2, Ganz500

Në muajin Dhjetor bëme ndërhyrjet emergjente që ishin parashikuar në ndërrimin e kapakëve të cilët fushin ujë, në sistemet elektrike, të vajisjes, hidraulike.

Gjatë vitit 2022 ngelet për të vënë në gatishmëri pompa Ganz2 e cila domosdoshmerisht do bërë riparimi kapital këtë vit ose zëvendësimi me një pompë të re, si dhe ndërrimi i tubacionit të shkarkimit të pompës nr.3.

Me gjithë amortizimin e madh të hidrovorit në përgjithësi gatishmëria është e kënaqshme.

b) Shfrytëzimi i eskavatorëve

	Alfons Hysomemaj		Luan Dalipaj		Daniel Islamaj	
	Ditë pune të planifikuara	Ditë pune të realizuara	Ditë pune të planifikuara	Ditë pune të realizuara	Ditë pune të planifikuara	Ditë pune të realizuara
Janar	12	5	18	20	18	20
Shkurt	12	3	18	18	18	7
Mars	12	5	18	16	18	15
Prill	12	5	18	14	18	17
Maj	12	3	15	14	15	13
Qershor	12	4	15	20	15	22
Korrik	0	0	0	0	0	0
Gusht	0	0	0	0	0	0
Shtator	12	15	18	8	18	20
Tetor	12	8	18	23	18	15
Nëntor	12	0	18	4	18	5
Dhjetor	12	9	18	18	18	13
Shuma	120	57	174	161	174	147
Në përqindje	47.5%		92.5%		84.5%	

Ditë pune të planifikuara: 468 ditë pune

Ditë pune të realizuara: 365 ditë pune

Në %: 78%

c) Realizimi i shpenzimeve të planifikuara me prokurim

Për realizimin e shpenzimeve me prokurime 22,954,000 lekë është parashikuar dhe janë realizuar 21,000,000 lekë.

Në përqindje: 91.3%

d) Ndërhyrje në kanalet ujitëse

Për sa i përket gatishmërisë së kanaleve janë rehabilituar me fondet e Bashkisë:

-14km veshje me beton nga viti 2018 e në vazhdim

-Janë rehabilituar pastrime të kanaleve ujitëse me bazë dheu pa veshje 20km kanal ujitës.

Çdo vit ndërhyet për pastrimin rutinë 10-15km.

Për vitin 2021 janë pastruar 10km kanal dhe vepra arti.

Ky sezon ujitje ka qen i vecantë për arsye të temperaturave të larta.

Ne si Bord Kullimi bëmë gatishmërinë e sistemeve të ujitjes në të gjithë skemat si është ajo e Llakatundit, Babicës së Vogël, Kallafetit, Dukatit, Radhimës dhe Panajasë.

Këto sisteme kanë patur ujë gjatë gjithë periudhës.

Shfrytëzimi i tyre lë për të dëshiruar.

Ish-organizatat e përdorimit të ujit përveç asaj të Llakatundit janë tërhequr nga kontrolli dhe administrimi i tyre.

Pra uji ka vërshuar në kanalet ujitëse por nuk është menaxhuar.

Kjo është një përgjegjësi shumë e madhe në administrim që është lënë në mëshirë të fatit.

Shumë arsye të tjera sic është lënia e tokave bujqësore në kullota ose mos mbjellje të kulturave vaditëse.

Kanë qënë të planifikuara 750 ha për tu ujitur. Nga kjo janë ujitur gjithsej afërsisht 200 ha në zonën e Llakatundit të bërë nga administrimi i mirë i z. Bardhosh Malaj që është administratori i vendosur nga Kryetari i Bashkisë.

Edhe në zonat e tjera janë ujitur por pasqyrimi është fare minimal.

Si me rezervuarin e Babicës 30ha, Kallafetit 20ha, Dukatit megjithëse ka patur ujë 24 orë nuk është raportuar asnjë hektar, Panajaja 10 ha. Të dhënat, përveç të Llakatundit, janë operative.

Prandaj kërkohet ndërhyrja e Kryetarit të Bashkisë, Këshillit Bashkiak, Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave për gjetjen e zgjidhjes për administrimin e këtij sektori jetik për banorët dhe fermerët e Bashkisë Vlorë.

e) Investimet

Janë realizuar 4,000,000 nga 10,200,000: Realizimi është blerja e një mini eskavator 5.2 ton për nevojat e pastrimit të kanaleve ujitëse. Pjesa tjetër e investimit kanali ujitës VLU3-3 Risili me vlerë 6,200,000 lekë nuk është realizuar për efekte proceduriale në prokurim. Djegia e fondeve (mosrealizimi i tyre) është dobësi organizative.

f) Struktura

Përsa i përket strukturës së sektorit kemi bërë gjithmonë kërkesa që sipas ligjit ky sektor të marrë formën e plotë nga reformimi:

1. Punonjës më arsim të lartë në organikë 3 (tre)
2. Manovrator (eskavatorist) 4 (katër)

3. Mirëmbajtës mjetesh të rënda (mekanik) 1 (një)
4. Mirëmbajtës kujdestar rezervuarësh 1 (një)
5. Administrator ujitje 5 (pesë)
6. Hidrovori i Qytetit 11 (njëmbëdhjetë)

Duke mos kërkuar fond shtesë të pagave.

Aktualisht janë 17 (shtatëmbëdhjetë) veta nga 25 punonjës që kërkon sektori i Bordit të kullimit.

Sektori DDD

Sektori i shërbimit DDD realizon dezinfektime dezinfektive dhe deratizime në çerdhe, kopshte, shkolla, vendstrehime, lulishte, parqe, dhe mjedise publike., sic janë shkollat, kopshtet dhe çerdhet dy herë në vit, si edhe në rastet kur ka ankesa nga këto institucione publike. Ndërhyrjet për blatat ose furrtaret në kuzhinat e kopshteve dhe çerdheve bëhen dy herë në vit, ndërsa për brejtësit ndërhyhet një herë në vit.

Për të siguruar garantimin e sigurisë së shëndetit sektori DDD zbaton një plan masash profilaktike për kufizimin ose eliminimin e brejtësve në rast kontaktimi, si edhe të insekteve që rrjedhimisht sjellin probleme në ambientin e gatimit. Preparatet që përdoren janë konform rekomandimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe Rregullores 528/2012 të BE 'Për produktet biocide'

Gjatë muajit janar janë kryer dezinfektive të bodrumeve të pallateve fillimisht duke inspektuar vatrat e infeksionit si bodrume e mcr dhe më pas ndërhyrja me preparat për dezinfektimin e tyre. Inspektimet dhe desinsektimet kryhen çdo ditë të javës nga e hëna deri të shtunën në vatrat e evidentuara më parë dhe në rast konstatimi të reja,

Në Rajonin 1 është realizuar inspektim dhe dezinfektim në rast konstatimi vatre infeksioni, dezinfektim i Kanalit të Ujrave të larta, dezinfektim banese pranë Shkollës "4 Heronjtë" , Katllavanit të ish Kinema Ali Demi, pallat pranë Spitalit me parkim të kontaminuar me ujë të ndotur.

Në Rajonin 2 pranë zonës së quajtur "Ish Reparti Ushtarak,, , "Ish Gazermat,, ose ish Magazinat e Repartit të Sazanit,, është evidentuar një pallat i ndërtuar mbas viteve 90. Në këtë pallat parkimi i nëndheshëm është jo funksional dhe ka prezence jo vetëm uji por edhe të mbeturinave potencial vatre për mushkonje por edhe për brejtësit. Problematika në këtë zonë shtohet së tepërmi pasi kemi kanale të hapura, në vende të caktuara janë edhe të bllokuara, gjë që çon në akumulim uji dhe vater potenciale mushkonje, problematike më së shumti në sezonin e verës ku temperaturat rriten ndjeshëm. Në këtë rast është ndërhyrë me preparat dezinfektues e dezinfektues për zvogelimin e prezencës së infeksionit. Gjithashtu është inspektuar dhe dezinfektuar në rast konstatimi të prezencës së larvës së mushkonjës përgjatë kanalit të Siavit.

Në Rajonin 3 është dezinfektuar Mcr, banesa të braktisura e parkime të nëndheshme si më poshtë:

- ❖ MCR pranë Kopshtit Nr.2.
- ❖ MCR pranë shkollës "Musa Çakërri", pranë një banese.
- ❖ Shtëpi të braktisura pranë shkollës Musa Çakërri, të cilat ishin kthyer në grumbullim mbeturinash dhe vatër për brejtësit, e cila është dezinfektuar e deratizuar.

Në vijim kemi evidentuar një pallat të dytë në këtë rajon, pranë "Furrë Bukë Fabio,, te blloku i pallateve pranë Zyrës së Punës "Ish Shkolla e Naftes,, . Kjo ndërtesë është ende në ndërtim, por ka prezencë uji në parkimin e nëndheshëm që është potencial vatre mushkonje.

Në Rajonin 4 situata dezinfektuar ndërtesa por edhe ambientet rreth pallateve, të cilat janë:

- ❖ Ndërtesa rreth zonës së quajtur Kapino pallat me numër 1258
- ❖ Rreth Shkollës "15 Tetori,, pallat me numër 1300 i cili ka bodrume me ujra të ndotura si edhe vatër për brejtësit pasi ka mbeturina shtazore dhe jo shtazore përreth tij.
- ❖ Pallate rreth postes së Çoles pallat me nr.1267, zona mbrapa Shkollës "Jani Minga" pallat nr.1286 me ujë të ndotur në bodrum
- ❖ Janë dezinfektuar zyrat e Shërbimit të Provës.

Në Rajonin 5 kemi evidentuar problematika në pallate të ndërtuara para viteve 90 dhe kemi ndërhyrë për minimizimin e problematikës përkatësisht:

- ❖ Pallat në Rrugën Demokracia nr.1982, i cili gjithashtu ka prezencë uji të ndotur potencial vatre infeksioni.
- ❖ Në pallatin e ashtuquajtur "6 katëshi,, kemi prezencë uji të ndotur në bodrume. Gjendja në këtë pallat është jo e mirë. Megjithëse kryhet disinfektim rutine për të penguar daljen e mushkonjës vërejmë se kemi prezencë vektoresh transmetues të semundjeve.
- ❖ Mcr e cila ka qene e mbyllur me pare me beton por gjatë një rikonstruksioni të kryer pranë Kopshtit Nr.3 është bërë dëmtimi i derës së betonit dhe kjo mcr është bërë tepër problem për kopshtin dhe për banorët, e cila nuk është vetëm vatër për vektor transmetuesh infeksioni por edhe vend akumulimi për mbeturinat fekale. Në këtë zonë është identifikuar dhe kemi dezinfektuar një pallat ndërtuar mbas viteve 90 me kat të nëndheshëm me ujë që kishte sjellë shqetësim te banorët.
- ❖ Është dezinfektuar dhe deratizuar për brejtësit Qendra Ekonomike.
- ❖ Është dezinfektuar Kopshti 1, Kopshti 2, Kopshti 3, Kopshti 5, Kopshti 9, Kopshti N.14, Çerdhja 15, Kopshti 1 Maj, Kopshti 4 Heronjtë.
- ❖ Është zhvilluar procedura DDD në Hidrovorin e madh të Qytetit
- ❖ Është dezinfektuar Shkolla "Musa Çakëri" , Shkolla "28 Nëntori" Shkolla "Teli Ndini",

Në muajin shkurt janë kryer dezinfektime të bodrumeve të pallateve fillimisht në vatrat e infeksionit si bodrume e mcr dhe më pas ndërhyrja për dezinfektimin e tyre. Inspektimet dhe desinsektimet kryhen çdo ditë të javës nga e hëna deri të shtunën në vatrat e evidentuara më parë dhe në rast konstatimi të reja,

Në Rajonin 1 është realizuar inspektim dhe dezinfektim në rast konstatimi vatre infeksioni, dezinfektim i Kanalit të Ujrave të larta, dezinfektim banese pranë Shkollës "4 Heronjtë". Katllavanit te ish Kinema Ali Demi, pallat pranë Spitalit me parkim të kontaminuar me ujë të ndotur

- ❖ Janë dezinfektuar ambjentet ku merren tamponet ndaj Covid-19 dhe zyrat e Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor
- ❖ U dezinfektuan ambjentet e shkollës "Teli Ndini "
- ❖ U dezinfektua shkolla 9 vjeçare " 4 Heronjtë"

- ❖ U realizua dezinfektim në ambjentet e kopshtit N.5
- ❖ U dezinfektuan zyrat e Prefekturës
- ❖ U dezinfektuan ambjentet te "Drejtoria Rajonale Tatimore"

Në Rajonin 2 u realizua inspektim pranë zones e quajtur "Ish Reparti Ushtarak,, dhe është dezinfektuar parkimi i nëndheshëm është jo funksional me prezence uji por edhe të mbeturinave. Është ndërhyrë duke dezinfektuar e dezinfektuar per zvogelimin e vatrës së infeksionit.

- ❖ U zhvillua dezinfektim te "Shtëpia e foshnjës"

Në Rajonin 3 janë dezinfektuar e dezinfektuar banesa të braktisura mcr e parkime të nëndheshme si më poshtë:

- ❖ MCR pranë Kopshtit N.2
- ❖ MCR pranë Shkollës "Musa Çakëri", pranë një banese, Mcr me përmbajtje uji të ndotur e mbeturina, si edhe shtëpi të braktisura pranë shkollës "Musa Çakëri", të cilat ishin kthyer në grumbullim mbeturinash dhe vat ër për brejtësit, e cila është dezinfektuar e deratizuar
- ❖ U realizua dezinfektim në Qendrën "Aulona",
- ❖ U dezinfektuan ambjentet e shkolles "Lef Sallata"
- ❖ U dezinfektuan ambjentet e shkollës së mesme "Naim Frashëri"
- ❖ U realizua dezinfektim i ambjenteve në çerdhen N:4
- ❖ U realizua dezinfektim në Bibliotekën " Shefqet Musaraj" si edhe dezinfektimi i hyrjes të një pallati pranë saj ku kishte persona Covid -19 pozitiv.
- ❖ U realizua dezinfektimi në zyrat e Drejtorisë Arsimore
- ❖ U realizua dezinfektim në ambjentet te "Zyra e Punës"
- ❖ Dezinfektimi vijoi në ambjentet e "PLM "
- ❖ Dezinfektimi u zhvillua në ambjentet e Prokurorisë së Apelit

Në Rajonin 4 situata janë dezinfektuar bodrumet por edhe ambientet rreth pallateve, të cilat janë:

- ❖ Pallat me bodrum me numër 1258
- ❖ Pallati 1267 me bodrum me ujë të ndotur
- ❖ Pranë Shkollës "15 Tetori,, pallat me numër 1300 i cili ka bodrum me ujra të ndotur.
- ❖ Pallate rreth postes se Çoles nr.1281, nr.1267, zona mbrapa Shkollës "Jani Minga pallat nr.1286 me ujë të ndotur,,
- ❖ Pallat 1365 mbas Shkollës 9 vjeçare "Marigo Posio"
- ❖ U dezinfektuan ambjentet e Shkolles 9 vjeçare " 15 Tetori"
- ❖ U realizua dezinfektim në kopshtin N.7,
- ❖ U realizua dezinfektim në kopshtin N. 13,
- ❖ U realizua dezinfektim në Drejtorinë e Bujqësisë
- ❖ Dezinfektimi vijoi te Avokatura e Shtetit
- ❖ Dezinfektimi ka vijuar në zyrat e Shërbimit të Provës.

Në Rajonin 5 kemi ndërhyrë për minimizimin e problematikës duke dezinfektuar përkatësisht:

- ❖ Pallate në zonën përballë Komisarariatit të Policisë i cilët kanë ujra të ndotura në bodrumet e tyre,
- ❖ Pallat në Rrugën Demokracia nr.1982, i cili gjithashtu ka prezencë uji të ndotur potencial vatre infeksioni.
- ❖ Në pallatin "6 katëshi,, është kryer dizinsektim si çdo javë për të minimizuar prezencën e vektorëve .
- ❖ Mcr e cila pranë Kopshtit Nr.3
- ❖ U dezinfektuan ambjentet e shkollës "Zigur Lelo"

Në Njësisë Administrative Novoselë

- ❖ U realizua dezinfektim në Qendren e Transferimit të Bimëve

Në Njësinë Administrative Qendër

- ❖ U realizua dezinfektim në shkollën 9 vjeçare dhe kopshtin "Nikolla Xhuveli" Nartë.
- ❖ U realizua dezinfektim në shkollën dhe kopshtin "Hajredin Haxhiraj" Kërkovë.
- ❖ Dezinfektimi vijoi në shkollën dhe kopshtin "Taulla Xhafa" Hoshtimë.
- ❖ U dezinfektua shkolla dhe kopshti "Xhemil Bregu" Panaja,
- ❖ Dezinfektimi vijoi në kopshtin "Ilia Kici Dashi" Bestrovë

Gjatë muajit mars ka vijuar dezinfektimi i Rajoneve në vatrat e evidentuara gjatë gjithë javës. **Në Rajonin 1** është realizuar inspektim dhe dezinfektim në Qendrën Historike, dezinfektim banese pranë Shkollës "4 Heronjtë" , pallat pranë Spitalit me parkim të kontaminuar me ujë të ndotur,

Në Rajonin 2 është dezinfektuar me prezencë uji bodrumet e dy pallateve të ndërtuara para viteve 90 mbas Shkollës së mesme "Pavarsia" .

Në Rajonin 3 është dezinfektuar Mcr, banesa të braktisura e parkime të nëndheshme si më poshtë:

- ❖ MCR pranë shkollës Musa Çakëri, pranë një banese,
- ❖ Zona e Ish Kombinatit, inspektim dhe dezinfektim në mcr, banesë e braktisur, si edhe nje garazhd pallati te blloku i pallateve pranë Kopshtit N.9, I cili paraqiste problem për vatër mushkonje.
- ❖ Është dezinfektuar Shkolla 9 vjeçare "Musa Çakëri",
- ❖ U dezinfektuan ambjentet e shkollës speciale "PLM",
- ❖ Është realizuar dezinfektim dhe dezinfektim në ambjentet e "Zyrës së Punës"
- ❖ Është dezinfektuar banesa e një individi që ishte gjetur i pajetë te blloku i Orizit nga Policia e Shtetit.
- ❖ Janë dezinfektuar ambjentet te Sigurimet Shoqërore

Në Rajonin 4 janë dezinfektuar pallate si më poshtë:

- ❖ Pallat me numër 1258
- ❖ Pallati 1267 me bodrum me ujë të ndotur
- ❖ Pallat me numër 1300 i cili ka bodrum me ujë të ndotur

- ❖ Pallate rreth postes se Çoles nr.1281, nr.1267
- ❖ U dezinfektuan ambjentet e Kopshtit N:7,

Në Rajonin 5 kemi ndërhyrë për minimizimin e problematikës duke dezinfektuar përkatësisht:

- ❖ Pallat në zonën përballë Komisarariatit të Policisë i cilët kanë ujra të ndotura në bodrumet e tyre,
- ❖ Pallat në Rrugën Demokracia nr.1982, i cili gjithashtu ka prezencë uji të ndotur potencial vatre infeksioni.
- ❖ Në pallatin e ashtuquajtur “6 katëshi,, kemi prezence uji të ndotur në bodrum
- ❖ Mcr e cila pranë Kopshtit Nr.3
- ❖ Është inspektuar Zona e Fushës së Aviacionit, deri te Fusha e Druve. Gjatë inspektimit nuk është konstatuar prezencë larve mushkonje.
- ❖ Janë dezinfektuar ambjentet e Kopshti N:3

Në Njësinë Administrative Orikum

- ❖ Janë dezinfektuar ambjentet e Shkollës 9 vjeçare "Balil Pelari"

Në Njësinë Administrative Shushicë

- ❖ U realizua dezinfektim në Shkollën dhe Kopshtin "Selam Musai" Babicë e madhe
- ❖ Shkolla "Festim Hoxha" Sherishtë
- ❖ Shkolla "Lili Gori" Xhyherinë.

Gjatë muajit prill është realizuar inspektim dhe dezinfektim përkatësisht në:

Në Rajonin 1 është dezinfektuar një banesë pranë Shkollës "4 Heronjtë" , pallat pranë Spitalit me parkim të kontaminuar me ujë të ndotur

- ❖ U dezinfektua Shkolla "Musa Çakëri"

Në Rajonin 2 pranë zones e quajtur “Ish Reparti Ushtarak,, është dezinfektuar parkimi jo funksional me prezencë mbeturinash. Është ndërhyrë duke u dezinfektuar per zvogelimin e vatrës së infeksionit

- ❖ U dezinfektuan shkolla e mesme si : "M.Q.Ataturk" ,
- ❖ U dezinfektua shkolla e mesme "Ali Demi
- ❖ Dezinfektimi te shkolla e mesme profesionale "Pavarësia"

Në Rajonin 3 janë dezinfektuar e dezinfektuar banesa të braktisura mcr e parkime të nëndheshme si më poshtë:

- ❖ MCR pranë kopshtit N:2
- ❖ MCR pranë Shkollës "24 Maj", vatrë për vektore të ndryshëm, potencial infeksioni.
- ❖ MCR pranë shkollës "Musa Çakëri", pranë një banese, Mcr me përmbajtje uji të ndotur e mbeturina.
- ❖ Shtëpi të braktisura pranë shkollës "Musa Çakëri", të cilat ishin kthyer në grumbullim mbeturinash, e cila është dezinfektuar.

Në Rajonin 4 situata janë dezinfektuar bodrumet por edhe ambientet rreth pallateve, të cilat janë:

- ❖ Pallat me bodrum me numër 1258.
- ❖ Pallati 1267 me bodrum me ujë të ndotur.
- ❖ Pranë Shkollës "15 Tetori", pallat me numër 1300 i cili ka bodrum me ujra të ndotur.
- ❖ Pallate rreth postes së Çoles nr.1281, nr.1267, pallat nr.1286 me ujë të ndotur.
- ❖ Pallat 1365 mbas Shkollës 9 vjeçare "Marigo Posio".
- ❖ U realizua dezinfektimi të Shkollën 9 vjeçare "15 Tetori"
- ❖ U realizua dezinfektimi në Shkollën 9 vjeçare "Marigo Posio"

Në Rajonin 5 kemi ndërhyrë për minimizimin e problematikës duke dezinfektuar përkatësisht:

- ❖ Pallati të Posta me bodrume të kontaminuara me ujë të ndotur.
- ❖ Pallate në zonën përballë Komisarariatit të Policisë i cilët kanë ujra të ndotura në bodrumet e tyre.
- ❖ Pallat në Rrugën Demokracia nr.1982, i cili gjithashtu ka prezencë uji të ndotur potencial vatre infeksioni.
- ❖ Në pallatin "6 katëshi", është kryer dizinsektim për të minimizuar prezencën e vektorëve .
- ❖ Në lulishten të "Ushtari i Panjohur", ku kishte vatër mushkonjë pranë tualeteve publike
- ❖ U dezinfektua Shkolla 9 vjeçare "Rilindja"
- ❖ U dezinfektua shkolla e mesme "Halim Xhelo"

Gjatë muajit maj është inspektuar dhe dezinfektuar sipas Rajoneve si më poshtë:

Në Rajonin 1 është realizuar inspektim dhe dezinfektim në rast konstatimi vatre infeksioni, në banesën pranë Shkollës 9 vjeçare "4 Heronjtë" , Katllavanit të ish Kinema Ali Demi, si edhe është dezinfektuar Pallati i papërfunduar të Qendra Historike

- ❖ Është dezinfektuar Muzeu etnografik dhe Muzeu Historik

Në Rajonin 2 pranë zones e quajtur "Ish Reparti Ushtarak,, është inspektuar parkimi i nëndheshëm është jo funksional me prezencë uji por edhe të mbeturinave. Gjithashtu është inspektuar dhe dezinfektuar në rast konstatimi të prezencës së larves së mushkonjës përgjatë kanalit të Siavit

- ❖ Është deratizuar Qendra e Zhvillimi PAK

Në Rajonin 3 janë dezinfektuar e dezinfektuar banesa të braktisura mcr e parkime të nëndheshme si më poshtë:

- ❖ MCR pranë shkollës "Musa Çakërri", pranë një banese, MCR me përmbajtje uji të ndotur e mbeturina
- ❖ MCR pranë Shkollës "24 Maj"

Në Rajonin 4 situata janë dezinfektuar bodrumet por edhe ambientet rreth pallateve, të cilat janë:

- ❖ Pallat me bodrum me numër 1258
- ❖ Pallati 1267 me bodrum me ujë të ndotur

- ❖ Pranë Shkollës "15 Tetori,, pallat me numër 1300 i cili ka bodrum me ujra të ndotur.
- ❖ Pallate rreth postes se Çoles nr.1281, zona mbrapa Shkollës "Jani Minga pallat nr.1286 me ujë të ndotur,,
- ❖ Pallat 1365 mbas Shkollës "Marigo Posio"

Në Rajonin 5 kemi ndërhyrë për minimizimin e problematikës duke dezinfektuar përkatësisht:

- ❖ Pallat në Rrugën Demokracia nr.1982, i cili gjithashtu ka prezencë uji të ndotur potencial vatre infeksioni.
- ❖ Në pallatin "6 katëshi,, është kryer dizinsektim si çdo javë për të minimizuar prezencën e vektorëve .
- ❖ Janë inspektuar kanalet anësore pranë Shkollës "Zigur Lelo"
- ❖ Është dezinfektuar pallat me kat të nëndheshëm jo funksional përballë me Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike pasi kishte prezence mushkonje.
 - Në vijim është dezinfektuar banesa e një qytetari i gjetur i pajete në banesën e tij nga policia.
 - Janë dezinfektuar Kopshtet si : Zigur Lelo, Kopshti Nr.3
 - Janë dezinfektuar ambjentet e Çerdhes Nr.15

Gjatë muajit qershor janë inspektuar dhe dezinfektuar vatrat ne rajonet si më poshtë:

Në Rajonin 1 janë dezinfektuar vatrat si më poshtë:

- ❖ Ambjentet perreth baneses se braktisur pranë Shkollës 9 vjeçare "4 Heronjtë" duke përfshirë banesen dhe koshat e mbeturinave.
- ❖ Pallati i papërfunduar te Qendra Historike, I cili ishte bërë problematike duke shkaktuar irritim te banoret me pranine e insekteve fluturoese.
- ❖ Ndertese pranë AKU me kat nëndheshëm jo funksional

Në Rajonin 2 është inspektuar dhe dezinfektuar si më poshtë:

- ❖ Dezinfektim dhe deratizim te Kabinat te Plazhi i Vjeter e cila së pari është vatrë infeksioni pasi është e frekuentuar nga kafshë endacak të cilët janë potencial I mundshëm për infestime dhe së dyti shihen vende me ujë të kontaminuar edhe ky potencial per zhvillim vektoresh transmetues të sëmundjeve infektive.
- ❖ Është dezinfektuar një pallat i papërfunduar i cili ishte i infestuar me larva mushkonje
- ❖ Në Lungomare në zonën e quajtur Shkolla e Marinës është dezinfektuar në koshat e mbeturinave dhe në pucetat përgjatë saj.

Në Rajonin 3 janë dezinfektuar e dezinfektuar banesa të braktisura mcr e parkime të nëndheshme si më poshtë:

- ❖ MCR pranë Shkollës "24 Maj"
- ❖ MCR pranë shkollës "Musa Çakëri", pranë një banese, Mcr me përmbajtje uji të ndotur e mbeturina
- ❖ Është dezinfektuar dhe deratizuar Shkolla 9 vjeçare "Ismail Qemali"
- ❖ Është dezinfektuar dhe deratizuar Çerdhja Nr.15
- ❖ Janë inspektuar dhe dezinfektuar pucetat në Blllokun e banimit te Kendi i Lojrave

- ❖ Është dezinfektuar zona te fillimi i Lungomares në pjesën pranë Hotel Bolonja e cila kishte pucete te kontaminuar me uje të ndotur.

Në Rajonin 4 situata janë deziinfektuar dezinfektuar janë:

- ❖ Pallat me bodrum me numër 1258, 1267, 1300
- ❖ Pallate rreth postes se Çoles nr.1281, zona mbrapa Shkollës "Jani Minga pallat nr.1286 me ujë të ndotur,,
- ❖ Pallat 1365 mbas Shkollës 9 vjeçare "Marigo Posio" Pallat 1365, 1258, 1267, 1300, 1286
- ❖ U dezinfektuan ambjentet shkolla 9 vjeçare "Jani Minga"
- ❖ U dezinfektuan ambjentet te shkolla 9 vjeçare "15 Tetori"

Në Rajonin 5 kemi dezinfektuar përkatësisht:

- ❖ Bodrumet e pallatit te Posta Qëndrore e cila ishte problematike për banorët.
- ❖ Pallat në Rrugën Demokracia nr.1982, i cili gjithashtu ka prezencë uji të ndotur
- ❖ Në pallatin "6 katëshi,, është kryer dizinfektim si çdo përjavshëm.

Në Njësinë Administrative Orikum

Kopshti "Mustafa Qemal Ataturk" në Orikum është dezinfektuar dhe deratizuar ambjentet brenda dhe jashtë tij

Gjatë muajit korrik është inspektuar dhe dezinfektuar si më poshtë:

Rajonin 1 janë dezinfektuar vatrat si më poshtë:

- ❖ Ambientet perreth baneses se braktisur pranë Shkollës 9 vjeçare "4 Heronjtë" duke përfshirë banesen dhe koshat e mbeturinave.
- ❖ Pallati i papërfunduar te Qendra Historike, I cili ishte bërë problematike duke shkaktuar irritim te banoret me pranine e insekteve fluturoese.
- ❖ Ndertese pranë AKU me kat nëndheshëm jo funksional
- ❖ Janë dezinfektuar zyrat te Sherbimi i Provës.

Në Rajonin 2 është inspektuar dhe dezinfektuar si më poshtë:

- ❖ Është dezinfektuar një pallat i papërfunduar i cili ishte i infestuar me larva mushkonje
- ❖ Në Lungomare në zonën e quajtur Shkolla e Marinës është dezinfektuar në koshat e mbeturinave dhe në pucetat përgjatë saj.
- ❖ U dezinfektuan ambjentet "Mustafa Qemal Ataturk"

Në Rajonin 3 janë dezinfektuar e dezinfektuar banesa të braktisura mcr e parkime të nëndheshme si më poshtë:

- ❖ MCR pranë Shkollës "24 Maj"
- ❖ MCR pranë shkollës "Musa Çakëri", pranë një banese, Mcr me përmbajtje uji të ndotur e mbeturina
- ❖ Është dezinfektuar dhe deratizuar Shkolla 9 vjeçare "Ismail Qemali"
- ❖ Është dezinfektuar dhe deratizuar Çerdhja Nr.15
- ❖ Janë inspektuar dhe dezinfektuar pucetat në Bllokun e banimit te Kendi i Lojrave

- ❖ Është dezinfektuar zona te fillimi i Lungomares në pjesën pranë Hotel Bolonja, e cila kishte pucete te kontaminuar me uje të ndotur.
- ❖ Qendra Shëndetësore 1 Maj

Në Rajonin 4 janë dezinfektuar e dezinfektuar si më poshtë:

- ❖ Janë dezinfektuar bodrumet e pallateve te Posta e Çoles, pranë Shkollës 9 vjeçare "15 Tetori", pranë Shkollës "Marigo Posio" si edhe mbas Shkollës së mesme "Jani Minga" përkatësiht 1365, 1258, 1267, 1300, 1286
- ❖ Dezinfektim dhe deratizim te Kabinat te Plazhi i Vjeter e cila është vatër infeksioni.

Në Rajonin 5 kemi dezinfektuar përkatësisht:

- ❖ Janë dezinfektuar zyrat te Gjendja Civile
- ❖ Pallat në Rrugën Demokracia nr.1982, i cili gjithashtu ka prezencë uji të ndotur
- ❖ Në pallatin "6 katëshi,, është kryer dezinfektim për minimizimin e insekteve fluturues.
- ❖ Është dezinfektuar dhe deratizuar Kopshti Nr.3
- ❖ Bodrumet e pallatit te Posta Qendrore e cila ishte problematike per banoret.

Gjatë muajit gusht

Në Rajonin 1 është realizuar inspektim dhe dezinfektim ne

- ❖ Kanalin të Ujrave të larta,
- ❖ Dezinfektim banese pranë Shkollës 9 vjeçare "4 Heronjtë"
- ❖ Pallat pranë Spitalit me parkim të kontaminuar me ujë të ndotur
- ❖ U dezinfektua shkolla dhe kopshti " 4 Heronjtë"
- ❖ U dezinfektua shkolla " Teli Ndini "
- ❖ U dezinfektua "28 Nëntori"
- ❖ U dezinfektua Kopshti Nr.5

Në Rajonin 2

- ❖ Dezinfektim dhe deratizim te Kabinat te Plazhi i Vjeter e cila së pari është vatër infeksioni pasi është e frekuentuar nga kafshë endacak të cilët janë potencial I mundshëm për infestime dhe së dyti shihen vende me ujë të kontaminuar edhe ky potencial per zhvillim vektoresh transmetues të sëmundjeve infektive.
- ❖ Është dezinfektuar sërish një pallat i papërfunduar i cili ishte i infestuar me larva mushkonje
- ❖ Pranë Shkollës së Marinës janë dezinfektuar pucetat dhe koshat e mbeturinave të cilat ishin te tejmbushura me mbeturina organike dhe inerte.
- ❖ U dezinfektua shkolla e mesme " Ali Demi"
- ❖ U dezinfektua Shkolla Industriali "Pavarësia"
- ❖ U dezinfektua Shkolla Profesionale Tregtare
- ❖ U realizua dezinfektim në shkollën e mesme "Mustafa Qemal Ataturk"
- ❖ U dezinfektua shkolla dhe kopshti " Zenel Murro "
- ❖ U dezinfektua Shkolla 9 vjeçare "Avni Rustemi"

- ❖ U realizua dezinfektim te Kopshti "1 Maj"
- ❖ U realizua dezinfektim në shkollën " Ismail Qemali "
- ❖ U realizua dezinfektim në shkollën " Muço Delo "
- ❖ U realizua dezinfektim në shkollën " Ismail Qemali "
- ❖ U realizua dezinfektim në Kopshtin N.15
- ❖ U realizua dezinfektim në Qendrën e Zhvillimit PAK
- ❖ U realizua dezinfektim në " Shtëpinë e foshnjës"

Në Rajonin 3 janë dezinfektuar e dezinfektuar banesa të braktisura mcr e parkime të nëndheshme si më poshtë:

- ❖ MCR pranë shkollës "Musa Çakërrri", pranë një banese, Mcr me përmbajtje uji të ndotur e mbeturina
- ❖ MCR pranë Shkollës "24 Maj"
- ❖ U realizua dezinfektim në Çerdhe N.4
- ❖ U realizua dezinfektim në Çerdhen Nr.15
- ❖ U realizua dezinfektim në shkollën " Ismail Qemali "
- ❖ U realizua dezinfektim në Kopshtin N.2
- ❖ U realizua dezinfektim në shkollën " Musa Çakërrri"
- ❖ U realizua dezinfektim në shkollën speciale " PLM"
- ❖ U realizua dezinfektim në Kopshtin Nr.8
- ❖ U realizua dezinfektim në Kopshtin Nr.9
- ❖ U realizua dezinfektim në Kopshtin Nr.10
- ❖ U dezinfektua dhe u dezinfektua shkolla "24 Maj"
- ❖ U dezinfektua shkolla dhe kopshti "Lef Sallata"
- ❖ U dezinfektua shkolla e mesme " Naim Frashëri"

Në Rajonin 4 situata janë dezinfektuar ndërtesa por edhe ambientet rreth pallateve, të cilat janë:

- ❖ Ndërtesa rreth zonës së quajtur Kapino pallat me numër 1258
- ❖ Rreth Shkollës "15 Tetori,, pallat me numër 1300 i cili ka bodrume me ujra të ndotura si edhe vatër për brejtësit pasi ka mbeturina shtazore dhe jo shtazore përreth tij.
- ❖ Pallate rreth Postes se Çoles pallat me nr.1267, zona mbrapa Shkollës "Jani Minga" pallat nr.1286 me ujë të ndotur në bodrum.
- ❖ U dezinfektua shkolla e mesme " Jani Minga"
- ❖ U realizua dezinfektim në shkollën 9 vjeçare "Jani Minga "
- ❖ U realizua dezinfektim Çerdhe N:2
- ❖ U dezinfektua Kopshti Nr.7
- ❖ U dezinfektua Kopshti Nr.11
- ❖ U dezinfektua Kopshti Nr.13
- ❖ U dezinfektua shkolla 9 vjeçare " Marigo Posio "
- ❖ U dezinfektua shkolla 9 vjeçare " 15 Tetori "

Në Rajonin 5 kemi evidentuar problematika në pallate të ndërtuara para viteve 90 dhe kemi ndërhyrë për minimizimin e problematikës përkatësisht:

- ❖ Pallat në Rrugën Demokracia nr.1982, i cili gjithashtu ka prezencë uji të ndotur potencial vatre infeksioni.
 - ❖ Janë dezinfektuar bodrumet e pallatit “6 katëshi,, të cilat kishin prezencë uji të ndotur. Dezinfektimi në këtë pallat është i përjavshëm.
 - ❖ Është dezinfektuar nje pallat i ndertuar para viteve 90 pranë Sahatit të Qytetit , i cili është vatër për zhvillimin e mushkonjave
 - ❖ U dezinfektua Kopshti Nr.1
 - ❖ U dezinfektua Kopshti Nr.3
 - ❖ U dezinfektua Kopshti Nr.14
 - ❖ U dezinfektua shkolla e mesme "Shaban Demiraj"
 - ❖ U dezinfektua shkolla e mesme "Halim Xhelo"
 - ❖ U dezinfektua shkolla 9 vjeçare "Ibrahim Kushta"
 - ❖ U dezinfektua shkolla 9 vjeçare dhe kopshti "Zigur Lelo"
 - ❖ U dezinfektua shkolla 9 vjeçare "Rilindja"
- Gjatë këtij muaji është zhvilluar procedura DDD në Institucionet e Arsimit Parauniversitar në kuadrin e fillimit të vitit të ri shkollor 2021-2022 të cilat janë të paraqitura në tabelen e mëposhtme:

Gjimnaze	Kopshte		Çerdhe	Shkollë 9 vjeçare	
Gjimnazi Fasli Danaj Llakatund	1.Kopshti 1	1.Kopshti Loni Mone	Çerdhja Nr:2	Shkolla Lef Sallata	Shkolla Pilo Prifti –Novoselë
Gjimnazi Pilo Prifti	2.Kopshti Nr.2	2.Kopshti Delisuf	Çerdhja Nr:4	Shkolla Musa Çakëri	Shkolla Loni Mone-Poro
Gjimnazi Hasan Mëhilli	3.Kopshti Nr.3	3.Kopshti Dëllënjë	Çerdhja Nr:15	Shkolla 4 Heronjtë	Shkolla Kafil Malaj Bishan
Gjimnazi Hasan Pulo	4.Kopshti Nr.5	4.Kopshti Ismail Qemali – Fitore		Shkolla Zigur Lelo	Shkolla Reshat Hoxha Akerni
	5.Kopshti N: 7	5.Kopshti Reshat Hoxha Akëri		Shkolla Zenel Murra	Shkolla Taulla Xhafaj Hoshtime
	6.Kopshti Nr:8	6.Kopshti Pilo Prifti- Novoselë		Shkolla Ibrahim Kushta	Shkolla Xhemil Bregu -Panaja
	7.Kopshti Nr:9	7.Kopshti Skrofotinë		Shkolla Rilindja	Shkolla Perlat Rexhepi- Cerkovine
	8.Kopshti Nr:10	8.Kopshti Perlat Rexhepi -Cerkovinë		Shkolla Muço Delo	Shkolla Avni Rustemi Trevllazër
	9.Kopshti Nr:11	9.Kopshti Avni Rustemi -Trevllazër		Shkolla Avni Rustemi	Shkolla Hajredin Haxhiraj Kerkove
	10.Kopshti Nr: 13	10.Kopshti Taulla Xhafaj Hoshtime		Shkolla 15 Tetori	Shkolla Ismail Qemali Fitore

	11.Kopshti Nr:14	11.Kopshti Xhemil Bregu -Panaja		Shkolla Marigo Posio	Shkolla Faslli Danaj Llakatund
	12.Kopshti Nr:15	12.Kopshti Hajredin Haxhiraj Kerkove		P.L.M	Shkolla Festim Hoxha Sherishtë
	13.Kopshti 1 Maj	13.Kopshti Ilia Kici Dashi –Bestrove		Q.Zh.P.A.K	Shkollë Lili Gori Xhuherinë
	14.Kopshti Lef Sallata			Shkolla Jani Minga	Shkolla Idris Rustemi Risili
	15.Kopshti Musa Çakëri			Shkolla Ismail Qemali	Shkolla Faslli Danaj Llakatund
	16. Kopshti 4 Heronjtë				Shkolla Hamit Lumi Babicë e Vogël
	17.Kopshti Zigur Lelo				Shkolla Selam Musai Babicë e Madhe
	18.Kopshti Zenel Murra				

Gjatë muajit shtator

Në Rajonin 1 është realizuar inspektim dhe dezinfektim ne

- ❖ Dezinfektim banese pranë Shkollës 9 vjeçare "4 Heronjtë"
- ❖ Pallat pranë Spitalit me parkim të kontaminuar me ujë të ndotur

Në Rajonin 2

- ❖ Dezinfektim dhe deratizim te Kabinat te Plazhi i Vjeter ,vatër infeksioni, pasi shihen vende me ujë të kontaminuar edhe ky potencial per zhvillim vektoresh transmetues të sëmundjeve infektive.
- ❖ U realizua dezinfektim në katin e nëndheshëm të godinës te Shtëpia e Foshnjes

Në Rajonin 3

- ❖ U realizua dezinfektim në bllokun e pallateve te Sheshi "3 Racat"
- ❖ U realizua dezinfektim në Shkollën Speciale "PLM"
- ❖ U realizua dezinfektim i ambjenteve të brendshme te Tatimet

Në Rajonin 4

- ❖ U dezinfektuan ambjentet e Kopshtit Nr.7
- ❖ Janë dezinfektuar bodrumet e pallateve te Posta e Çoles, pranë Shkollës 9 vjeçare "15 Tetori", pranë Shkollës "Marigo Posio" si edhe mbas Shkollës së mesme "Jani Minga" pasi kanë ujë të kontaminuar

Në Rajonin 5

- ❖ U realizua dezinfektim i ambienteve të brendshme të Kopshtit Nr.2
- ❖ U dezinfektua bodrumi i pallatit nr.1982 në Rrugën Demokracia, i cili ka prezencë uji të ndotur.
- ❖ Janë dezinfektuar bodrumet e pallatit "6 katëshi,, me prezencë uji të ndotur.
- ❖ U dezinfektua mcr pranë Kopshtit N.3, e cila bëhet shpeshhere vendgrumbullim mbeturinash organike dhe inorganike.
- ❖ Është dezinfektuar bodrumi i një pallati pranë Sahatit të Qytetit , i cili është vatër për zhvillimin e mushkonjave

Gjatë muajit tetor

Në Rajonin 1

- ❖ U dezinfektuan zyrat te Prefektura
- ❖ U inspektua u dezinfektua dhe deratizua hapsira te ish Kinema Ali Demi. Theksojmë së kjo sipërfaqe është e kontaminuar me brejtës të cilët gjejnë strehë dhe ushqim në mbeturinat organike dhe inorganike që hedhin banorët.

Në Rajonin 2

- ❖ U dezinfektua Konvikti i Industriales
- ❖ U dezinfektuan ambientet e brendshme të Kopshtit Nr.15
- ❖ U realizua dezinfektimi I ambienteve të Shkollës 9 vjeçare "Avni Rustemi"

Në Rajonin 3

- ❖ U dezinfektuan ambientet e brendshme të Kopshtit Nr.8
- ❖ U dezinfektuan ambientet e Kopshtit Nr.9
- ❖ U inspektuan dhe u dezinfektuan mcr pranë Shkollës 9 vjeçare "Musa Çakëri". Këto mcr apo vendstrehime kanë prezencë uji, i cili shpeshhere bëhet mjedis I përshtatshëm për zhvillimin e larvave për llojet Culex.

Në Rajonin 4

- ❖ U dezinfektuan ambientet e Kopshtit Nr.13
- ❖ U dezinfektuan ambientet e Kopshtit Nr.7
- ❖ Janë dezinfektuar bodrumet e pallateve te Posta e Çoles, pranë Shkollës 9 vjeçare "Marigo Posio" pranë Shkollës 9 vjeçare "15 Tetori", si edhe mbas Shkollës së mesme "Jani Minga" përkatësiht 1258,1286,1365, 1267, 1300.
- ❖ Dezinfektim dhe deratizim te Kabinat te Plazhi i Vjeter e cila është vatër infeksioni.

Në Rajonin 5

- ❖ U dezinfektuan ambientet e Kopshtit Nr.3
- ❖ U realizua dezinfektim në bodrumin e pallatit nr.1982në Rrugën "Demokracia"
- ❖ Në pallatin"6 katëshi,, është kryer dizinfektimi për minimizimin e vektoreve si insektet fluturues, të cilët gjejnë mjedis të përshatshëm për zhvillimin e larvave të tyre.

- ❖ Është dezinfektuar dhe deratizuar Kopshti Nr.3 në ambjentet e brendshme të tij, por dhe mcr e cila vijon ende të ketë ujë të ndotur.
- ❖ Është dezinfektuar hyrja e pallatit të Posta Qendrore e cila ishte problematike për banoret pasi kishte presence të insekteve fluturues.

Në Njësinë Administrative Orikum

Janë dezinfektuar ambjentet e brendshme si klasa, korridore, tualete në Shkollën e mesme "Hasan Pulo" Orikum. Në hapësirat jashtë godinës është deratizuar si profilaksi për brejtësit.

Gjatë muajit nëntor

Në Rajonin 1

- ❖ Janë dezinfektuar ambjentet përreth banesës së braktisur pranë Shkollës 9 vjeçare "4 Heronjtë"
- ❖ Është inspektuar dhe dezinfektuar kati i nëndheshëm i një pallati pranë Spitalit me parkim të kontaminuar me ujë të ndotur.

Në Rajonin 2

- ❖ U dezinfektuan hapsirat e jashtme të Shkollës së mesme Industriale "Pavarësia"
- ❖ U dezinfektuan ambjentet e brendshme të Kopshtit "1 Maj" dhe në pjesën jashtë godinës u deratizua për brejtësit.
- ❖ U dezinfektuan ambjentet e brendshme të Shkollës së mesme "Ali Demi"

Në Rajonin 3

- ❖ U realizua dezinfektim në hapsirat e brendshme të godinës së Kopshtit Nr.10
- ❖ U inspektuan dhe u dezinfektuan mcr me prezencë uji pranë Shkollës 9 vjeçare "Musa Çakëri".
- ❖ U inspektuan dhe u dezinfektuan blloku i banimit të ish Tregu i Orizit. Dezinfektimi u realizua të mcr të cilat ishin të hapura.

Në Rajonin 4

- ❖ U realizua dezinfektim i ambjenteve të brendshme të Shkollës 9 vjeçare "Jani Minga"
- ❖ U realizua dezinfektim i ambjenteve të Kopshtit Nr.11

Në Rajonin 5

- ❖ U dezinfektuan hapsirat e brendshme dhe të jashtme të Kopshtit Nr.3

Në Njësinë Administrative Shushicë

U dezinfektuan hapësira e brendshme e Kopshtit "Grabian" si edhe Qendra Shendetësore "Grabian"

Gjatë muajit dhjetor

Në Rajonin 1

- ❖ U dezinfektuan hapsirat e brendshme të Shkollës dhe Kopshtit "4 Heronjtë"
- ❖ U dezinfektua dhe u higjenizua hapsira përreth koshave të mbeturinave pranë Shkollës 9 vjeçare "4 Heronjtë"

- ❖ U dezinfetuan ambjentet e brendshme të Shkollës 9 vjeçare "Teli Ndini"
- ❖ U dezinfetuan ambjentet e brendshme të Kopshtit Nr.5
- ❖ U dezinfetuan ambjentet e brendshme të Shkollës 9 vjeçare "28 Nëntori"

Në Rajonin 2

- ❖ U dezinfetuan ambjentet e brendshme të Shkollës 9 vjeçare "Ismail Qemali"
- ❖ U dezinfetuan ambjentet e brendshme të Shkollës së mesme Tregtare.
- ❖ U dezinfetuan ambjentet e brendshme të Shtëpisë së Foshnjës

Në Rajonin 3

- ❖ U dezinfektuan ambjentet e brendshme të Kopshtit Nr.8
- ❖ U dezinfektuan ambjentet e Kopshtit Nr.9
- ❖ U inspektuan dhe u dezinfektuan mcr pranë Shkollës 9 vjeçare "Musa Çakëri". Këto mcr apo vendstrehime kanë prezencë uji, I cili shpeshhere bëhet mjedis I përshtatshëm për zhvillimin e larvave për llojet Culex

Në Rajonin 4

- ❖ Janë dezinfektuar bodrumet e pallateve te Posta e Çoles, pranë Shkollës 9 vjeçare "Marigo Posio" pranë Shkollës 9 vjeçare "15 Tetori", si edhe mbas Shkollës së mesme "Jani Minga".

Në Rajonin 5

- ❖ U realizua dezinfektim në bodrumin e pallatit nr.1982 në Rrugën "Demokracia"
- ❖ Në pallatin "6 katëshi,, është kryer dizinfektimi për minimizimin e vektoreve si insektet fluturues, të cilët gjejnë mjedis të përshatshëm për zhvillimin e larvave të tyre.
- ❖ Është dezinfektuar dhe higjenizuar Mcr pranë Kopshtit Nr.3
- ❖ Është dezinfektuar bodrumi i pallatit pranë ish Merkatës i cili ka prezencë uji të ndotur që është potencial për mjedis të përshtatshëm për vektorët e llojit culex.
- ❖ U dezinfetuan ambjentet e brendshme të Kopshtit Nr.1

Spektori Mirëmbajtje Rrugë, Trotuare, Plazhe publike

Spektori mirëmbajtje rrugë, trotuarë, plazhe si sektor brenda Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike e ka organizuar punën e tij mbi bazën e grafikëve të ndërtuar për t'i shërbyer sa më mirë komunitetit të qytetit.

Ky sektor e ka ndërtuar punën në mirëmbajtje të rrugëve të qytetit si mbushje me asfalt, çakëll, stabilizant dhe rërë bituminoze si dhe të njësive administrative të përfshira në Bashkinë Vlorë si Novoselë, Llakatund, Njësia Qendër dhe Orikum.

Pothuajse është ndërhyrë gjatë gjithë periudhës në pjesën më të madhe të rrugëve të rajoneve të qytetit si:

Në rajonin Nr 5

Lagja “Kushtrim” përballë ish-fabrikës së tullave është bërë pastrimi i dherave, llumrave dhe materialeve të ndryshme.

Këto rrugica të kësaj lagje janë pastruar dhe karikuar me çakëll disa herë duke transportuar sasi të mëdha të këtyre material janë larguar nga rrugicat dhe kunetat rreth 110 m³ materiale të ndryshme.

Është bërë skarifikimi dhe mbushja me material inert (çakëll, stabilizant) duke shpenzuar një sasi prej 200 m³ çakëll.

Po kështu në këtë rajon është ndërhyrë në rrugicat e po kësaj lagje pranë SHA Ujësjetllës Vlorë duke pastruar rrugicat dhe kunetat me materiale të ngurta prej 70 m³.

Është bërë skarifikimi dhe karrikimi me material inert (çakëll, stabilizant) në sasinë prej 100 m³.

Në bllokun e projektit plot pranë ish-serrave si dhe ish-tuneleve të aviacionit duke hequr pastruar dhe transportuar materiale të ndryshme si dhe mbeturina në volum prej 90 m³

Është bërë skarifikimi dhe karrikimi me material inert në sasinë prej 80 m³.

Në rajonin Nr 2

Lagja “Isa Boletini”

Janë pastruar të gjitha mbetjet e ndryshme dhera , llumra dhe materiale të tjera në të gjitha rrugicat e kësaj lagje në sasinë prej 100 m³.

Janë skarifikuar dhe karikuar me material inert si çakëll , stabilizant në sasinë 150 m³.

Në zonën e unazës (Bishti i kalldrëmit deri te Institucioni SHIK) janë pastruar të gjitha rrugicat e zonës nga mbeturina si dhe mbetje të ndryshme në volum 90 m³.

Janë skarifikuar dhe mbushur me çakëll, stabilizant në sasinë prej 30 m³.

Në lagjen “10 Korriku”

Janë pastruar mbetje të ngurta dhe materiale të tjera në sasinë prej 70 m³.

Janë skarifikuar dhe mbushur me çakëll, stabilizant rrugicat në sasi për 80 m³.

Në lagjen “Uji i Ftohtë”

Pastrime nga mbetjet e ndryshme dhera llumra nga Club ITARUS deri te tuneli unaza (Diplomati) sidomos në situatën e shirave në sasinë prej 80 m³ pasi këto materiale shkarkohen nga kodra si rezultat i reshjeve në këtë zone.

Në lagjen “Pavarësia” është ndërhyrë me mbushje gropa me rërë bituminoze në sasinë prej 20 ton.

Në ruginë pranë Zjarrëfiksës është ndërhyrë disa herë me pastrim mbeturina, ku janë larguar rreth 70 m³.

Është bërë skarifikim dhe mbushje me çakëll stabilizant në rrugicat pranë ambulancës së lagjes si dhe rruga tek Aneksi i Stadiumit “Flamurtari” rreth 50 m³. Si dhe në pjesën pas pas pallatit të lojrave me dorë.

- Në Rajonin Nr 3

Në lagjen “ Rilindja” pastrim nga balta , mbetje materiale të ngurta në bllokun pranë P L M në sasinë prej 20 m³.

Në godinën e Bibliotekës së Qytetit është ndërhyrë me pastrim të sipërfaqeve të oborrit pas saj dhe heqje materialesh në sasinë prej 30 m³.

Kjo sipërfaqe është mbushur me stabilizant në sasinë prej 20 m³.

Është ndërtuar një pjesë e murit rrethues të dëmtuar.

Është ndërtuar dhe vendosur portë metalike në hyrjen pas godinës.

Është bërë karikimi me rërë bituminoze në të gjitha rrugicat e lagje në sasinë prej 30 ton.

Pastruar nga mbetjet ne bllok prej 60 m³ mbetje të ndryshme.

- Në Rajonin Nr 1

Në bllokun mbi spital pranë liqenit është ndërhyrë me pastrim të rrugicave nga mbetjet në ato të pa asfaltuar duke transportuar sasinë prej 50 m³.

Ndërkohë në këto rrugica u bë karikimi me çakëll me një sasi prej 50 m³.

Në zonën e Karabashit është ndërhyrë në të gjitha dëmtimet e rrugës me mbushje me rërë bituminoze në sasinë prej 30 ton.

Ne zonen e kuzumbabase pastrim mbeturina te ndryshme prej 40 m³

Ne zonen e ish fabrikes cimento pastruar 40 m³ mbeturina

- Në Rajonin Nr 4

Pastrimi i mbetjeve të ndryshme dhe inerteve në rrugët Mateo Matatias dhe evaduar një sasi materiali prej 30 m³.

Është bërë skarifikim dhe karikim me çakëll stabilizant në sasi 40 m³.

Në rrugën “Fan Noli” është bërë skarifikimi dhe është bërë mbushje në stabilizant në sasi prej 60 m³.

Te rruga pranë kopshtit “Pullumbat e Paqes” është bërë pastrimi dhe evadimi i një sasi prej 50m³.

Po kështu është bërë skarifikim dhe karikim me stabilizant në sasinë prej 30 m³.

Në rrugën Lef Sallata pranë ish fushës së aviacionit është skarifikuar dhe karrikuar me çakëll në sasinë prej 60 m³

Në rrugën pranë shinave të trenit, skarifikim dhe karikim me çakëll në sasinë prej 30 m³.

Rrugët e dëmtuara të shtruara me asfalt

Emërtimi i rrugëve	Sipërfaqe / m ²	Sasia /m ³	Sasia / ton
Janaq Kilica, At Kristi Negovani, Demokracia	228.6	22.8	50.1
Blloku i kullave të Xhamia	594	59.4	130.68
Rruga para Shkollës “Jani Minga”	331.4	33.14	72.9
Unaza para SHIK	115.4	11.54	25.38

dhe kthesa “Lamanaj”			
Blloku i pallateve pas Sigurime Shoqërore	96.6	9.6	21.12
Rruga Sulejman Delvina (Bishti i Kalldrëmit) pas sigurimeve shoqërore nr 2	29.3	2.9	6.6
Rruga “Ali Demi” mbi spital (kryqëzimi)	771.5	77.1	170
Kryqëzimi Transballkanike me rrugën Sazani (para karburant Vola)	50	5	11
Posta çole kryqëzimi si dhe pas pallatit postës	127.3	12.7	28
Rruga “ Riza Salati, Misto Mele, kryqëzimi Tre racat	182	18.2	40
Blloku i pallateve Tregu i orizit	115	11.5	25.3
Rruga Kuzumbaba	104	11.5	25.3
Rruga “ Pelivan Leskaj”	24	2.4	5.3
Blloku i pallateve lagjja “ Isa Boletini”	400	40	88
Sheshi në fund të rrugës “Demokracia” para Supermarket Haso	389.6	38.9	85.6
Rruga pranë ish- konsullatës Italiane	200	20	44
Blloku i pallateve në “Varosh”	200	20	44
Është riparuar me asfalt blloku i pallateve pas shkollës Industriale	300	30	66
Te rruga Gjergj Araniti	50	5	11
Rruga Pelivan Leskaj (pranë Hotel	30	3	6.6

Partner)				
Tek unaza pranë KSHA	60	6	13.2	
Para shkollës “Teli Ndini”	500	50	110	
Tek rruga Hasan Kushta	30	3	6.6	
Total	4878.7	482.14	1086.6	

Sinjalistika rrugore

Në sektorin e sinjalistikës është punuar për vendosjen e sinjalistikës horizontale dhe vertikale.

Janë bërë vijëzimet e këmbësorëve përgjatë Lungomares.

Janë bërë vijëzimet e korsive të biçikletave.

Janë bërë vijëzimet e këmbësorëve në bulevardin Vlorë-Skelë.

Janë bërë vijëzimet e këmbësorëve në unazën paralel me Lungomaren.

Në rrugën “At Kristo Negovani” janë bërë vijëzimet e këmbësorëve në kryqëzimet

Në rrugën Demokracia janë bërë vijëzime këmbësorësh pranë shkollës “Rilindja”

Janë bërë vijëzime këmbësorësh në rrugën “Dervish Hekali” si pranë shkollës “Perla”

Në rrugën Lef Sallata janë bërë vijëzime këmbësorësh në kryqëzime si dhe pranë Shkollës “Naim Frashëri” dhe “Musa Cakëri”

Në rrugën “Misto Mele” janë bërë vijëzime këmbësorësh në kryqëzim dhe pranë shkollës 24 Maj

Në vazhdim jemi me bërjen e vijëzimeve të këmbësorëve në rrugët para shkollave si dhe kryqëzimet e rrugëve.

Pastrimi i plazheve publike

Është kryer pastrimi në plazhin e vjetër nga mbeturina detare (leshërikë) si dhe mbetje të tjera, si dhe largimi i tyre në sasinë prej 300 ton.

Plazhi i Akademisë pastruar periodikisht nga mbetjet detare si dhe mbeturina të tjera në sasinë prej 300 ton.

Plazhi i ri është pastruar periodikisht sidomos në sasi mbetje detare në fundin e këtij plazhi pranë fushave të sportit, vend ku grumbullohet sasia më e madhe e këtyre mbeturinave, prej 250 ton.

Plazhet janë mirëmbajtur edhe duke u pluguar dhe sistemuar sipërfaqja e rërës si dhe pastrimi i shkallëve të trotuarit përgjatë Lungomares nga rëra dhe mbaturinat.

Ishulli pastrohet ditë për ditë nga mbetjet detare dhe mbeturinat.

Në vazhdim të punës për mirëmbajtjen e plazheve vazhdon pastrimi i tyre nga mbeturinat, leshërikët etj.

Riparim trotuare:

Është ndërhyrë pjesërisht në vendet në të cilat trotuarët kanë ceduar

Rruga “ Ali Demi “ janë riparuar 32 m²

Trotuari para Shkollës “Jani Minga” 13 m²

Në trotuarin e Lungomares	12 m ²
Tek shkolla “ Ibrahim Kushta”	45 m ²
Tek blloku i pallateve pas Sigurimeve Shoqërore	43 m ²
Përballë Bibliotekës është bërë riparim i trotuarit prej	70 m ²
Riparuar trotuari pranë shkollës 24 Maj	20 m ²
Riparim ttrotuari te rruga Tregu i orizit	150 m ²

Sinjalistika rrugore

Në sektorin e sinjalistikës është punuar për vendosjen e sinjalistikës horizontale dhe vertikale.

Janë bërë vijëzimet e këmbësorëve përgjatë Lungomares.

Janë bërë vijëzimet e korsive të biçikletave.

Janë bërë vijëzimet e këmbësorëve në bulevardin Vlorë – Skelë.

Janë bërë vijëzimet e këmbësorëve në unazën paralel me Lungomaren.

Në rrugën At Kristo Negovani janë bërë vijëzimet e këmbësorëve në kryqëzimet

Në rrugën Demokracia janë bërë vijëzime këmbësorësh pranë shkollës “Rilindja”

Janë bërë vijëzime këmbësorësh në rrugën “Dervish Hekali” si pranë shkollës “Perla”

Në rrugën Lef Sallata janë bërë vijëzime këmbësorësh në kryqëzime si dhe pranë Shkollës “Naim Frasheri” dhe “Musa Cakërri”

Në rrugën “Misto Mele” janë bërë vijëzime këmbësorësh në kryqëzim dhe pranë shkollës “24 Maj”.

Në vazhdim jemi me bërjen e vijëzimeve të këmbësorëve në rrugët para shkollave si dhe kryqëzimet e rrugëve.

Janë vendosur tabela që kanë munguar në rrugët “At Kristo Negovani”, në rrugën “Anita Bitri”, “Riza Salati”, “Gjergj Aranti”, Unaza e qytetit.

Në sinjalistikën horizontale:

Janë vizuar vend qëndrime taksi, tek rruga “Parlat Rrexhepi” pranë Bashkisë, në rrugën Sazani.

Në rrugën “Gjergj Araniti”, “Demokracia”, rreth - rrotullimi Pusi i Mezinit rreth-rrotullimi pranë shkollës së Aviacionit.

Janë kryer së fundmi vijëzimet e Longomares

Ne sektorin e sinjalistikës është punuar për vendosjen e sinjalistikës horizontale dhe vertikale.

Janë bërë vijëzimet e këmbësorëve përgjatë Lungomares.

Janë bërë vijëzimet e korsive të biçikletave.

Janë bërë vijëzimet e këmbësorëve në bulevardin Vlorë - Skelë.

Jane bërë vijëzimet e këmbësorëve në unazën paralel me Lungomaren.

Betonime të ndryshme në rrugë dhe rrugica

Në rrugën e unazës pranë Rrapit në Ujë të Ftohtë është bërë betonimi i një sipërfaqe prej 15 m².

Është ndërtuar trotuari përballë Club Itarus në pllaka si dhe beton në sipërfaqe prej 20 m².

Betonim i gropave në rrugën “At Kristo Negovani” pranë ish- Gjykatës së vjetër 10 m².

Betonim bazamante gabinës elektrike pranë Bashkisë.

Betonuar rruga pranë prefekturës 300 m²

Betonuar rrugicë përballë Ish kinema Ali Demi 200 m³

Teku blloku i kullave pranë Xhamisë 500 m²

Tek blloku pranë rrugës Kristo Mele 500 m²

Në situatën e reshjeve

Sektori i rrugë trotuare së bashku me mjetet e ndërmarrjes është angazhuar në çdo moment kur ka situatë rreshjesh për pastrimin e rrugëve, trotuare, kunata nga baltrat si tek ish - bobinazhi, unaza e qytetit, rruga “Demokracia” sheshi fabrika e tullave, në Pus Mezini.

Periudha e sezonit turistik

Gjatë gjithë periudhës së sezonit turistike ndërmarrja ka punuar në pastrim plehra në Lungomare paradite dhe mbasdite e organizuar me mjete transporti si dhe punëtorë si dhe çdo të diel.

Janë hequr plehra jashtë kazaneve të plehrave nëpër qytet.

Janë hequr 540 ton plehra.

Është pastruar Pylli i Sodës nga mbetjet, plehrat duke organizuar mjetet e ndërmarrjes si skrep kamion 20 ton si dhe kamioncinat e vogla.

Në kuadër të nismës për një qytet të pastër , ndërmarrja ka angazhuar gjithë sektorët me punonjës dhe me mjete për pastrimin nga mbetjet e ndryshme në pyllin e qytetit si dhe në rrugët interurbane të bashkisë gjithashtu edhe në zona të ndryshme të banuara të qytetit.

Projekti K05100: Gjelbërimi

Gjatë këtyre muajve në Qytetin e Vlorës është shërbyer në të gjitha sip. e gjelbërta.

Në rrugën nacionale Vlorë-Fier shërbehet me pastrim, higjenizim, korrje sip.bari, krasitje shkurresh, krasitje drurësh, spërkatje drurësh.

Lulishtja hyrja e qytetit është shërbyer me pastrim, higjenizim, korrje sip, bari, vaditje me bot, krasitje shkurresh e gardh i gjelbër, punim dru shkurre, plehrim kimik, pastrim shatërvani, riparim stolash, spërkatje e bimësisë dekorative.

Lulishja 8 nëntori është shërbyer me krasitje drurësh, krasitje gardh i gjelbër, punim, plehrim kimik.

Lulishte para Policisë është shërbyer me pastrim, higjenizim, korrje sip.bari, krasitje gardh i gjelbër dhe shkurre, punim dru –shkurre-gardh i gjelbër, plehrim kimik.

Lulishte ura e degës është shërbyer me pastrim higjenizim, korrje sip.bari, krasitje dru-shkurre-gardh i gjelbër, plehrim kimik.

Rruga Dervish Hekali është shërbyer me punim drurësh e vaditje me bot.

Rruga Demokracia është shërbyer me pastrim higjenizim, korrje sip, bari, punim drurësh, vaditje me bot, punim sip.e dëmtuara dhe mbjellje fare bari, vaditje me bot.

Rruga Hysni Alimerko është punuar me pastrim, punim drurësh dhe krasitje.

Lulishte Pallati i Kulturës + Universiteti i ri është shërbyer me pastrim –higjenizim, punim tokë për mbjellje lulesh, mbjellje lulesh, vaditje, korrje sip. bari+plehrim, krasitje palmash+spërkatje, krasitje drurësh +punim, fshirje e rrugëve e shesheve, pastrim i fugave, qethje shkurresh për t'u dhënë formë, krasitje gardh i gjelbër +punim.

Lulishte në Hyrje të Portit është shërbyer me pastrim –higjenizime, korrje sip. bari, fshirje rrugë e sheshe, krasitje drurësh, qethje shkurresh e gardh i gjelbër+punim e vaditje.

Muzeu i Pavarësisë është shërbyer me punim toke për mbjellje lulesh, mbjellje lulesh, çapitje lulesh, korrje sip. bari.

Rruga Fejzo Gjomema është shërbyer me pastrim, punim drurësh, vaditje.

Rruga Hektor Shyti është shërbyer me pastrim, punim drurësh, vaditje.

Rruga Kosova –Parku i tregtisë është shërbyer me punim toke për mbjellje farë bari, mbjellje fare bari, plehrim, vaditje, korrje sip. bari, punim drurësh, qethje shkurresh +punim, vaditje me bot.

Rruga Pelivan Leskaj është shërbyer me pastrim, punim drurësh, qethje gardh i gjelbër, plehrim kimik.

Rruga Shyqyri Alimerko është shërbyer me punim drurësh, pastrime barërash të këqija në trotuar, spërkatje drurësh.

Rruga Aristidh Kokoshi është shërbyer me punim drurësh, krasitje për ngritje kurore.

Rruga Dush Strati është shërbyer me punim drurësh, pastrim, krasitje për ngritje kurore, krasitje e rëndë.

Rr. Nermin Vlora Falaski është shërbyer me pastrim-higjenizim, korrje sip. bari, qethje shkurresh e punim, punim drurësh, plehrim kimik.

Rr. Mustafa Bello është shërbyer me pastrim, punim drurësh+krasitje për ngritje kurore, krasitje e rëndë.

Rr. Naim Frashëri është shërbyer me pastrim, punim drurësh, pastrim trotuarësh nga barërat e këqija.

Rr. Mis Durham është shërbyer me punim drurësh, krasitje, pastrim trotuarësh nga barërat e këqija, spërkatje drurësh, vaditje me bot.

Lulishte Marigo Posio është shërbyer me pastrim-higjenizim, korrje sip. bari, plehrim, qethje shkurresh+punim, krasitje gardh i gjelbër+punim, fshirje rrugë e sheshe, plehrim kimik.

Trekëndëshi Holiday është shërbyer me pastrim, vaditje, qethje gardh i gjelbër+punim, punim shkurresh, korrje sip. bari, plehrim kimik, vaditje me bot.

Lulishte te Bashkia, 6 katëshi, Muzeu, Mesapliku, rr. Perlat Rexhepi është shërbyer me pastrim-higjenizim, korrje sip. bari, punim toke për mbjellje lulesh, mbjellje lulesh, vaditje, krasitje gardh i gjelbër, punim dru-shkurre-gardh i gjelbër, fshirje rrugë e sheshe, vaditje me bot.

Blloku Kapele-Posta është shërbyer me pastrim –higjenizim, qethje shkurresh+punim, punim drurësh, punim toke për përgatitje për mbjellje të sip. së barit të dëmtuar, plehrim kimik.

Lagjia 28 Nentori+Gjendja Civile është shërbyer me pastrim –higjenizim, korrje sip. bari, krasitje gardh i gjelbër+punim, qethje shkurresh+punim, punim drurësh, plehrim kimik, krasitje drurësh.

Shkallët në Kuzum Baba shërbehet me pastrim, korrje sip. bari, qethje shkurresh, fshirje të shkallëve.

Lungomare është shërbyer me pastrim-higjenizim, vaditje, korrje sip. bari, plehrim, rigjenerim tapet bari, punim drurësh+krasitje, krasitje palmash+spërkatje, hapje gropash me skrep e me

krah, mbushje e gropave me çakëll dhe mbjellje e pishave të reja, riparim impiantesh, punim me freze sip.e dëmtuara.

Blloku Pavarësia është shërbyer me pastrim, higjenizim, korrje sip.bari, qethje shkurresh+punim, qethje gardh i gjelbër, punim drurësh, krasitje palmash, plehrim kimik.

Blloku Kali i Trojës është shërbyer me pastrim, higjenizim, korrje sip.bari, fshirje rrugë e sheshe, krasitje palmash+spërkatje, punim dru –shkurre, qethje shkurre e gardh i gjelbër, riparim stolash.

Rr. Anita Bitri, Lef Sallata, Jeronim de Rada, Fiqirete Musta, Hajredin Haxhiraj është shërbyer me pastrim, punim drurësh, krasitje, pastrim i trotuarit nga barërat e këqija, plehrim kimik,vaditje me bot.

Blloku Isa Boletini është shërbyer me pastrim, higjenizim, korrje sip.bari, punim dru-shkurre-gardh i gjelbër, qethje gardh i gjelbër +shkurre, pastrim trotuari nga barërat e këqija,plerim kimik.

Lulishte pas Qendrës Studentore është shërbyer me pastrim, punim drurësh, qethje shkurresh e gardh i gjelbër+punim.

Blloku pas Teatrit Petro Marko shërbehet me pastrim, higjenizim, korrje sip. bari, qethje shkurresh e punim, krasitje gardh i gjelbër +punim, punim drurësh, fshirje rrugë e sheshe.

Blloku përballë Xhamisë është shërbyer me pastrim, higjenizim, korrje sip.bari, fshirje rrugë e sheshe, punim drurësh, krasitje palmash, qethje shkurre e gardh i gjelbër+punim.

Rruga Gjergj Araniti është punuar me pastrim, higjenizim, qethje shkurre e gardh i gjelbër, punim shkurre e gardh i gjelbër, punim beli për përgatitje të tokës për rigjenerim të barit të dëmtuar, mbjellje fare bari, vaditje me bot, pastrim, nivelim dheu, mbjellje fare bari pas karburantit te rruga Gjergj Araniti (700 m²)

Rr. Albano Romina është shërbyer me pastrim, punim drurësh, pastrim trotuari nga barërat e këqija,vaditje me bot.

Rruga Veleidin Kollozi është shërbyer me pastrim, higjenizim, korrje sip.bari, punim drurësh+spërkatje, plehrim kimik, vaditje me bot, punim dhe mbjellje me farë bari sip.e dëmtuara.

Rr.Riza Salati është shërbyer me pastrim, punim drurësh, pastrim trotuari nga barërat e këqija,vaditje me bot.

Lulishte Selia e PS është shërbyer me pastrim, higjenizim, punim dru–shkurre, qethje shkurre e gardh i gjelbër, korrje sip. bari.

Rr.Ali Demi është shërbyer me: pastrim, higjenizim, korrje sip.bari, punim drurësh, punim e qethje gardh i gjelbër, plehrim kimik,vendosje stolash te lapidari, vaditje me bot, spërkatje.

Rr.Osman Haxhiu, Zaho Koka, Enver Jaho është shërbyer me pastrim, punim, krasitje drurësh, pastrim i trotuarit nga barërat e këqija.

Rr.Rakip Malile është shërbyer me pastrim, krasitje palmash+spërkatje, qethje gardh i gjelbër +punim, plehrim kimik.

Rotondo në Hyrje të Rr.Transballkanike është shërbyer me pastrim, korrje sip. bari, plehrim me pleh kimik.

Rr.Transballkanike është shërbyer me pastrim, higjenizim, krasitje gardh i gjelbër, punim i trafikndarësit, korrje sip bari, punim toke, mbjellje lule, zvendësim të luleve të vjedhura, çapitje, plehrim,vaditje me bot, punim me frezë.

Lulishte 3 Racat është shërbyer me pastrim, fshirje, punim dru-shkurre, qethje shkurresh, korrje sip.bari, shkulje barërash të këqija.

Bloku i Kombinatit është shërbyer me pastrim, korrje sip.bari, punim drurësh, pastrim fugash te parkimet e makinave, krasitje drurësh të mëdhenj që rrezikojnë, krasitje drurësh për ngritje kurore, vaditje me bot.

Bloku pas Albano Romina është shërbyer me pastrim, higjenizim, punim dru-shkurre-gardh i gjelbër, vaditje me bot.

Rruga Sazani është shërbyer me pastrim, higjenizim, korrje sip.bari, punim drurësh, pastrim i Pyllit të Sodës nga letra, inerte, krasitje e pishave, heqje e rrënjëve të pishave të rrëzuara prej vitesh, prerje ferrash.

Lulishte Plazhi i vjetër është shërbyer me pastrim, korrje sip.bari, punim dru-shkurre, qethje shkurresh për t'u dhënë formën e duhur.

Rr.Trotuaret te BKT, Rr.Kastriot Gjini është shërbyer me pastrim, punim drurësh.

Rr.Misto Mele është shërbyer me pastrim, higjenizim, korrje sip.bari, punim dru-shkurre-gardh i gjelbër, qethje shkurre e gardhe të gjelbër, vaditje me bot, spërkatje.

Rr. At Kristo Negovani është shërbyer me pastrim, punim gardh i gjelbër+krasitje, krasitje drurësh, plehrim kimik.

Rr.Zahir Pajaziti, Tasim Jonuzi, Ramize Gjebrea është punuar me pastrim, punim drurësh, pastrim trotuarësh nga barërat e këqija.

Bloku pas 3 Racave është shërbyer me pastrim, punim dru-shkurre-gardh i gjelbër, krasitje shkurre-gardh i gjelbër, korrje sip.bari, punim toke dhe mbjellje fare bari në vendet e dëmtuara.

Bloku te rr.Demokracia është shërbyer me pastrim, punim drurësh, plehrim kimik, pastrim të sip.të parkimeve, vaditje me bot.

Lulishte te Liqeni është shërbyer me pastrim, korrje sip.bari, krasitje drurësh, qethje shkurresh, punim dru-shkurre.

Bloku Pilot është shërbyer me pastrim, korrje sip.bari, punim dru-shkurre, qethje shkurresh, vendosje stolash, pastrim i trotuarëve nga barërat e këqija.

Rr. Dhimitër Konomi është shërbyer me pastrim trotuari nga barërat e këqija, punim drurësh, plehrim kimik, spërkatje me herbicide e barëerave të këqija.

Lulishte sheshi i Flamurit është shërbyer me pastrim, higjenizim, korrje sip.bari, vaditje, punim dru-shkurre, qethje shkurre-gardh i gjelbër, krasitje palmash, fshirje rrugë e sheshe, pastrim fugash, larje të shkallëve e shesheve, punim toke për mbjellje lulesh, mbjellje lulesh, çapitje, plehrim, zvendësim të luleve të vjedhura, krasitje pishave të mëdha.

Lulishte te 4 topat është shërbyer me pastrim, higjenizim, plehrim, korrje sip.bari, punim dru-shkurre, plerim kimik, vaditje me bot.

Universiteti është shërbyer me pastrim, higjenizim, korrje sip.bari, pastrim fugash, punim dru, shkurre, krasitje shkurresh për t'u dhënë formën e duhur, krasitje palmash+spërkatje, fshirje rrugë e sheshe, mbjellje lulesh, vaditje, plehrim kimik.

Rruga Sulejman Delvina është shërbyer me pastrim, korrje sip. bari, pastrim fugash, punim dru -shkurre, krasitje dru-shkurre, pastrim trotuari nga barërat e këqija, vaditje me bot, spërkatje drurësh, prerje e pemëve të thata.

Ballkoni i Vlorës është shërbyer me pastrim, higjenizim, korrje sip.bari, plerim kimik.

Lulishte Posta e Çoles është shërbyer me pastrim, higjenizim, korrje sip. bari, punim dru – shurre-gardh i gjelbër, qethje gardh i gjelbër +shkurre, prerje e pemëve që rrezikonin përballë me tregun.

Shkollat dhe kopshtet e qytetit është shërbyer në të gjitha shkollat e kopshtet me korrje sip.bari, punim dru –shkurre, plehrim kimik, qethje shkurresh e gardhesh të gjelbër, mbjellje fidanësh të rinj, krasitje drurësh e palmash. Me nje sip totale, sip bari 90000 m², dru dekorativ 3000, palma 201, shkurre 2000 rrënjë, fidanë të rinj të mbjellë së fundmi 250 fidanë pisha, 36 rrënjë dru dekorativ.

Në Fidanishte punohet me pastrim territori nga barërat e këqija, punim drurësh, krasitje formuese, mbushje qeskash për transportim fidanësh, mbushje kubikësh me lule për përgatitje për qytet, prodhim fidanësh me farë e me kalema, mbjellje farishtesh me lule e bimë të ndryshme dekorative, përgatitje kurorash me raste festash të ndryshme, vaditje të bimësisë etj.

Lapidari në Babicë punohet me korrje sipërfaqe bari, plehrim kimik, punim gardh i gjelbër, punim drurësh.

Lulishte Shkolla e Marinës është punuar me pastrim të sip.të gjelbërt, vaditje, korrje sip.bari, plehrim kimik, riparim impiantesh.

Bulevardi Vlorë –Skelë është shërbyer me pastrime, fshirje, punim drurësh, punim gardh i gjelbër, spërkatje të bimësisë dekorative, çapitje lulesh, korrje sip.bari te Xhamia, plehrim kimik, krasitje gardh i gjelbër.

Duke filluar që nga muaji Maj deri në fund të muajit dhjetor, Sektori i Gjelbërimit ka qenë i angazhuar me: Pastrim të Pyllit të Sodës, pastrim të koshave në Bulevard (2 herë në ditë), pastrim të mbeturinave jashtë dhe brenda koshave në Lungomare dhe rr. Sulejman Delvina (çdo ditë prej orës 17 deri në orën 23) rreth 500 ton mbetje, larje të trotuarëve duke filluar nga Qendra Historike, Bulevardi Vlorë –Skelë, Lungomare, terrenet sportive, rruga Jeronim De Rada, rruga nga Kalaja në Orikum, larje të shtërvaneve. Duke ju bashkuar dhe nismës për një Shqipëri të pastër aksionet e pastrimit nuk janë ndalur në zona të ndryshme të qytetit.

Emërtimi	njësia	sasia	Volume pune të kryera në shërbim të sip.të gjelbërta sipas zërave
Lule	m ²	4907	15000 m ²
Bar	m ²	216736	220000 m ²
Dru dekorativ	Rrënjë	11750	11700 rrënjë
Palma	Rrënjë	895	895 rrënjë
Shkurre	Rrënjë	6232	6200 rrënjë
Rrugë e sheshe	m ²	31797	950000m ²
Gardh i gjelbër	ml	14571	15500 metër linear
Transport mbeturinash	rrugë	10 ton mbetje në ditë	2700 ton mbetje

Aksionet e Pastrimit janë Paraqitur në tabelën më poshtë:

Vendi ku u zhvillua zona	Data e zhvillimit	forcat e punes	volumet
			Nr.thasë--inerte(ton)
Pylli I sodës	07.11.2021	84	300thasë ,12 ton
Krah shkollës Ali Demi	08.11.2021	20	50 thasë,7.2 ton
Rr.Dhimitër Konomi	09.11.2021	65	100thasë,3.6 ton
Stadiumi	10.11.2021	15	50thasë,6 ton
Rr.Ramize Gjebrea	11.11.2021	75	300 thasë,14.4 ton
Skelë,në brendësi të pallateve	12.11.2021	15	50thasë,3.6 ton
Sheshi I flamurit,rr.tunel-kala	13.11.2021	84	100 thasë,8.4 ton
heqje mbeturinash ne qytet	14.11.2021	10	inerte 9.6 ton
Qendra historike(inerte)	15.11.2021	14	12ton
Qendra historike(inerte)	16.11.2021	14	12 ton
Rr.Vlore-Panaja	17.11.2021	84	300 thasë,3.6 ton
Rr.Vlorë-Panaja	18.11.2021	30	100 thasë
Novoselë	19.11.2021	10	100 thasë
Novoselë	20.11.2021	10	50 thasë
Bestrovë	22.11.2021	30	100thasë,12 ton
jani minga,hapesir midis pallateve	23.11.2021	15	150,16.8 ton
pallati I kultures(sherbime te ndryshme	24.11.2021	20	50 thasë,7.2 ton
rruga e Çipajve(pastrim dhe mbjellje)	25.11.2021	30	3.6 ton
shkak I shirave te shumt (anullua)	26.11.2021		
punim dhe pastrim sheshi I flamurit	27.11.2021	20	7.2 ton
larje me lavazho,pallati I kultures	27.11.2021	6	500m2
larje me lavazho,sheshi I flamurit	27.11.2021	6	300m2
heqje balte dhe larje te bobinazhi	28.11.2021	15	12 ton
heqje balte dhe larje te bobinazhi	29.11.2021	15	12 ton
pastrim I trotuareve dhe plazhit nga mbetjet	29.11.2021	35	18 ton
fshirje trotuaresh ne skele,sheshi ne lungomare	30.11.2021	20	7.2 ton

Menaxhimi i Klubit Shumësportësh “Flamurtari”

Përgjatë vitit 2024 kanë vazhduar aktivitetet zyrtare në Pallatin e Sportit Flamurtari dhe puna për përfaqsimin sa më të denjë të Klubit dhe Bashkisë Vlorë dhe për arritjen e objektivit të përbashkët të masivizimit të sporteve dhe përfshirjen e sa më shumë të rinjve në to.

- Ekipi Femrave në Basketboll të rritura ka fituar Kupë e Shqipërisë më 24 Janar 2024 dhe ka zënë vendin e dytë në Kampionatin Kombëtar për sezonin 2023-2024. Ekipi ishte pjesë e Ligës Unike, kampionat i përbashkët i Federatës Shqiptare të Basketbollit dhe Federata e Basketbollit të Kosovës duke u renditur në vendin e pestë. Më datë 08/10/2024 ekipi ka fituar Superkupën e Shqipërisë. Në muajin Tetor ka startuar Kampionati

Kombëtar 2024-2025 ku ekipi ka fituar te gjitha ndeshjet e zhvilluara. Në muajin Nentor ka startuar kampionati i Liges Unike 2024-2025

- Ekipi i Basketbollit meshkuj të rritur në sezonin 2023-2024 përfaqëson klubin në Superligë ku sipas klasifikimit renditen në vendin e gjashtë. Ne muajin Tetor ka filluar Kampionati Kombëtar per sezonin 2024-2025 ne te cilin ekipi ka patur paraqitje dinjitoze dhe vazhdon stervitjen intesive per arritjen e objektivave ne kete sezon.
- Ekipet zinxhir të basketbollit U18, U16 për femra dhe U18, U16 për meshkuj janë pjesë e Kampionatit Kombëtar për mosha.
- Ekipi Volejbollit Femra në kampionatin e sezonit 2023-2024 ka marë vendin e dytë në Kampionatin Kombëtar dhe është pretendent për të fituar Kupën e Shqipërisë për Kategorinë e parë. Ne muajin Tetor ka startuar Kampionati Kombëtar per sezonin 2024-2025 dhe vazhdon puna intesive per fitoren e kampionatit.
- Ekipi i Volejbollit femra U18 në sezoni 2023- 2024 ka nisur me përfaqësim të denjë për moshat U 18 dhe U 16, duke na bërë të jemi ekip pretendent për kryesimin e kampionateve,
- Ekipi i Minifutbollit (Futsal) është shpallur kampion në sezonin 2023-2024. Vazhdon pergjate gjithe vitit per gatitje intesive per mbajtien e titullit kampion dhe per sezonin 2024-2025.
- Ekipi i Kickbox ka arritur të mbrojë titullin kampion Bote, dhe pregatit sportistë të talentuar të cilët përfaqësojnë klubin në cdo kompeticion sportiv.
- Ekipi i Mundjes ka marë pjesë në të gjitha aktivitet e organizuara nga Federata Shqiptare e Mundjes për vitin 2024. Ne Kampionatin Kombetar te zhvilluar ne datat 8 dhe 9.11.2024 sportisti Kelsi Nelaj u shpall kampion Kombetar ne kategoria 87 kg.
- Sportistët e ekipit të Boksit kanë përfaqësuar denjësisht klubin duke i sjellë titujt e vendit të parë për moshat dhe Kampionatit të Boksit për të rritur. Ne Kampionatin Kombetar Elite sportisti Ariol Zeneli u shpall Kampion.
- Në disiplinën e atletikës vazhdon pregatitja e sportistëve për këtë sezon, gjithashtu dhe në ekipin e peshëngritjes me synim shpalljen e sportistëve tanë kampion. Ekipi i qitjes falë punës së vahdushme vazhdon evidentimin e sportistëve të rinj dhe pregatitjen e tyre për kompeticionet në këtë disiplinë ne daten 03 Nentor ne Durres u zhvillua gara e 12 me te mireve ku ekipi i qitjes Flamurtari u paraqit ne nivele te larta. Sportistja Najka Mustafa mori medaljen e arte; Deisi Gjeca medalje te arte ne pushke meshkuj. Ne daten 23 Nentor ekipi ka mare pjese dhe ne Kupon Pavaresia ne qytetin e Elbasanit.

Ekipi i shahut, taekwondo, karate vazhdojnë përgatitjet për sezonin 2024-2025.

- Në kuadër të titullit “Vlora, qyteti European si sportit 2024”, Klubi Shumësportësh “Flamurtari”, është pjesë organizative e aktiviteteve sportive të organizuara në qytet, duke filluar me kampionatin Street Basket 3x3 organizuar në Lungomare me pjesëmarrjen më 23 Mars me pjesëmarrjen e sportistëve nga i gjithë ballkani ku kampione në kategorinë për femra u shpallë ekipi i Flamurtarit, organizimin e finaleve të Liga Unike Lajthiza më datat 27-28-29 Mars në ambientet e Pallatit të Sportit, organizimin e aktivitetit Night of the Champions më 13 Prill në ambientet e Pallatit të Sportit ku kampion u shpallën 2 sportista që përfaqësonin ekipin e Flamurtarit, organizimin e Maratona Vlora Run 2024 më 21 Prill dhe organizimin e Mountain Bike Kanina më 27 Prill 2024. Më datat 07-11 Maj 2024 organizua “Festivali Sportiv”, me 9 disiplina sportive ku dy prej kampionateve, përkatësisht Kampionati i Qitjes Sportive dhe Kampionati i Bokst u zhvilluan në ambientet e Klubit Shumësportësh “Flamurtari”, sportistët e Klubit ishin pjesëmarrës dhe garues në të 9 disiplinat sportive të organizuara. 7-8-9 Qershor pjesë organizative e “Vlora Open Beach Volley 2024”, pjesëmarrës ekipe nga e gjithë Shqipëria dhe përfaqësues të qytetit ekipet e organizuara me sportistët e Klubit Shumësportësh “Flamurtari”. 19-20-21 Korrik 2024, “Steka e Artë 2024”, Klubi Shumësportësh “Flamurtari”, pjesë organizative dhe përfaqësuar ekipin e Vlorës me Ekipin e Bilardos. 2-3 Gusht “Summer Up” Festivali Sportiv një aktivitet i larmishëm për të gjitha grupmoshat me pjesëmarrjen e sportistëve nga e gjithë Shqipëria ku sportistët e Klubit fituan cmime të para dhe të dyta në sportet e Beach Volley, Notë, Ping Pong, Street Basket, Shah.

Përgjatë muajit Nëntor të vitit 2024 kanë vazhduar aktivitetet zyrtare në Pallatin e Sportit Flamurtari dhe puna për përfaqsimin sa më të denjë të Klubit dhe Bashkisë Vlorë dhe për arritjen e objektivit të përbashkët të masivizimit të sporteve dhe përfshirjen e sa më shumë të rinjve në to. Aktivitetet e zhvilluara përgjatë muajit Nëntor janë:

- Kupa Pavarësia në Karate, me pjesëmarrjen e ekipeve sportive nga Shqipëria dhe rajoni ku garuan 270 sportiste te grupmoshave.
- Kampionati Kombëtar i Taekwondo me pjesëmarrjen e 6 ekipeve ku garuan 100 sportiste. Orion Kamberaj sportisti i ekipit të Flamurtarit u shpallë kampion në kategorinë 12-14 vjeç dhe 9 sportiste nga mosha 9-12 vjeç u shpallën kampione.
- Kupa Pavarësia Basketboll U16 u realizua me pjesëmarrjen e 6 ekipeve dhe 72 sportistëve. Ekipi i vajzave Flamurtari basketboll U16 shkoje në finale me ekipin e Fierit dhe doli në vend të dytë.

Me datë 14 Dhjetor 2024 në ambientet e Pallatit të Sportit “Flamurtari” u zhvillua Night Of The Champions 11, kampionati i KickBoxing me pjesëmarrjen e sportistëve të huaj dhe sportistëve të flamurtarit në këtë disiplinë.

Projekti	Plani vjetor	Fakt 01.01.2024-31.12.2024
Ekipi basketbollit meshkuj te rritur	5,950,000	5,950,000
Ekipi basketboll meshkuj te rinje	300,000	295,875
Ekipi basketbollit femra te rritura	10,000,000	9,976,165
Ekipi basketbollit femra te reja	300,000	300,000
Ekipi I volejbollit femra te rritura	2,500,000	2,492,965
Ekipi I volejbollit femra te reja	400,000	388,880
Ekipi I boksit	4,250,000	4,250,000
Ekipi I ciklizmit	1,000,000	998,125
Ekipi I mundjes	1,200,000	1,200,000
Ekipi I Ping Pong	300,000	291,875
Ekipi I peshengritjes	800,000	798,750
Ekipi I karatесе	300,000	300,000
Ekipi I minifutbollit	4,000,000	4,000,000
Ekipi I qitjes	800,000	798,750
Ekipi I taekwondo	300,000	300,000
Ekipi I bilardos	700,000	696,750
Ekipi I atletikes	300,000	278,750
Ekipi I shahut	350,000	346,250
Ekipi I kickbox	1,500,000	1,498,750
Ekipi futboll femra	300,000	278,750
Ekipi I notit	600,000	600,000
Projekte Shtesë	368,500	368,500
Energji elektrike	550,000	550,000
Ujë	230,000	215,627
Telefoni+ Sherbim interneti	80,000	52,800
Shperblime per ekipe dhe individ kampion	350,000	280,000
Grumbullim te ekipeve per trofe	700,000	675,631
Federime+ Gjyqtari sportive	3,500,000	3,409,125
Shpenzime te paparashikuara	100,000	61,156
Shpenzime publicieti	650,000	643,100
Udhetime dhe dieta personeli	200,000	106,311
Riparime te vogla+ shp. Te tjera	1,000,000	870,935
Materiale sportive	600,000	588,542
Sigurimi I lojtareve	300,000	300,000
231 Paisje teknike, tabela elektronike, Pc	1,000,000	0
Shpenzime bileta udhetimi transferim lojtaresh te huaj	300,000	283,764

1. Projekti : Teatrin “Petro Marko”

Duke u nisur nga qëllimi kryesor i punës për Teatrin “Petro Marko”, pasurimin e jetës artistike e kulturore në qytetin e Vlorës, dhe referuar shkresës suaj nr. 635 prot, datë 15.01.2025 ju paraqesim aktivitetin e këtij Institucioni për periudhën 01 Janar 2024 - 31 Dhjetor 2024 si më poshtë:

JANAR 2024

1. “Estrada e të rinjve (Jemi dhe ne)”, me regji të Artan Islamit. Interpretojnë : Anteo Salikaj, Gabriela Azizaj, Gentjan Këllici, Dajana Shehaj, Fabian Duro, Albano Merkaj, Justinian Kissi, Emanuela Selimaj, me mbështetjen e Bashkisë Vlorë. Kjo estradë pati shumë sukses dhe u duartrokit për 3 netë në Teatrin “Petro Marko”, gjatë muajit Dhjetor 2023, dhe u vendos përsëri në 19 Janar 2024.
2. Koncert “Fausto Leali”. Grupi i njohur italian, me mbështetjen e Bashkisë Vlorë më 26 Janar 2024 mbajti një koncert në Teatrin “Petro Marko”. Koncert që pati një pjesëmarrje të jashtëzakonshme .

SHKURT 2024

3. Në teatrin “Petro Marko” u zhvillua ceremonia e dhënies së titullit “Nderi i Qytetit” për ekipin e futbollit Flamurtari të viteve 80-90 në datën 10 Shkurt 2024.
4. Komedia “Një vrasje e vogël aksidentale” me regjit të Marigona Bektashi Ferati, e sollën në skenë aktorët Fisnik Ademi, Irena Aliu, Qendesa Kajtazi, Artan Hetemi. Komedi e duartrokitur u shfaq me shumë sukses në datën 22 Shkurt 2024 në teatrin “Petro Marko”.

MARS 2024

5. Koncert i pianistit Red Radoja, artisti me repertor të kompozitorve francez mbajtur më 1 Mars 2024.
6. Mirënjohje për Artistët e Kinematografisë Shqiptare “Ibrahim Mucaj dhe Kristaq Mitro”, me Regji të Kristaq A.Skrami , Dirigjent Oleg Arapi, me pjesëmarrjen e aktorëve të mëdhenj Timo Flloko, Rajmonda Bulku, Ndricim Xhepa, Kristaq A.Skrami më 3 mars 2024.
7. Komedia “Natën e mirë me burrin tim”,një komedi e viteve të fundit, me regji të Jorgaq Tushe, shfaqur me shumë sukses në teatrin “Petro Marko” , në datat 8,9,10,12,13,14,15,16,17,22,23,24 Mars 2024. E luajtur nga trupa e aktorëve Artan Islami , Matilda Avduli, Ermir Hoxhaj, Eljona Thomaraj, Roland Minga , Alba Shtëmbari dhe Loris Sinaj.
8. Koncert “Le Interviste Impossibli”, interpretoi Idalberto Fei dhe Eldorado Siravo, gjithashtu dy artiste italiane Gabriella Casali dhe Cloris Brosca në bashkëpunim me Konsullaten Italiane Vlorë, i mbajtur më 27 mars 2024.

PRILL 2024

9. Në datat 16, 17 dhe 18 Prill 2024 u shfaq me shumë sukses drama e trishtë “Elektra” nga Sofokliu, me regjizor Kico Londo, As/Regjisor Olgert Mataj, Greta Baci, Kevin Rrapaj, me artist të mëdhenj Laura Nezha, Alert Celoliaj, Gladiola Harizaj, Denisa Demaj, Engjell Hoxha, Medi Gurra, Asiana Koka, Melisa Manuka, Suela Prendi, Greta Baci, Kevin Rrapaj.
10. Trupa “Star Danc Academy” organizoi konkurs kërcimi modern, mbajtur më 20 Prill 2024.
11. Në “Ditën botërore të librit” u organizua një aktivitet me pjesëmarrjen e klasave të 9-ta të shkollave “Lef Sallata” dhe “Muço Delo”, zhvilluar në datë 23 Prill 2024.

MAJ 2024

12. “Fest Art 2024” Një spektakël i përvitshëm i talenteve të reja, nën vëzhgimin dhe trajnimin e profesionistëve më të mirë të fushës si dhe organizimin e Teatrit “Petro Marko” në bashkëpunim me Zyrën Vendore Arsimore Vlorë. Në përfundim të konkursit pati dhe çmime e vlerësime për artistët e rinj.
U zhvillua në datat 7 dhe 8 Maj 2024 me talentet më të spikatura në të gjitha shkollat e mesme dhe klasave të 9 – ta të shkollave 9-vjeçare të qytetit në zhanrin e këngës dhe kërcimit modern.
13. Data 9 Maj 2024 në Teatrin “Petro Marko”. Shfaqje muzikore dhe poezie në italisht dhe arabisht frymëzuar nga romani “Një mijë e një net” u soll nga dy artistet e talentuara Valeria Almeringhi dhe Sara Bezzi për artëdashësit vlonjatë, koncertin e titulluar “Le Due Lune” me autor, regjisor dhe dirigjent Damiano Giuranna në bashkëpunim me Konsullatën Italiane Vlorë.
14. Datë 11-12 Maj 2024, “Tom & Jerry” Teatër për fëmijë me dy aktor fantastik Aleksandër Kondi dhe Jaho Guma që pati shumë pjesëmarrje në sallën e teatrit “Petro Marko” nga vogëlushët. Për dy ditë resht aktorët e talentuar dhuran të qeshura pa fund për fëmijët e vegjël.
15. Koncerti “The Best” pati gjithashtu shumë pjesëmarrje në sallën e teatrit “Petro Marko” me regji të Elvira Hoxhara dhe drejtimin të Oleg Arapi në bashkëpunim me institucionin arsimor jopublik Elite më 16 maj 2024.
16. Mirënjohje për Artistët e Kinematografisë Shqiptare “Piro Milkani”, me regji të Kristaq A.Skrami dhe dirigjent Oleg Arapi, me pjesëmarrjen e aktorëve të mëdhenj Timo Flloko, Rajmonda Bulku, Ndricim Xhepa, Kristaq A.Skrami. I ftuar Nik Xhelilaj, mbajtur më 18 Maj 2024.
17. “Rinia larg dhunës së bullizimit dhe gjithpërfshirja në aktivitete kulturore” që pati shumë pjesëmarrje në sallën e teatrit “Petro Marko”. Ky aktivitet u organizua në datë 19 maj 2024 në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë me pjesëmarrjen e pesë shkollave të konkursit “Teatër”
18. Comedy-Bar “Stand-UP” me pjesëmarrjen e Gent Hazizai dhe Besnik Mustafaj u duartroi nga publiku vlonjat më 24 maj 2024.
19. Koncert “Omagio a Battiato” ku u luajtën muzikë me vepra të autorëve të shquar, në bashkëpunim me Konsullatën Italiane Vlorë, i mbajtur më 30 maj 2024.
20. Komedi “Gruaja e burrit tim” me regji të Kiço Londo, As Regjisor Olgert Mataj. Falë aktorëve të mrekulleshëm të zgjedhur me kujdes shfaqja pati shumë sukses në teatrin

“Petro Marko”, dhënë për artdashësit vlonjatë për dy ditë në datat 31 maj-1 qershor 2024.

QERSHOR 2024

21. “Rroftë Parodia” (Kur qajnë Komikët) Recital i Parodistëve e Vlorës, dy artistë të jashtëzakonshëm që na mbajtën peshë me humorin e tyre brilant përgjatë tre netëve 7-8-9 qershor 2024.
22. Antonio Motcia Modica & Lee Curreri, muzika Italiane 40 anni di “Fame – Saranno Famosi” në bashkëpunim me Konsullaten Italiane Vlorë, i mbajtur më 13 Qershor 2024.
23. Melodia e Stineve , konkurs kërcimi për fëmije me 15 Qershor 2024
24. Miss & Mister Turizmi me producente Myzejen Konduri u zhvillua më 16 Qershor 2024 në Teatrin “Petro Marko”
25. “Thuaj Këngës Rini”, aktivizim rinor i shprehur përmes artit nga Këshilli Vendor Rinor dhe të rinjtë e Vlorës më 21 Qershor 2024.

KORRIK 2024

26. “Show Veror 2024”, në qendrën historike të qytetit të Vlorës lagjja Muradie, 11 Korrik 2024.
27. “Show Veror 2024”, Lungomare, 26 Korrik 2024

GUSHT 2024

28. “Show Veror 2024”, Orikum, 7 Gusht 2024.

SHTATOR 2024

29. Me rastin e Ditës së Shënjtërimit të Nënë Terezës më 5 shtator 2024, Kori i Filharmonisë së Kosovës, nën drejtimin e dirigjentit Rafet Rudi, ndriçoi skenën e teatrit “Petro Marko”. Programi përfshiu vepra nga kompozitorë të njohur si Jan Sandström, Baki Jashari, Vasil Sofokli Tole, Lorenc Antoni, Jake Runestad, Claudio Monteverdi, Aulon Naçi dhe Rafet Rudi.
30. Koncert Jubilar me rastin e 85 vjetorit të lindjes së prof. Robert Papavrami nga Qendra Kulturore “Resonance” Vloraphilharmony , “Let it be music Vlorë” me drejtor artistik dirigjent Thanas Caci i mbajtur në 12 Shtator 2024.

TETOR 2024

31. Koncert “Kori i Karditsas” nën drejtimin artistik të Nikos Efthimiads, në piano Lila Violetta Soussi në bashkëpunim me Ambasadën Greke në Shqipëri, i mbajtur më 9 Tetor 2024.
32. Koncert “80 vjetori i Çlirimit të Vlorës”, me pjesëmarrjen e Orkestrës, solistët dhe valltarët e Ansambllit të Këngëve dhe Valleve Popullore më datë 15 Tetor 2024.
33. Mbrëmje Poetike “Ah ky mall, ky mall i çmendur” kushtuar diplomatit dhe kryebashkiakut të viteve '20-'30 të shekullit XX, Ali Asllani i mbajtur më 17 Tetor 2024. Aktivitet i cili pati pa fund duartrokitje nga salla.

34. Shfaqja “Sonetet e Shekspirit” me regjizor Kristaq A.Skrami .Me grupin aktorëve më të spikatur të teatrit “Petro Marko”. Shfaqja pati shumë sukses në teatrin “Petro Marko”,për 5 ditë në datat 19 Tetor- 27 Tetor 2024.

NENTOR 2024

Në vijim Java Festivali Teatror “Shekspiri zbret në Vlorë” gjatë muajit Nëntor ka qënë e mbushur me shfaqje, koncerte duke filluar me:

35. Komedia “Masë për masë”e celi trupa e teatrit të Gjakovës “Hadi Shehu”dhe teatrit të Prizrenit “Bekim Fehmiu” me regji të Altin Bashës për 1 ditë 9 Nëntor 2024.
36. Shfaqja “Remeo e Xhuljeta”, ”Zbutja e Kryeneçes”, ”Nata e dymbëdhjetë”, dhe “Shumë zhurmë për asgjë” për 1 ditë 10 Nëntor 2024.
37. Shfaqja “Sonetet e Shekspirit” me regjizor Kristaq A.Skrami me grupin aktorëve të teatrit “Petro Marko”më të spikatur u mbajt 1 ditë 11 Nëntor 2024.
38. Shfaqja “Nata e dymbëdhjetë” me regji të Justin Anderson me një grup artistësh u mbajt 1 ditë 12 nëntor 2024.
39. Shfaqja “The Lost King” interpretoi Franco Ferrante në bashkëpunim me Konsullatën Italiane Vlorë, 1 ditë 13 Nëntor 2024.

Organizatorët e Festivalit Teatror të Shekspirit "Shekspiri zbret në Vlorë", Bashkia Vlorë, "Shekspir Center" dhe Teatri "Petro Marko", në ditën e fundit të Edicionit të Parë, nderuan me Çertifikatë Mirënjohjeje për karrierën e tyre të gjatë artistike në skenën e Teatrit Shqiptar aktorët e mirënjohur të Teatrit dhe Filmit Shqiptar Margarita Xhepa, Robert Ndrenika dhe aktorin e Teatrit "Petro Marko" Vlorë, të ndjerin Vasillaq Godo, një nga themeluesit e këtij Teatri. Kjo Çertifikatë u shoqërua edhe me një bust të William SHEKSPIR si simbol artistik i këtij Festivali Teatror.

Busti i Shekspirit është punuar me mjeshteri nga Skulptori i mirënjohur Edmond RIRA.

40. Shfaqja “Romeo & Zhuljeta” me regji të Dajana Nenaj me grupin e aktorëve sollën artin skenik në një audience të re nëpërmjet një qasjeje moderne u dha për 1 ditë në 14 Nëntor 2024.
41. Një bisedë me Dr. Anxhela Çikopano “Rebelimi ndaj institucionit arkivues si shuarje e kujtesës kolektive” pati debatin publik e organizuar Qendra e Studimit të Arteve dhe me mbështetjen e bashkisë Vlorë u mbajt 19 Nëntor 2024.
42. U zhvillua takim letrar “Atdheu ne vargjet e poeteve Vlonjatë”, pati duartrokitje të pjesmarësve artdashës vlonjat 20 Nëntor 2024 .
43. Një tjetër aktivitet përgjatë javës ishte koncert muziko-teatral “Mundësi pa Kufi“ interperetoi Alda & Blerina Shalari, i ftuari special Dritan Borici ,për 1 ditë 20 Nëntor 2024.
44. Festival “Shkronjat në Pentagram” përgjatë javës së festimeve të 112 vjetorit të Pavarsisë ishte edhe Ekspozita në hollin e Teatrit “Petro Marko” nga piktor të vegjël të shkollave 9-vjeçare të qytetit te Vlorës 21 Nëntor 2024, e cila u vizitua me mjaft interes .
45. Koncerti Jubilar i “80-Vjetori i Çlirimit“, në bashkëpunim me QKF me rastin e festave ku pati pjesmare gjithashtu u shoqerua me duartrokitje nga salla.
46. Një tjetër koncert “Nëntori i një Filmi” ku pati muzikë nga filmat me tematikën e festave, organizuar nga “SinfoArt” dhe teatri “Petro Marko” më 28 Nëntor 2024.
47. Data 29 Nëntor 2024 ,Koncert “Kur çelin bozhuret” për 80 vjetorin e Çlirimit e organizuar nga teatri “Petro Marko” dhe Qendra e Kulturës Vlorë.

DHJETOR 2024

48. Data 04 dhjetor 2024 ,një koncert recital,në Piano Ema Jaupi,luajti pjesë nga J.S.Bach, F.J.Haydn, C.Zadeja, F.Chopin, L.V.Beethoven u shoqerua me duartrokitje të shumta nga salla.
49. Data 7 dhjetor 2024 Koncert “Ekone Trio” në Piano Edlira Braka e shoqëruar me dy artistë, në saksofon Valentino Arrayet dhe Malo Linsofon. Pati duartrokitje të shumta nga salla.
50. Data 11 dhjetor 2024 ,Koncert “Jean Michel Ferra”.
51. Data 13 dhjetor 2024,“Koncerti i Krishlindjes” koncert me këngët më të njohura të Krishtlindjes nga kompozitorët më të mirë J.Rutter, M.Frisina, J.Wade, A.Adams, J.Williams, G.F.Handel.
52. Koncert “Aperitivo Italiano” ku u luajtën muzikë me vepra të autorëve të shquar, në bashkëpunim me Konsullatën Italiane Vlorë, i mbajtur më 14 dhjetor 2024.
53. Koncert “Gëzuar 2025” pati shumë pjesëmarje në sallën e teatrit “Petro Marko” në bashkëpunim me institucionin arsimor jo-publik Drita e Dijes, i mbajtur më 18 dhjetor 2024.
54. “Koncert i Krishlindjes” pati shumë pjesëmarje në sallën e teatrit “Petro Marko” me regji të Elvira Hoxhara në hollin e teatrit u zhvillua dhe ekspozitë pikturë e institucionit arsimor jopublik Elite i mbajtur më 19 dhjetor 2024.
55. Shfaqja “Agnesa e Zotit“ me regji të Kiço Londo, e sjellin në skenë aktoret Eni Jani, Laura Nezha, Vjoleta Trebicka. U shfaq me shumë sukses në datën 20 dhjetor 2024 në teatrin “Petro Marko”.
56. Shfaqje me rastin e festave të fundvitit në Spitalin “Ali Mihali”. Të ftuar dy Parodistët e Vlorës, dy artistë të jashtëzakonshëm, gjithashtu artistët e muzikës të teatrit “Petro Marko” R.Brahimi, V.Tahiraj, L.Baballëku një shfaqje që pati shumë duartrokitje dhe dashuri nga ata njerëz që kanë nevojë të përfshihen me ndjenjat dhe emocionet që sjell arti. Ky aktivitet u zhvillua në datë 22 dhjetor 2024.
57. Koncert nga Global Dance “Një mesazh Krishtlindje” pati pjesëmarje të shumtë gjithashtu u shoqërua me duartrokitje të shumta, i mbajtur më 23 dhjetor 2024
58. Koncert i organizuar nga Q.K.F “Treni i dhuratave”, i mbajtur më datë 26.12.2024 në Teatrin “Petro Marko”.

Aktiviteti i madh përmbyllës i gjithë aktiviteteve të vitit, me datë 27.12.2024, me ide dhe organizim nga Teatri “Petro Marko” dhe me mbështetjen e Bashkisë Vlorë u organizua Mbrëmja "Gala e Fundvitit", që solli në skenë koloset e muzikës dhe skenës shqiptare, soprano Ardita Meni dhe tenorët Kastriot Tusha e Josif Gjipali dhe dy artistët Renis Gjoka dhe Ina Morinaj

Spektori i Arsimit, Rinisë dhe Sportit

Mbi analizën e punës për periudhën 01.01.2024- 31.12.2024

Spektori i Arsimit, Rinisë dhe Sportit funksionon në bazë të Ligjit nr.69/2012 i ndryshuar, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr.139/2015 dt.17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, V.K.M. nr.666, dt 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për

nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, VKM 511 dt. 27.07.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa të VKM 666”, Udhëzimit nr. 26, dt 25.11.2019, “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”, VKB-ës nr.97, dt 28.12.2020 “Plani i përmisimit të shërbimit të arsimit parashkollor në Bashkinë Vlorë”, Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, Ligji nr.9863, dt 28.01.2008 “Për ushqimin”, Udhëzimit, nr.22, dt 25.11.2010 “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor, Ligji nr.74/2013, dt 14.02.2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9863, dt 28.1.2008 “Për ushqimin”, të ndryshuar, Ligji nr.79/2017 “Për Sportin” (i ndryshuar) me ligjin 105/2020 dt.29.07.2020, Ligji nr.79/2019 dt 04.11.2019 “Për Rininë”.

-Bazuar në VKB-në nr.97, dt. 28.12.2020 “Plani i përmisimit të shërbimit të arsimit parashkollor në Bashkinë Vlorë” janë kryer kontrole të paplanifikuara në kopshtet dhe çerdhet në territorin e Bashkisë Vlorë për zbatimin e orarit të punës, menaxhimin, kujdesin ndaj fëmijës.

- Staf për organizimin dhe mbarëvajtjen e çdo evenimenti të “Vlora, Qyteti European I Sportit 2024” gjatë gjithë vitit 2024.

-Ngritja e një grupi pune brenda sektorit për analizën e situatës në kopshtet e Bashkisë Vlorë.

-Bazuar në Urdhërin e Brendshëm nr.4 dt 10.01.2023 dhe Urdhërit të brendshëm nr 119 datë 26.04.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit edukativ individual për fëmijët me aftësi të kufizuara”, mbikqyr komisionin i cili ka përditësuar planin PEI për 44 fëmijë me aftësi të kufizuara në kopshtet e bashkisë Vlorë, në bashkëpunim me mësueset mbështetëse (përditësimi çdo 3 muaj).

-Bazuar në Urdhërin e Brendshëm nr.283 dt 18.07.2024 “Ngritjen e komisionit për monitorimin e tregut për përcaktimin e listës dhe çmimeve të mjeteve didaktike për nevojat e kopshteve dhe çerdheve të Bashkisë Vlorë”, është ngritur komisioni për monitorimin e çmimeve të tregut për mjetet didaktike në kopshte dhe çerdhe.

- Në bashkëpunim me Zyrën Vendore Arsimore Vlorë–Himarë ka organizuar dhe finalizuar aktivitetin e festës së mësuesit. U nderuan 38 mësues me titullin “Mirënjohje e Qytetit”.

- Pjesë e grupit organizues të aktivitetit “Dita e Verës”.

-Është zhvilluar procesi i mbledhjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit të bonusit financiar të nxënësve ekselentë të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme që aplikojnë në Bashkinë Vlorë. Janë trajtuar për vitin shk. 2023-2024 me bonus financiar 134 nxënës në shkollat 9- vjeçare publike dhe 128 nxënës në shkollat e mesme të përgjithshme publike.

-Pjesëmarrje në grupin e punës me Urdhër të Brendshëm nr 285 dt 22.08.2023 “Mbi ngritjen e grupit të punës për inventarizimin dhe arkivimin e dokumentacionit të Sektorit të Prokurimeve”

-Mbledhje, përpunim dhe sendërzim të të dhënave mbi problematikat infrastrukturore dhe bazë materiale në IA-të dhe çerdhet e bashkisë Vlorë

-Bazuar në Ligjin nr.69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, VKB-ës nr.97, dt. 28.12.2020 “Plani i përmisimit të shërbimit të arsimit parashkollor në Bashkinë Vlorë”, ndiqet procesi i regjistrimit të vazhdueshëm në kopshte dhe çerdhe, si dhe adresimi i problematikave.

-Bazuar në Urdhërin e Brendshëm Nr.450, dt. 11.12.2023 “Për një ndryshim në Urdhërin nr.3 dt 07.01.2020 mbi ngritjen e komisionit për kolaudimin e mallrave ushqimorë, industriale dhe

elektrike” është kryer kontroll ditor i ushqimit për çerdhet, kopshtet pranë magazinës së Qendrës Ekonomike.

-Pjesë e grupit “Për ngritjen të punës, për hartimin e specifikimeve teknike dhe fondit limit të tenderit Blerje- Ushqimore” në bazë të Urdhërit të brendshëm nr.48, dt. 22.02.2024

- Kthim përgjigje institucioneve të ndryshme.

-Pjesëmarrje në trajnime dhe aktivitete të ndryshme që organizojnë drejtori të tjera të bashkisë Vlorë.

-Trajnime dhe aktivitete për rritjen e kapacitetit të KVR-s.

-Finalizim të projektit “Thuaja këngës rini” të KVR Vlorë në bashkëpunim me Fonadacionin *Qendra Evropiane* dhe AKR

-Finalizim të projektit “Panairi i punës” të KVR Vlorë në bashkëpunim me Fonadacionin *Qendra Evropiane* dhe AKR

- Ngritja e një database mbi situatën e të rinjve në territorin e bashkisë Vlorë.

- Ngritja e një database “Të rinjtë dhe sporti” në territorin e bashkisë Vlorë.

-Përditësim të dokumentacionit për kryerjen e procesit të monitorimit në kopshtet e bashkisë Vlorë në bazë të Urdhërit nr. 199 dt. 07.05.2024 " Për miratimin e kornizës së vlerësimit të cilësisë së kopshtit" dhe "Udhëzuesit metodologjik për realizimin e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të kopshtit” nga MAS

- Kryerjen e procedurave për aplikim, regjistrim të qytetarëve të cilët aplikojnë për fëmijët e tyre për herë të parë në kopshtet dhe çerdhet e bashkisë Vlorë si dhe për transferim nga një institucion në tjetrin, bazuar në VKB-në nr.97, datë 28.12.2020 “Plani i përmisimit të shërbimit të arsimit parashkollor në Bashkinë Vlorë”

- Komisioni i inventarit fizik të shkollave 9-vjeçare në bazë të Urdhërit të brendshëm nr.131 datë 02.05.2024 “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e akteve afatgjata dhe inventarit në përdorim për vitin 2023”

- Anëtar i komisionit të inventarit fizik të shkollave të mesme dhe konviktit të shkollës Industriale në bazë të Urdhërit të brendshëm nr.201 datë 07.06.2024 “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e akteve afatgjata dhe inventarit në përdorim për vitin 2023”

-Pjesë e komisionit për ndjekjen e procedurave të përzgjedhjes së subjekteve fizikë/juridikë që do të zhvillojnë aktivitete në kuadër të projekteve Vlora, Qyteti European i Sportit 2024 në bazë të Urdhërit të Brendshëm nr.66 dt.11.03.2024 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit për procedurat në kuader të aktiviteteve të Vlora Qyteti European i Sportit” dhe Urdhërin e Brendshëm nr.70 dt 18.03.2024 “Për një ndryshim në Urdhërin e Brendshëm nr.66 dt.11.03.2024”,

-Pjesë e komisionit të ekspertizës në bazë të Urdhërit të Brendshëm nr.10 dt.10.01.2024 “Për ngritjen e komisionit të ekspertizës”

-Pjesë e grupit të punës në bazë të Urdhërit të Brendshëm nr.295 dt.24.07.2024 “Për ngritjen grupit të punës për kryerjen e evidentimit, hartimit, ndjekjes gjatë zbatimit të punimeve të problematikave infrastrukturore në institucionet e arsimit para-universitar në Bashkinë Vlorë dhe Njësitë Administrative”

-Grup pune mbi vlerësimin e aplikimeve për bursë shkollore për nxënës të komunitetit Rom/Egjiptian në kuadër të projektit “Support towards employment and education members for Roma and Egyptian minority in Municipality of Vlora”

- Grup pune për hartimin e termave të referencës dhe vlerësimin e ofertave në kuadër të projektit WRECKS4ALL

- Ngritjen e grupit të punës “Për shqyrtimin e dokumentacionit të aplikuesve për kuotat financiare të ushqimit në mensa dhe konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike dhe hartimin e listës përfundimtare të aplikantëve përfitues“

-Grup Pune në bazë të Urdhërit të Brendshëm Nr.421 date 11.10.2024 “Për shqyrtimin e dokumentacionit të aplikuesve për kuotat financiare të ushqimit në mensa dhe konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike dhe hartimin e listës përfundimtare të aplikantëve përfitues“. Në total u shqyrtuan 397 aplikime nga 34 shkolla, 353 rezultojnë me dokumentacion të rregullt dhe 44 me mungesa

-Hartim relacioni dhe PVKB nr.113 prot dt. 27.12.2024 protokolluar në bashki me nr.20507 prot dt 23.13.2024 (Për miratim të bursave të shtetit për miratim të bursave të shtetit për nxënësit në arsimin parauniversitar).

- Në bashkëpunim me COD ka organizuar dhe finalizuar projektin “Edukimi nis që në hershmëri” në kuadër të festave të fundvitit.

- Ka organizuar aktivitetet me të rinjtë e Bashkisë Vlorë në kuadër të *Ditës së Rinisë*

1. Projekti : Programi i Kujdesit Social Dhe Solidaritetit

Programi: K10430 - Familja dhe fëmijët

Funksioni: Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale

DREJTORIA E NDIHMËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL

Drejtorja e Ndihmës dhe Shërbimit Social në Bashkinë Vlorë përfshin në strukturën e saj 5 rajonet e bashkisë qytet si dhe katër Njësitë Administrative përkatësisht Njësia Administrative Qendër, Njësia Administrative Orikum, Njësia Administrative Novoselë si dhe Njësia Administrative Shushicë. Gjithashtu në strukturën e saj, drejtorja ka edhe Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve, Njësinë e Dhunës në Familje, Njësinë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rasteve, Sektorin e Barazisë Gjinore, Shërbimin Mbështetës për Fëmijët dhe Familjet, si dhe Sektorin e Trajtimit të Personave me aftësi të Kufizuar së bashku me specialistin e Sektorit të Financë-Statistikës.

Në total Drejtorja e Ndihmës dhe Shërbimit Social përbëhet nga 24 punonjës. Për periudhën Janar-Dhjetor 2024, Drejtorja e Ndihmës dhe Shërbimit Social, është përballur me sfida të pranishme dhe të vazhdueshme, por edhe me modele pozitive sa i takon bashkëpunimit të rrjetit tashmë të konsoliduar të shërbimeve sociale në Bashkinë e Vlorës. Shërbimet sociale janë një zinxhir kompleks në ndërveprim me institucionet shtetërore dhe me OJF që operojnë në nivel lokal dhe kombëtar.

Drejtorja e Ndihmës dhe Shërbimit Social ka hartuar dhe miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak një Plan të mirëfilltë Social 2025-2027, me objektiva të qarta, të matshëm dhe të realizueshëm si një risi në bazë të implemetimit të projektit pilot për DI-in në kuadër të ngritjes

së Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen. Gjithashtu Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimit Social ka aplikuar për projektin e qendrës ditore të moshuarve, projekt i cili është shpallur fitues.

Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimit Social në bashkinë e Vlorës ka në fokus shërbimet e kujdesit shoqëror nevojat sociale në rritje të kategorisë së grupeve në vështirësi ekonomike për të gjithë komunitetin, të jenë të mbuluara me shërbime ekzistuese dhe shërbime të reja sociale, për të qënë sa më pranë qytetarëve sipas modeleve dhe praktikave më të mira bashkëkohore.

Shërbimet ofrohen në përputhje me standartet dhe kornizën ligjore të shërbimeve sociale duke u bazuar në qasjen me individin , si prioritar në qëndër të cdo shërbimi, duke ngritur një sistem të balancuar shërbimesh sociale të cilat do të kenë në fokus target grupet në nevojë, duke synuar një mbulim më të mirë të nevojave të tyre, një mbulim më të plotë me shërbime të tjera të kujdesit shoqëror, nëpërmjet zhvillimit të mëtejshëm të shërbimeve ekzistuese dhe ndërtimit të shërbimeve të reja.

SEKTORI FINANCË-STATISTIKË

Çdo muaj Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimit Social paraqet Projekt-Vendimin e fondit të kushtëzuar 6% me fonde të deleguara nga buxheti i shtetit dhe Projekt-Vendimin me të ardhurat e bashkisë ku trajtohen familje me probleme të thella sociale të cilat nuk janë përfituese të sistemit dixhital por në bazë të kritereve specifike të miratuara në Këshillin e Bashkisë çdo fillim viti, përfitojnë me të njëjtën vlerë monetare si skema dixhitale dhe konkretisht :

Numri i familjeve përfituesve në vështirësi ekonomike nga të ardhurat e bashkisë ka qënë afërsisht rreth 31 familje në muaj me një fond vjetor prej 1.244.000 Lek .

<i>Emërtimi</i>	<i>Përfitues te ndihmes ekonomike</i>	
	<i>Numër</i>	<i>Lekë</i>
Bashkia	21	719.500
Njesia Shushice	2	132.000
Njesia Qendër	3	162.000
Njesia Novosele	2	141.500
Njesia Orikum	3	90.000
TOTALI	31	1.245.000

Me V.K.M. 159 date 12.03.2022 për Mbështetjen financiare të disa kategorive të vecanta , përfitim të ndihmes ekonomike financiar nga buxheti i shtetit. Në bazë të V.K.M 854 date 26.12.2024 për “Shpërblimin e disa kategorive të vecanta për festat e fund vitit 2025” u akordua

fondi i shpërblimit për të gjitha kategoritë në masen 15000 leke për cdo familje. Pra për vitin 2024, qeveria ka akorduar fonde sipas tabelës së mëposhtme :

Emertimi	ND.EKONOM Nga sistemi				Shpërblim fundviti	TOTAL 2024/25 000/L	
	Nr familje	Shuma 000/l	Nr familje	Shuma 000/l	Shuma 000/leke		
Bashkia- Rajonet	395	27.521			413	6.195	34.371
Njesia Orikum	23	2.032			24	360	2.392
Njesia Qendër	43	3.819			41	615	4.434
Njesia Shushice	111	9.299			115	1.725	11.024
Njesia Novosele	61	5.546			62	930	6.476
TOTALI	633	48.218			655	9.825	58687

Në skemën e ndihmës ekonomike prioritet janë përfituesit kryefamiljare gra 179, familje që janë të komunitetit rom 29, familje të cilat kanë në përbërje të tyre P.A.K 88, jetim deri në moshën 18 vjec të cilët janë 24 persona, familje me trinjakë 2 dhe viktime të dhunës 54 familje si dhe fëmijë që janë me shërbim kujdestarie të gjyshërve ose të afermve të tyre 7 familje.

Ndërsa për numrin e përfituesve të familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike nga **fondi i kushhtëzuar 6%** për vitin 2024 janë trajtuar 23 familje me një fond 1.173.972 leke ,sipas tabelës së mëposhtme:

Emërtimi	Përfitues te ndihmes ekonomike	
	Numër	000/Lekë
Bashkia	23	829
Shperblim fundviti	23	345
TOTAL	23	1.174

Pagesat për të gjitha këto kategori e personave me aftësi të kufizuar kanë vazhduar pa ndërprerje edhe për personat që kanë mbaruar afatin e komisionimit për të mos krijuar probleme sociale dhe konkretisht:

	P.A.K + kujdestarë	Tetraplegjik+	Verbëri	Invalid	Total
--	--------------------	---------------	---------	---------	-------

Emërtimi			kujdestarë		kujdestari					
	Nr.	000/Lek	Nr.	000/Lek	Nr.	000/Lek	Nr.	000/Le k	Nr.	000/ Lek
P.A.K	1924	250.834	566	149.021	668	130.942	238 2	91.224	5540	622.2 02
Shperblim fundviti 24	1853	27.795	560	8.400	660	9.900	-	-	3073	46.0 95
TOTALI		278.629		157.421		140.842		91.224		668.1 18

NJËSIA PËR ÇËSHTJET KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE

Nga Koordinatori Vendor i Dhunës në Familje për periudhën Janar-Dhjetor 2024 janë trajtuar gjithësej 110 vendime gjyqate lëshuar në formën e UMM dhe UM nga Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë të paraqitura pranë Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social, bashki. Këto raste dhune janë menaxhuar në bashkëpunim me Ekipin Teknik Ndërdisciplinar dhe në koordinim të përmirësuar mes aktoreve të këtij grupi, ku janë marrë edhe masat përkatëse për mbështetjen e plotë të viktimave.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2024 janë realizuar 11 mbledhje emergjente të Ekipi Teknik Ndërdisciplinor të dhunës në familje.

Rastet e paraqitura si me vendim gjyqate ashtu edhe të vetëreferuara pranë Njesisë së Çështjeve Kundra Dhunës në Familje, janë menaxhuar në bashkëpunim me koordinatoren vendor dhe me antarët e Ekipit Teknik Ndërsëktorial, duke u ofruar rasteve të dhunes, shërbime ligjore dhe psikologjike falas, shërbime këshillimi për burrat e dhunshëm, rastet e pajisura me UM janë trajtuar me Ndihmë ekonomike në masën 9900 lekë, duke kryer njëkohësisht monitorimet përkatëse në bashkëpunim me policinë vendore Vlorë, si dhe stafin e shërbimit Social, ndërmjetësim për punësim, informim dhe këshillim mbi të drejtat që ka një viktimë dhune në bazë të ligjit përkatës, ndërmjetësim për aplikim bonus qeraje si dhe ndërmjetësim për akomodim pranë strehëzave rezidenciale përkatëse.

Kryesisht në skemën e ndihmës ekonomike përfshihet edhe kategoria e viktimave të dhunës në familje të pajisura me UM duke përfituar kështu pagesën e ndihmës ekonomike në masën 9900 Lek.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024, në bashkinë e Vlorës është bërë e mundur që të organizohen aktivitete dhe materiale ndërgjegjësuese kundër dhunës në familje, në shkollat 9-vjeçare dhe të

mesme të qytetit të Vlorës në kuadër të fushatës së “16 ditëve të aktivizimit të luftës kundër dhunës me bazë gjinore”.

Në bazë të fondit social janë realizuar takime ndërgjegjësuese dhe promovime për të drejtat e grave, të viktimave të dhunës dhe trafikimit të qenieve njerëzore, takime ndërgjegjësuese me të rinjtë e shkollave të mesme të qytetit . Çdo rast dhune i paraqitur pranë Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social ose çdo rast i referuar nga gjykata e rrethit gjyqesor Vlorë është kontaktuar dhe është bërë vlerësimi i nevojave nëpërmjet një intervistimi mes koordinatorit të dhunes, punonjësit social të vlerësimit të nevojave si dhe viktimës. Pasi është vlerësuar nevoja e çdo rasti dhune koordinatori ka informuar viktimën dhe e ka referuar në institucionet përkatëse. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024 janë referuar janë referuar 90 raste pranë klinikës ligjore “Vatra” dhe 15 raste dhune per dhunesit për këshillim psikosocial pranë Klinikës Ligjore “Vatra” ku viktimave të dhunës dhe personave ushtrues të dhunës, u është ofruar asistencë ligjore dhe psikologjike, zgjidhje martesore dhe kërkesepadi për UMM dhe UM si shërbime falas nga Klinika Ligjore e Qendrës Psiko-Sociale “Vatra”.Duke bërë një analize të rasteve grupmosha më e prekur nga dhuna është fasha 26-35 vjec si dhe 36-45 vjec si raste dhune në familje. Grupmosha më pak e prekur nga ky fenomen është fasha 19-25 vjeç. Femrat jane target grupi më i margjinalizuar nga fenomeni i dhunës edhe për raportimet e vitit 2024. Statusi civil më i prekur nga fenomeni i dhunës në familje janë të martuar, më pas renditen kategoria e personave të divorcuar dhe më pak bashkëjetuesit. Niveli arsimor i ulet ka qene më i prekur prej fenomenit të dhunës në familje dhe me pas niveli arsimor i mesem kurse niveli arsimor i lartë ka qënë më pak i prekur prej dhunës për vitin 2024. Një kategori e prekur nga fenomeni i dhunës në familje janë edhe komuniteti Rom dhe Egjiptjan, të cilët janë trajtuar me shërbime sociale nga Ekipi Teknik Ndërdisciplinor i Dhunës në Familje.

NJËSIA E MBROJTJES DHE TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Për periudhën Janar-Dhjetor 2024, ka menaxhuar në total 110 raste dhe 61 jane raste te reja të fëmijëve në nevojë për mbrojtje sipas problematikave si vlerësime social-ekonomike të familjes për monitorim të rastit, për marrjen e përgjegjesisë prindërore nga prindi, rastet e fëmijëve të huaj të pashoqëruar dhe strehim pranë qendrave rezidenciale përkatëse, si dhe raste të fëmijëve në konflikt me ligjin. Janë zhvilluar ne total 40 vizita si dhe 15 mbledhje të grupit teknik ndërsektorial. Grup mosha e fëmijëve në nevojë për mbrojtje në bazë të statistikave rezulton 14-16 vjec. Për vitin 2024 janë përfshirë 22 fëmijë në kopshte dhe çerdhe me të ardhurat e fondit të bashkisë.

Vizitat në familje kanë pasur karakter kryesisht vlerësues mbi situatën sociale-ekonomike të familjes dhe janë kryer në varësi të problematikave të cilat kanë patur rastet. Në kuadër të muajit mbi çështjen anti-trafik në qëniet njerëzore Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve ka realizuar një sërë aktivitete sensibilizuese në bashkëpunim me aktorë të tjerë të përfshirë në

këtë çështje si policia Vendore Vlorë, Q.P.S “Vatra”, Shërbimi Social Rajonal, NJVKSH duke ofruar informacion sensibilizues dhe informues në shkollat e sektorit publik dhe privat të qytetit të Vlorës Gjithashtu janë realizuar aktivitete të ndryshme në kuadër të 16 ditëve të dhunës në familje, në lidhje me ndërgjegjësimin e të rinjve për të denoncuar rastet e dhunës në ambientin ku jetojnë.

Një tjetër aktivitet në fushën e shërbimeve sociale , nga Njesia e Mbrojtjes së Fëmijëve në bashkëpunim me Shërbimin Mbështetës Për Fëmijët Dhe Familjet dhe fshatrave SOS, në vitin 2024 u realizua Kampi Veror. Në vitin 2024 nën kujdesin e vecantë të kryetarit të bashkisë z. Ermal Dredha u realizua kampi veror me pjesëmarrjen e mbi 30 fëmijëve. Fëmijët që janë përfshirë në kampet verore janë fëmijë nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike por dhe fëmijë me problematika sociale.

Pjesëmarrja e anëtareve të GTN-se gjithashtu ka qënë e rregullt dhe të gjithë kanë marrë përsipër detyrimet ndaj rasteve dhe problematikave që ata paraqesin. Disa prej problematikave janë zgjidhur menjëherë kurse disa janë në proces për t’u zgjidhur duke kërkuar pak më shumë kohe. Gjithashtu janë marrë masa edhe për identifikimin dhe trajtimin e rasteve të fëmijëve në situatë rruge duke ngritur 5 skuadra terreni për sezonin turistik 2024 me nga 3 punonjës socialë në bashkëpunim me Shërbimin Mbështetës për Fëmijët dhe Familjet si dhe Qendrën Psiko-Sociale” Vatra”.Janë zhvilluar 5 aksione blic për identifikimin e të miturve në situatë rrugë si dhe të miturve të shfrytëzuar për punë.

Menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrotje dhe i rasteve të fëmijëve viktimat të dhunës në familje është realizuar me staf të plotë dhe të mirë organizuar.

NËPUNËSI PËR ÇËSHTJET E BARAZISË GJINORE

Për periudhën Janar-Dhjetor 2024, nëpunësi i barazisë gjinore ka asistuar në mbështetje me shërbim sociale si dhe asistim në vlerësimin e nevojave të rasteve sociale si dhe referim pranë institucioneve ofruese shërbimesh falas. Ka qënë pjesëmarrës në të gjitha mbledhjet e këshillit bashkiak.

Nëpunësi i barazisë Gjinore ka qënë pjesë aktive edhe gjatë fushatave sensibilizuese dhe informuese si fushata e çështjeve anti-trafík në qëniet njerëzore si dhe fushata e 16 Ditëve të Aktivizmit Kundra Dhunës më bazë Gjinore. Nëpunësi gjinor ka qënë pjesëmarrës edhe në tryezat konsultative mbi çështjet e barazisë gjinore, si dhe pjesëmarrës në trajtime të ndryshme nga OJF-të me fokus barazinë dhe drejtësinë gjinore.

Ka asistuar në seanca gjyqësore në bashkëpunim me Punonjësin e Mbrojtjes së Fëmijëve, për çështjet e fëmijëve me problematika socio-ekonomike si dhe ka asistuar në vlerësimet e nevojave të rasteve të dhunës në familje në bashkëpunim me Koordinatorin Vendore të Dhunës dhe ka

qënë pjesëmarrës aktiv si në ETN ashtu dhe ne GTN e realizuara mbi çështjet e ndryshme dhe problematikat sociale të paraqitura pranë DNSHS-së.

NJËSIA E VLERËSIMIT DHE REFERIMIT TË NEVOJAVE TË RASTIT **Periudha Janar-Dhjetor 2024**

Për periudhën Janar- Dhjetor 2024, Njesia e Vlerësimit dhe Referimit të Rasteve ka zhvilluar një sërë aktiviteteve si:

Grupi Teknik Ndërdisciplinor është mbledhur tre herë për menaxhim rastesh të kategorisë së moshës së tretë dhe të personave me Aftësi të Kufizuar.

Janë realizuar 40 vlerësime nevojash në bashkëpunim me koordinatorin vendor të dhunës në familje.

Janë realizuar 40 vlerësime nevojash në bashkëpunim me Punonjësin e Mbrojtjes së Fëmijëve për rastet e fëmijëve me problematika sociale si dhe monitorimet përkatëse.

Janë realizuar 110 vlerësime nevojash të familjeve të cilët janë përfitues të sistemit Digjital të Ndhmës Ekonomike në rajonet e bashkisë Vlorë dhe Njësitë Administrative.

Asistim në seancat gjyqësore, të rreth 6 raste të qytetarëve me problematika të ndryshme sociale. Specialisti i Njësisë së Vlerësimit dhe Referimit të nevojave ka qënë pjesëmarrës dhe relatues pranë shkollave të arsimit të mesëm dhe nëntëvjeçar në kuadër të fushatës së “16 Ditëve të Dhunës me Bazë Gjimore” si dhe pjesëmarrëse në trajtimet të ndryshme të zhvilluara nga Organizatat e shoqërisë civile si dhe institucione të tjera.

Pjesëmarrëse aktive në organizimin e festave të fundvitit për përfituesit e Ndhmës Ekonomike si dhe të moshuar të vetmuar nën kujdesin dhe mbështetjen e Kryetarit të bashkisë z.Ermal Dredha. Gjithashtu në kuadër të festave të fund vitit 2024, është realizuar dhe një aktivitet me fëmijë të skemës së ndihmës ekonomike, ku prezentë ka qënë dhe kryetari i bashkisë z.Ermal Dredha.

SHËRBIMI MBËSHTETËS PËR FËMIJËN DHE FAMILJEN

Aktivitetet dhe shërbimet e ofruara nga Shërbimet Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen gjatë vitit 2024.

Shërbimet bazë	Shërbimet e detajuara
Shërbime të kujdesit shoqëror si: monitorim i mirëqënies së qytetarit dhe lobim për realizimin e të drejtave të qytetarëve.	Takime me aktorë vendorë në lidhje me respektimin e të drejtave të qytetarëve dhe sigurimin e aksesit në rrjetin e shërbimeve në komunitet: Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve (50 takime) Koordinatori Vendore për Dhunën në Familje

	<p>(20 takime)</p> <p>Psikolog në Polici (45 takime në komisarariat)</p> <p>Punonjës të shëndetësisë (20 takime, kryesisht e pediatër e mjek familje)</p> <p>Administratoret e Rajoneve dhe Njësi Administrative (40 takime)</p> <p>Zyra e punës (6 takime)</p> <p>Shërbimi Social Shtetëror Rajonal (20 takime)</p> <p>Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor (10 takime)</p> <p>Zyra arsimore (25 takime)</p> <p>Zyra për kopshtet e çerdhet (10 takime)</p> <p>Gjykata e Shkallës së parë, Vlorë (20 seanca)</p>
<p>Shërbime të fuqizimit individual e familjar: administrativ dhe ekonomike</p>	<p>Vlerësim i thelluar i nevojave të individit/familjes (30 familje)</p> <p>Plan fuqizimi individual/familjar (30 plane fuqizimi familjarë)</p> <p>Orientim-shoqërim dhe advokim në institucione të ndryshme përmendura në pikën 1, në funksion të përmbushjes së planit të fuqizimit dhe plotësimit të nevojave.(rreth 200- takime me të gjitha institucionet e nevojshme në kuadër të përmbushjes së planit të fuqizimit të familjeve dhe menaxhimit të rasteve)</p> <p>Këshillime psikologjik; fëmijë (60 raste) dhe të rritur (60 raste).</p> <p>Mbështetje direkte(paketa ushqimore-40 pako,-higjeno-sanitare 40 pako).</p> <p>Aktivitete për fëmijë me grupe të vogla realizuar në zyrat e SHMFF (5 aktivitete me pjesëmarrjen e rreth 50 fëmijëve në total). dhe të rritur (2 aktivitete me pjesëmarrjen e 30 grave).</p> <p>Në total familjeve u janë ofruar shërbime të integruara që kanë ndikur në mënyrë të drejtëpërdrejtë në rritjen e mirëqënies së fëmijëve e familjeve dhe parandalimin e institucionalizimit.</p>

<p>Shërbime të specializuara si kujdestaria në familje, psikoterapeutë, mësues special, logoped, fizioterapistë etje.</p>	<p>Shërbimi i kujdestarisë në familje me shërbimet e mëposhtme: -asistim në takimin e fëmijës me nënë biologjike. (1 fëmijë) -Shoqërim në cerdhe-shkollë të fëmijëve (1 fëmijë) -shërbime për të plotësuar nevojat e përditshme të të moshuarvve.(1 familje)</p> <p>Shërbime të specializuara, kontraktuar nga SOS. Në total kanë marrë shërbime të specializuara 75 fëmijë. <i>Shërbimi i Logopedisë:</i> – kanë marrë shërbim logepedie falas 7 fëmijë. <i>Shërbimi i fizioterapisë:</i> – kanë marrë shërbim fizioterapie falas 9 fëmijë. 50 fëmijë kanë marrë pjesë në kampin veror, nga të cilët 25 kanë qenë raste të reja.</p> <p><i>Klasa pas shkolle</i> - kanë ndjekur klasat pas shkolle 10 fëmijë</p> <p><i>Klasa e gjuhës angleze</i> - kanë ndjekur kursin e anglishtes 15 fëmijë</p>
<p>Klasa prindërimi- këshillim mbi prindërimin pozitiv</p>	<p>Moduli i klasave të prindërimit “Jam këtu për ty”me pjesëmarrës 15 nëna. Moduli SPSC (Strong Parents Strong Children), me pjesëmarrjen e 7 nënave. Është ofruar këshillim për prindërimin pozitiv gjatë gjithë kohës sipas nevojës, si dhe sipas vendimeve të lëna nga Gjykata.</p>
<p>Qendër burimore për dhënie e informacionit, ofrimin e trajnimeve, mentorim drejt plotësimit të nevojave dhe shërbime të specializuara.</p>	<p>Bazuar në hartën e shërbimeve sociale janë orientuar përfituesit drejt shërbimeve për të cilat anë patur nevojë, duke iu dhënë informacionin dhe orientimin e duhur.</p>
<p>Numri i përfituesve në total gjatë vitit 2024</p>	

Totali i rasteve që kanë marrë shërbime pranë SHMFF për vitin 2024	Në total për vitin 2024 janë menaxhuar 77 familje me nevoja të ndryshme socio-ekonomike dhe në total 190 përfitues shërbimesh.
--	--

Aktivitetet e realizuara	Përshkrim i aktivitetit
Aktivitet për prezantimin e modelit të Kujdestarisë alternative.	4 aktivitete të realizuara në Njësitë administrative, 60 persona të informuar drejtëpërdrejtë në lidhje me Kujdestarinë alternative.
Aktivitet edukues-argëtues për fëmijët e familjeve që marrin shërbime fuqizimi .	5 aktivitete të realizuara me fëmijët në kuadër të informimit për tema të ndryshme dhe argëtimit.
Organizimi i kampit veror nga Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimit Social dhe SOS, Fshatrat e fëmijëve.	Organizim i lojërave e sesioneve edukative për fëmijët pjesëmarrës në kampin veror, realizuar në muajin qershor për 2 javë, me 50 fëmijë përfitues.
Aktivitete argëtuese me nëna në përmbyllje të sesioneve të prindërimit.	Është organizuar një aktivitet në përmbyllje të moduleve të klasave të prindërimit.
Aktivitet informues dhe ndërgjegjësues me vajza dhe gra në kuadër të Dhunës në Familje.	Realizuar në muajin nëntor, si një nevojë për të shpërndarë informacion dhe adresuar problematikat e shumta që kanë vajzat e gratë, përfituese të shërbimeve tona.
Aktivitet i fundvitit me fëmijë nga familjet që përfitojnë nga shërbimet e SHMFF.	Realizuar në muajin dhjetor.
Pjesëmarrje aktive në aktivitete të organizuar nga aktorë të tjerë në funksion të sensibilizimit të qytetarëve rreth çështjeve të ndryshme sociale si Dhuna në familje, Dhuna me bazë gjinore, informim dhe sensibilizim mbi të drejtat e grave etj.	Pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme , prezantim i shërbimeve tona dhe pozicionit tonë në Drejtorinë e Ndhmës e Shërbimit Social.

2. Projekt K10430: Qendra e zhvillimit P.A.K

Misioni dhe objektivat e QZHPAK

Qendra e Zhvillimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, Vlorë si një institucion rezidencial i cili funksionon në përputhje me standardet dhe legjislacionin në fuqi për këtë target grup, edhe këtë vit ka organizuar aktivitetin e saj në përputhje me misionin dhe objektivat e vendosura.

Për vitin 2024 pranë Qendrës së Zhvillimit PAK kanë marrë shërbim 29 rezidentë, 8 prej të cilëve janë në interesim nga familjari dhe pjesa tjetër prej 21 rezidentësh janë të braktisur ku 10 prej tyre janë ende nën proces gjyqësor. Në vitin 2024 kanë marrë shërbim 29-rezidentë ,ku 9-prej tyre janë me interesim ,10 pa interesim dhe 10-të tjerë janë ende në proces gjyqësor për të marrë kujdestarinë.

Në organiken e saj Qendra ka një një staf prej 30 punonjësish të ndarë në 2 sektorë: Sektori i Administratës dhe Sektori i Shërbimeve

Viti 2023 ka po të njëjtin numër personeli të ndarë në 2 sektorë:

- Në nivel specialisti të përfaqësuar nga punonjës social, logoped, infermier, fizioterapist, psikolog dhe edukatorët të cilat mbulojnë dhe nivelin edukativ-pedagogjik.
- Në nivel shërbimi të përfaqësuar nga kuzhinieret, kujdestarët e natës, sanitaret, magazinieri dhe lavantieri.

Misioni i Institucionit

QZHPAK është zbatimi i politikave sociale me synim : Ofrimin e Shërbimeve cilësore, të qëndrueshme dhe në përputhje me standartete e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për Personat me Aftësi të Kufizuara duke qënë gjithnjë në koherencë me legjislacionin në fuqi me qëllim rritjen e cilësisë së jetës , nxitjen e pavarësisë, përfshirjes dhe respektimit të dinjitetit të rezidentëve si dhe integrimin e tyre në komunitet në mënyrë sa më të natyrshme, nëse kjo e fundit është e mundur.

Qendra e Zhvillimit për Persona me Aftësi të Kufizuara ka për *Objektiv* të ::

- Rrisë cilësinë e shërbimit që ju ofrohet rezidentëve në drejtim të riaftësisimit fizik dhe mendor të këtyre të fundit.
- Nxitja dhe zbatimi i programeve aktive me qëllim krijimin e një procesi sa më natyral të integrimin të rezidentëve në komunitet.
- Krijimi i netëork-ve efektiv me Institucione, Organizata jofitimprurëse, Subjekte Juridike dhe private të cilat promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e këtij target-grupi.
- Realizimi i Programeve edukativo-pedagogjike dhe riaftësisimit të personave me aftësi të kufizuara.
- Organizimi i aktiviteteve jashtë qendres me rezidentët,qëllimi i së cilës është përshtatja me faktorë të jashtëm dhe individë të ndryshëm.

Detyrat :

- Ofrimi dhe krijimi i kushteve të favorshme dhe cilësisë për të jetuar dhe mësuar në bazë të programeve të riaftësisimit.
- Përpilimi i programeve të edukimit dhe të integrimin në sajë të bashkëpunimit të edukatoreve, specialistëve, monitorimi i të cilëve behet nga Drejtoria
- Zbatimi i legjislacionit dhe Standarteve

- Hartimi i programeve per trajnimin dhe formimin e stafit.
- Administron dhe menaxhon buxhetin e caktuar.
- Raporton dhe informon Sh.S.SH dhe Bashkine, Vlore mbi: statistikat dhe evidencat mujore,te ardhurat, transferimet e klienteve, raporte te realizimit te planeve mujore.
- Mban lidhje korrekte per cdo problem me Bashkinë Vlore dhe SH.S.SH.

Si Institucion shtetëror, social dhe rehabilitues pjesë e institucioneve të përkujdesit shoqëror në këtë Qendër ofrohen këto shërbime :

- Në nivel specialisti të përfaqësuar nga punonjësi social, infermier, specialist logoped dhe fizioterapeut, psikologe,dukatorët të cilat mbulojnë edhe nivelin edukativ-pedagogjik.
- Në nivel shërbimi të përfaqësuar nga kuzhinierët, kujdestarët, sanitarët, mirëmbajtësi, magazinieri etj .

Aktualisht në Qendrën tonë marrin shërbim 29 rezidentë, prej të cilëve 21 përfitues janë mbi moshën 21 vjecare, 12 rezidentë janë me familje dhe 17 të braktisur.Përfituesit me familje vetëm 8 prej tyre jane me interesim. Shërbimi Social Shtetëror udhëzon që Qendrat Rezidenciale të ofrojnë kujdes dhe shërbim për rezidentët deri në moshën 21 vjec si dhe të kryhen të gjitha procedurat për kthimin në familje të personave me interesim. Konkretisht janë kryer të gjitha kërkesat dhe procedurat ndaj Shërbimit Social Shtetëror dhe Rajonal për sistemimin e këtyre rezidentëve, por situacionet social-ekonomike të familjeve të tyre nuk i plotesojnë kushtet për deinstitucionalizimin e këtyre përfituesve.

• ***Të dhënat statistikore për numrin e përfituesve gjatë vitit 2024***

Nr	Emertimi	Lloji I Qendres			Grup- moshë				Perkujdesi familjar	
		Gjithsej	Rezidenciale	Ditore	Deri ne 18 vjec		Mbi 18 vjec		Me familje	Pa familje
					Rezidenciale	Ditore	Rezidenciale	Ditore		
		1	2	3					8	21
I	Numri I Qendrave gjithsej	1	1		4		25		8	21
	-Lloji I shërbimit									
	a)Higjieno -sanitar	29			4		25		8	21
	b)Shërbime edukative	29			4		25		8	21
II	c)Aktivitete sociale	29			4		25		8	21
	d)Fizoterapi	6			1		5		8	21
	e)Mbeshtetje financiare	29								
II I	Numri I klienteve perfitues	29			4		25		8	21
	a)Jetim social	12			1		12		17	
	b)Jetim biologjik	10			3		6			23
	c)Rom	1					1			1
i V	d)Te huaj									
	Numri i klienteve ne nevoje									

Fondi I shpezimeve (progresive ne 000/leke)	(në mijëra)								

Realizimet e objektivave

Realizimet në Sektorin Social dhe Pedagogjik 2024

1. Në drejtim të këtyre sektorëve qëllimet, objektivat dhe aktivitetet për vitin 2024 kanë qënë të orientuara në lidhje me moshën në rritje të rezidentëve të veshitësive që ata paraqesin nevojave dhe kërkesave të tyre në lidhje me trajtimin e aftësive të kufizuara dhe të zhvillimit të tyre në përputhje me kërkesat dhe plotësimin e standarteve të vendosura. Në nivel pedagogjik për këtë vit janë vlerësuar fillimisht nevojat, kërkesat dhe vetë rezidentët brenda institucionit është hartuar një projekt pilot duke organizuar aktivitete okupacioni në bazë të trajnimeve speciale të edukatorëve të orientuara në aktivitete specifike, që do të thotë se tashmë janë shtuar aktivitete paraprofesionale në mini atelie pune si: punime me letër dhe plastikë, punime leshi, pikturë, aplikacione-prodhim pikturë të ndryshme.

Aktivitet në Qendër janë zhvilluar normalisht, madje këtë vit mund të përmendim se ka patur një rritje në nivelin e organizimit të aktiviteteve

Rezidentët përfshihen në këto aktivitete në mënyrën që mundën . Këto aktivitete zhvillohen paralelisht me programet individuale të zhvillimit për gjithë secilin nga rezidentët.

Theksojmë se të gjitha aktivitetet janë realizuar në mbeështetje të plotë të edukatorëve specialiste të cilët organizojnë punën në bazë të prirjeve të secilit rezident.

Realizimi i objektivave pedagogjike

- Plotësimi i fshave të vlerësimit të AK, për të përcaktuar nevojat dhe prioritetet e ndërhyrjes.
- Hartimi, plotësimi i planeve individuale të zhvillimit.
- Rishikimi dhe rivlerësimi i nevojave të rezidentëve përsa i përket moshës dhe tipologjisë së veshitësisë që ata paraqesin duke i orientuar aktivitetet në ato paraprofesionale.
- Hapja e 2 mini- atelie të punës si dhe atë të krijimtarisë me materiale të ndryshme sipas specifikave të rezidentëve.

Realizimi i Sektorit Social dhe Pedagogjik 2024 :

Në nivel pedagogjik për vitin 2024 duke vlerësuar fillimisht nevojat kërkesat dhe vete rezidentët brenda institucionit është hartuar një projekt pilot duke organizuar aktivitete okupacioni në bazë të trajnimeve speciale të edukatorëve të orientuara në aktivitete specifike që do të thotë se tashmë janë shtuar aktivitete paraprofesionale në mini atelie pune si: punime me letër dhe plastike, punime leshi, punime me rruaza, me materiale të riciklueshme, punime në pikturë, aplikacione-prodhim pikturë të ndryshme.

Objektivat Specifike të arritura gjatë 2024

- Informimi dhe raportimi i evidencave sociale në institucionet përkatëse.
- Mbatja dhe nxitja e kontakteve të institucionit me familjarët e rezidentë duke i bërë ata aktorë të rëndësishëm në hartimin e Planeve të Kujdesit Individual të rezidentëve. Informimi i tyre mbi ecurinë dhe problematikën e rezidentit duke u përpjekur që të promovohet rikthimi i tyre në familje aty ku është e mundur.
- Hartimi i planeve vjetore dhe mujore si dhe raporteve mbi ecurinë e tyre sipas grafikut të paracaktuar nga drejtorja e Institucionit.
- Bashkëpunimi me specialistët dhe edukatorët e zhvillimit për të hartuar dhe zbatuar planet e kujdesit të rezidentëve.
- Organizimi i aktivitete me karakter social brenda dhe jashtë Qendrës në përputhje me planin e aktiviteteve mujore.
- Plotësimi dhe pasurimi i dosjeve sociale të rezidentëve.
- Mbatja dhe poltësimi i rregjistrave në ngarkim, të rezidentëve, të interesimit të familjarëve etj...
- Bashkëpunimi me Shkollën PLM në ecurinë e fëmijëve.
- Zhvillimi i Gjyqeve për marrjen në kujdestari të rezidentëve tanë .

Aktivitetet në Qendër janë zhvilluar normalisht, madje këtë vit mund të përmendim se ka patur një rritje në nivelin e organizimit të aktiviteteve do të përmendim këtu aktivitetet me rastin **Dita Ndërkombetare e Fëmijëve Jetime** datë 20 Maj, 1 qershorit, **Dita Ndërkombetare e Aftësive se Kufizuar** si dhe **festave të Clirimit dhe Pavarësisë dhe festave të fundvitit** .Gjatë këtij viti janë realizuar të gjitha llojet e aktiviteteve me raste festash.Me rastin e festës së verës date **14.03.2024** u vendos në bashkëpunim me stafin e PAK zhvillimi i një pikniku i cili u mbajt në ambientet jashtë qendre në plazhin e skelës,ku fëmijet u bënë pjesë e lojrave të ndryshme me njeri –tjetrin, por dhe me stafin .Aktivitet tjetër pasues ishte ai me rastin e **Ditës Ndërkombetare të Autizmit** ku u bë një ekspozitë me vizatime dhe punimet e rezidentëve ,pjesmarrës të këtij aktiviteti u bënë dhe Shërbimi Social Shtetëror Tiranë,përfaqësues të Bashkisë Vlorë ,vet Kryetari Z.Ermal Dredha dhe klasa IXA me punonjëse sociale Anisa Troqe. Për aktivitetin e festës së **1 Qershorit** është hartuar një plan pune bashkëpunimi me drejtorin dhe stafin në këtë datë është mbajtur një koktejl për fëmijët në bashkëpunim me stafin e qendrës duke organizuar lojra për ta me qëllim zhvillimin e aftësive lëvizëse dhe bashkëpunuese.Gjatë këtij viti u bë dhe riprezantimi i Atelies sonë me punime të reja nga rezidentët tanë duke nxituar kështu dhe duke i dhënë shtysë aftësive të tyre prodhuese në punime dhe në bashkpunimet që ata bëjnë me njeri tjetrin.

Gjatë sezonit të Verës kam patur si prioritet edhe frekuentimin e plazhit me fëmijë të institucionit ku në bashkpunim me stafin bëmë të mundur argëtimin e tyre në këtë sezon. Me rastin e festave të **28-29 Nëntori** një grup fëmijësh nga qendra jonë u bënë pjesë një shëtitje të shkurtër në SHESHIN E FLAMURIT si cdo vit dhe më pas festa vijoi në ambientet e qendrës me një drekë të shtruar nga stafi përgjegjës.Qëllimi i këtij udhëtimi ishte demonstrimi i aftësive të tyre ku ata mund të përshtaten shumë mirë dhe botë së jashtme.

Data 20 dhjetor 2024 është një tjetër datë e rëndësishme me vizitën e Z.Pirro Vëngu ,Ministër i Mbrojtjes i cili pati mirësinë të vizitonte ambientet e qendrës

dhe mbarëvajtjen e rezidentëve duke u interesuar dhe për nevojat e tyre extra. Ndhimat e tij në ushqime, veshmbathje dhe batanije ishin një plus shumë i madh për ne dhe u jemi shumë mirënjohës.

Më datë 28.12.2024 Bashkia Vlorë, Kryetar Ermal Dredha shpërndaui 29 dhurata për secilin fëmijë kjo në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror Tiranë, më pas shpërndarja e dhuratave vijoi dhe me një koktejl i cili u mbajt në ambjentet e Qendres PAK. Për realizimin e festave të fundvitit, Krishtlindjet dhe Vitin e Ri në bashkëpunim të ngushtë me drejtorin, stafin dhe fëmijet bënë zbulimin e ambjentëve të institucionit dhe si çdo vit, u mbajt dreka e krishtlindjeve dhe viti të ri **25.12.2024, 31.12.2024** dhe data **01.01.2025**.

Realizimet në Sektorin Shëndetësorë

- Hartimi i planeve të punës në bashkëpunim me mjekun e qendrës
- Marrja e medikamenteve sipas hartimit të planit të punës ditore.
- Ndjekja e terapive të ndryshme në bashkëpunim me logoped, fizioterapist dhe punonjësen sociale të qendrës.
- Bashkëpunimi me Klinikën Bakaj, Vlorë për kryerjen e analizave.
- Ndjekja dhe konsultimi me edukatorët e “Shkollës Speciale PLM” për ecurinë shëndetësore të fëmijëve që ndjekin këtë shkollë.
- Asistimi i edukatorëve në menaxhimin e krizave në momente të caktuara për rezidentët kjo në rastet kur mjeku dhe infermiera nuk janë të pranishëm ose gjatë orareve të vona të natës.
- Kontrolli rutinë për higjienën orale dhe trupore të rezidentëve.
- Shoqërimi i rezidentëve gjatë aktiviteteve jashtë qendrës.
- Bashkëpunimi me dentistin në kujdesin oral.
- **Konstatime 2024 mbi ecurinë shëndetësore të rezidentëve të Qendrës:**

Duke u bazuar në ecurinë e gjendjes shëndetësore të rezidentëve në 2024 krahasuar me 2023 është arritur në konkluzionin se për disa rezidentë ecuria e tyre shëndetësore nuk ka patur asnjë ndryshim apo zhvillim të mëtejshëm. Për një pjesë të tyre duke analizuar në bashkëpunim me mjekun specialist dhe duke u bazuar në analizat e gjakut që bëhen çdo 6-muaj u vendos mosndryshimi i medikamenteve. Ushqimi është korrekt në lidhje me kuotën ushqimore të percaktuar për secilin rezident dhe mund të vlerësohet një menyu brenda parametrave normalë përsa i përket kalorive duke përfshirë aty edhe moshën dhe dietën e rezidentëve.

Gjendja shëndetësore e rezidentëve ka qenë relativisht e mirë, duke patur parasysh këtu kategorinë e personave, problemet dhe vështirësitë që ata kanë. Në periudha të ndryshme të vitit janë shfaqur viroza të cilat janë trajtuar si në individ, po ashtu edhe kur rastet kanë qenë kolektive. Gadishmëria dhe dispozicioni i mjekëve ka qenë shumë i kënaqshëm dhe korrekt.

Është bërë në mënyrë korrekte vaksinimi i rezidentëve sipas kalendarit të vaksinimit, si dhe kontrollet rutine përsa i përket planifikimit nga ana e infermieres në lidhje me kontaktimin me mjekët përkatës.

Realizime në Sektorin Financiar.

Gjatë 2023 na është akorduar një fond prej 31 421 000, i ndarë sipas zërave të mëposhtëm:

Zërat	Plan	Fakt	%
600	24,286,000	23,174,441	95
601	3,970,000	3,862,193	97
602	1,165,000	10,092,348	87
231	2,000,000	1,834,280	92

Gjatë 2024 na është akorduar një fond prej 27,067,000, i ndarë sipas zërave të mëposhtëm:

Zërat	Plan	Fakt	%
600	17,606,000	13,770,873	78
601	2,806,000	2,286,311	81
602	4,655,000	4,090,959	88
231	2,000,000	1,952,830	98

Sektori i Sherbimit Higjeno- Sanitar

Nga kontrollet vazhdueshme në këtë sektor është evidentuar se Institucioni paraqet një higjenë të përgjithshme shumë të mirë kjo në mirëmbajtjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të institucionit konform rregullave dhe standarteve higjeno sanitare.

1. SEKTORI PYJE DHE KULLOTA

Bazuar në ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, të ndryshuar me ligjin nr. 49/2016, ligjin nr. 9693 datë 19/03/2007 “Për Fondin Kullor” të ndryshuar, VKM nr. 684, dt. 2.9.2020 për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të MTM”, strukturat përgjegjëse për pyjet e kullotat pranë bashkise janë organi administrativ i shërbimit pyjor.

Qëllimi dhe Objektivat Kryesore

Administrimi i pyjeve dhe kullotave nga Bashkia Vlorë është orientuar nga ligji nr. 57/2020 “Për pyjet” dhe aktet nënligjore për transferimin dhe mbrojtjen e këtyre resurseve. Qëllimi kryesor është qeverisja e qëndrueshme, ruajtja e ekuilibrit ekologjik dhe përmirësimi i menaxhimit të këtyre pasurive. Objektivat kryesore përfshijnë:

- Mbrojtjen dhe qeverisjen e qëndrueshme të pyjeve dhe kullotave.
- Monitorimin dhe parandalimin e aktiviteteve ilegale.
- Hartimin e projekteve për rehabilitimin e zonave të dëmtuara dhe përmirësimin e infrastrukturës.
- Ruajtjen e ekuilibrit biologjik në fondin pyjor vendor.
- Drejtimin dhe mbikëqyrjen e punës për përmirësimin e zonave të gërryera dhe luftimin e gërryerjeve, të rrëshqitjeve e të ortekëve brenda territorit të bashkisë;

- Sigurimin e mbështetjes teknike nëpërmjet këshillimit të pronarëve privatë dhe të komunitetit;
- Mirëmbajtjen dhe funksionimin e infra-strukturës në fondin pyjor bashkiak;

Objektivat

Mbikqyrja dhe kontrolli i fondit pyjor dhe kullësor duke patur si synim kryesorë përmirësimin e mbikqyrjes dhe kontrollit për të ndaluar degradimin e metejshëm të ekosistemeve natyrore dhe vënien nën kontroll dhe rregullimin e aktivitetit të kullotjes.

Përmirësimi i mbikëqyrjes dhe ndalimi i degradimit të ekosistemeve natyrore.

- Janë kryer inspektime për të zbatuar ligjin mbi aktivitetin kullësor, duke përfshirë fermerët që nuk paguajnë tarifën ose përdorin zjarre për "përmirësimin" e kullotave.
- Janë monitoruar dhe identifikuar nevojat për përmirësimin e lerrave dhe veprave hidrike për sigurimin e ujit të pijshëm për blegtorinë duke rezultuar si më poshtë vijon:

Janë mbledhur 491.200 lekë nga kontratat për kullotat për periudhën Janar-Dhjetor 2024.

Janë zhvilluar takime me fermerët për sensibilizim në fshatrat Dukat, Tragjas, Kanin dhe Radhimë.

Hartimi i dy (2) projekte të rëndësishme për rehabilitimin e kullotave.

- Rehabilitimi i lerrës Ali Maçit.
- Ndërtimi i një lere të re "Qafa e Qishës" në fshatin Radhimë.

Treguesit/pritshmëritë - Mundësi përmirësimi dhe rehabilitimi.

- Puna jonë ka rezultuar në takime të realizuara me fermerët, që meren me mbarështrimin e blektorisë, për ato zona apo fshatra ku dhe tendenca e shmangies ndaj pagesës së kullotës ka patur shfaqjet e saja, si në fshatin Dukat dhe Tragjas. **Ai që kullotë duhet të paguaj.**
- Ka dal nevoja për meremetim e veprave ujëpëruese malore në kullotat, me synim të riaftësisimit të kapacitetit ujëmbajtës të tyre për sigurimin e ujit të pijshëm për blegtorinë gjatë një sezoni kullësor prej 6 muajsh.

Ndërkohë në kuadër të shkresës së Ministrisë së Ministrisë së Brëndshme, nr. 3754 prot dt. 13.07.2021 me lëndë: *'Kujtesë mbi detyrimet ligjore për marrjen e masave parandaluese për zjarret e stinës në sipërfaqet pyjore dhe kullota'*, nga ana e sektorit u rishikua edhe një herë përcaktimi i nevojave për ndërhyrje emergjente në kuadër të sigurimit të rezervave ujore. Në kuadër të kësaj shkrese, përcaktimi i veprave ujore për rehabilitim/ndërtim vepër të re, u bë jo vetëm në funksion të gjëndjes aktuale të tyre, por edhe në kuadër të nevojës/rëndësis së habitatit.

Për sa më sipër sektori vendosi që shuma prej 3.915.899 lekë (nga të ardhurat e siguruar nga aktiviteti i kullotjes), caktuar nga Bashkia do të përdoret konkretisht në masivin pyjor mbi fshatin Tragjas dhe kullotat dimërore mbi fshatin Radhimë dhe Tragjas.

- Rehabilitimin e lerës Ali Maçit në ngastrën pyjore nr. 6 të ekonomisë Tragjas – Shengjergj me vlerë 1.627.314 lekë.
- Bërjen e një lere të re (çimentoje) në ngastrën nr. 48, Ekonomi Kullosore Dukat-Tragjas-Shashicë me vlerë 2.288.585 lekë.

Pyjet

Sektori Pyje-Kullota synon të parandalojë aktivitetet ilegale dhe përmirësimin e gjëndjes së pyjeve dhe si masa paraprake parashikon:

- Kontrollin rutinë për evidentimin dhe reduktimin e prerjeve ilegale dhe ndërtimet pa leje.
- Përfundimin e Planit të Mbarështimit për pyjet (2022-2032), i cili përfshin masat silvo-teknike për përmirësimin e gjëndjes së pyllit të Sodës.

Rezultate:

Nuk ka patur ndërhyrje të paautorizuara në fondin pyjor.

- Pyjet janë ruajtur më mirë dhe janë përgatitur plane për mbrojtje të mëtejshme.
- Kemi bashkëpunuar me Njësitë Administrative dhe kryesitë e fshatrave në nivel Bashkie.

Treguesit/pritshmeria - Kontroll i aktivitetëve ilegale.

- Mbrojtje më e mirë e formacioneve pyjore.
- Janë minimizuar aktivitetet pa leje, si prerje, zënie fondi, ndërtime pa leje e tjerë.
- Kemi realizuar dhe do realizojmë në vazhdimësi një pyll të pastër.
- Ka përfunduar Planin i Mbarështimit për grup ngastrat pyjore 15.02.2022 – 15.02.2032, Për Ekonomine Pyjore ‘Kume Shashicë’ te Pylli I Sodës, si dhe pjesa tjetër e kësaj Ekonomie (Uje i Ftohtë), i cili do të pasqyroj gjëndjen aktuale të këtij pylli, masat silvo-teknike, që me realizimin e tyre do të cojnë në përmirësimin e situatës fito sanitare të tij, si dhe parashikimin e objektivave të tjera menaxheriale, gjithmon brenda legjislacionit shqipëtar për pyjet dhe statusit që i ka dhënë plani i pergjdhshem vendor.

Nuk kemi patur ndërhyrje me prerje në fondin pyjorë.

Zjarret

Objektivi: Të vihet nën kontroll mbrojtja e pyjeve dhe kullotave nga zjarri, vecanërisht prej atyre të vëna me qëllim nga barinjët.

- Eshtë përgatitur një program masash parandalimi dhe përgjigjja ndaj situatave emergjente që mund të krijohen nga zjarret për vitin 2024.
- Janë bërë takime për sensibilizimin e komunitetit të zonës, kryesisht të komunitetit të blegtorëve, me qëllim rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit të tyre, për të ndryshuar konceptin se zjarret përmirësojnë kullotat (të cilat janë në proces të papërfunduar).

- Në kuadër të mbrojtjes nga zjarri, është bërë studimi në pyllin e Sodës (në kuadër të planit të mbarshtrimit), mbi krijimin e korridoreve antizjarr. Ky studim do të konkretizohet me një projekt i cili do të paraqes në menyrë të detajuar krijimin e korridoreve antizjarr në pyllin e Sodës.
- Është bërë projekti për pastrimin i pyllit të Sodës nga të gjithë drurët e thyer, rrëzuar apo shkukur nga era. Dokumentacion i nevojshëm për vazhdim procedure është dorëzuar në Bashki i cili është miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe jemi në pritje të zhvillimit të ankandit.

Treguesit/pritshmeria: Sa me pak raste të venies së zjarreve me "dashje".

- Ngritja e strukturave të posacme për fikjen e zjarreve në nivel Njesie Administrative dhe fshati.
- Caktimi i pikave të vrojtim-sinjalizimit, të levizshme, për zjarret në pyje e kullota. U caktuan 6 pika vrojtim sinjalizimi, të cilat mbulohen nga 5 punonjes, që sektori ka në terren.
 - ✓ Shata dhe Fushe Dukat, mbulohen nga inspektori zonës Veledin Celoaliaj.
 - ✓ Tragjas fshat/vjeter , mbulohen nga inspektori zonës Gaxho Baco.
 - ✓ Shashicë, Mallangas Radhimë mbulohen nga inspektori zonës Batjar Canaj.
 - ✓ Pylli Sodës mbulohet nga inspektori i zonës Adriatik Tafili.
 - ✓ Beshisht-Trevllazër mbulohet nga inspektori i zonës Vladimir Ganaj.
- Sensibilizimi i komunitetit për mbrotje të pyjeve nga zjarri. Janë realizuar dy takime, në fshatrat Dukat,Tragjas,Rradhimë dhe Kaninë.(Në bashkpunim me MNZSH (zjarrfiksja Vlorë) dhe SPZ (inspektorët e policisë).
- Janë vendosur postera në pyllin e Sodës,Beshisht,Dukat,Tragjas.Kaninë dhe Radhimë për sensibilizimin e opinionit publik.
- Sinjalizimi i rënies së zjarrit dhe shkuarja në vendngjarje në momentet e para të rënies së tij, ul ndjeshem rrezikshmerin e përhapjes.

Tabela e mëposhtme jep qartësisht situatën e zjarreve në pyje e kullota bashkiake për periudhën 01.01.2024-31.12.2024.

- Rastet e zjarreve – 3
 - ✓ Pyje 1 raste
 - ✓ Kullota 2 raste
- Sipërfaqia e pershkruar nga zjarret, 24 ha
 - ✓ Në pyje 1 ha
 - ✓ Në kullota 23 ha

➤ Pronësia

✓ Bashkiake 24 ha

- Pyje 1ha

- Kullota 23 ha

✓ Private 0 ha

- Kullota 0 ha

➤ Dëmi ekonomik ----- lekë

➤ Material drusor i djegur, por i përdorshëm -- m³

Plani financiar

Treguesit/pritshmeria: Sigurimi i të ardhurave nga kullotat.

Në periudhën Janar - Qershor, ne realizojmë lidhjen e kontratave për kullotat verore dhe në vazhdim ato dimërore. Deri tani janë lidhur 34 kontrat, që kanë të bëjnë me aktivitetin kullosor për sezonin 6 mujor 2024-2025 .Shuma e të ardhurave në kullota për këtë vit është 491.200 lekë.

Të ardhurat vjetore:

Nr.	Bashkia	Aktiviteti	Vlefte Lekë
1	Vlorë	Kullotje	491.200
2	Vlorë	Sipërf. Përdorim	81.500
3	Vlorë	Dru zjarri	-----
Shuma			572.500

Struktura Përgjegjëse Pyje e Kullota Bashkiake

Në zbatim të shkresës të AKP e cila na ngarkon me detyrën e inspektimit dhe kontrollit bazuar ne ligjin 57/2020 Për Pyjet, doli nevoja e plotësimit të struktures pyjore me punonjes të rinj. të Struktura e sektorit u shtua me VKB për 5 specialist. Aktualisht janë emëruar 3 specialist.

Lufta kundër bimeve narkotike

Struktura përgjegjëse pyje-kullota Bashkia Vlorë, ka mare pjesë në takimet e rezalizuara nga Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Vlorë, me njesitë Administrative Orikum, Novosel, Llakatund dhe Qendër. U është dhënë detyrë specialistëve të zonave të cilët po bashkpunojnë me inspektorët e policisë (SPZ) në kontrollin që ushtrohet në fondin pyjor - kullosor. Specialistët tanë janë pjesë e grupeve të punës të policisë për kontrollin e bimeve narkotike në fondin pyjor-kullosor.

Në takimet e organizuara me blegtoret në fshatrat Kanine, Radhimë, Tragjas, Dukat, krahës problemeve të tjera si: zjarret, kullotjet pa leje, prerjet pa leje është trajtuar dhe problemi i minimizimit të bimeve narkotike.

Përfundime

1. Realizimi i punës:

- Puna për rehabilitimin e pyjeve dhe kullotave ka qenë e strukturuar dhe ka prodhuar rezultate të dukshme.
- Masat parandaluese për zjarret dhe sensibilizimi i komunitetit kanë minimizuar rastet e incidenteve të qëllimshme.

2. Sfida:

- Ka nevojë për më shumë përfshirje të komunitetit për të përmirësuar mbledhjen e tarifave kullosore.
- Investimet në infrastrukturën e veprave ujore dhe korridoret antizjarr janë ende në zhvillim.

3. Rekomandime:

- Rritja e mbikëqyrjes dhe forcimi i bashkëpunimit me autoritetet për të parandaluar ndërhyrjet ilegale.
- Rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e ruajtjes së ekosistemeve dhe përfitimet nga menaxhimi i qëndrueshëm

2. SEKTORI I MJEDISIT

Sektori i Mjedisit siguron në nivel vendor, masat për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja, mbrojtjen nga ndotja akustike dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit.

Qëllimi është të rrisë nivelin e sigurisë së mjedisit në qytetin e Vlorës dhe të ndërmarrë iniciativa të reja për përmirësimin e jetës në komunitet dhe mbrojtjen e ekosistemeve për brezat e ardhshëm.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, ju informoj se detyrat e realizuara gjatë këtij viti si Sektor Mjedisit pranë Bashkisë Vlorë janë si më poshtë:

1. Plani i Veprimit dhe hartave strategjike për Reduktimin e Zhurmave në territorin e Bashkisë Vlorë.

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 47, datë 29.05.2024 me qëllim kryesor identifikimin, evidentimin dhe parandalimin e efekteve të dëmshme që vijnë për shkak të ekspozimit ndaj zhurmave në qytetin e Vlorës.

2. Miratimi i Planit Vendor të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike për Bashkinë Vlorë.

Miratuar me Vendim Nr. 79, datë 22.08.2024 protokolluar pranë Bashkisë Vlorë me Nr. 12963/1 Prot, datë 26.08.2024. Ky plan është realizuar nëpërmjet projektit “Procesi i Planifikimit Kombëtar të Përshtatjes (NAP) ndaj Ndryshimeve Klimatike”, një iniciativë e financuar nga Fondi i Gjelbër i Klimës (GCF) si pjesë e Readiness Support Programme si dhe Memorandumit të Mirëkuptimit midis Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Vlorë.

3. Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 26, datë 31.03.2024 “Për miratimin e planit vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve Bashkia vlorë”.

4. Pjesëmarrje në aktivitetet me fokus Mjedisin në varësi të bashkëpunimit me institucionet e tjera.

Në kuadër të kalendarit të aktiviteteve Mjedisore të miratuara nga ministria e Turizmit dhe Mjedisit janë organizuar aktivitete sensibilizuese mbi rëndësinë e ruajtjes së Mjedisit në Qytetin e Vlorës si më poshtë përmendur:

➤ Dita Botërore e Mjedisit

Drejtoria e Mjedisit në bashkëpunim me shkollat e qytetit të Vlorës, organizoi një aktivitet ndërgjegjësues me fokus edukimin mjedisor dhe angazhimin praktik të nxënësve në ruajtjen e pastërtisë dhe mbrojtjen e ekosistemeve bregdetare. Aktiviteti nisi me një sesion informues të zhvilluar në ambientet e shkollave, ku nxënësit u njohën me rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit, ndikimin e ndotjes në biodiversitet dhe mënyrat konkrete për të kontribuar në përmirësimin e situatës mjedisore në qytetin e tyre. Pjesë e këtij sesioni ishin edhe prezantime nga specialistët e mjedisit, të cilët ndanë njohuri mbi efektet e ndotjes plastike në ekosistemin detar dhe rëndësinë e ndarjes dhe riciklimit të mbetjeve. Pas kësaj faze teorike, aktiviteti vijoi me një praktikë në terren, ku nxënësit, të shoqëruar nga mësuesit dhe përfaqësues të Drejtorisë së Mjedisit, u angazhuan në një aksion pastrimi përgjatë vijës bregdetare të Lungomares duke synuar pastrimin e zonës nga mbeturinat, por edhe ndërgjegjësimin e komunitetit mbi nevojën për të ruajtur pastërtinë e hapësirave publike.

➤ Dita Botërore e Bletëve

Drejtoria e Mjedisit në bashkëpunim me Zyrën e Arsimit Vlorë organizoi aktivitetin me nxënësit e shkollës "24 Maji", në ambientet e shkolles, me mbjelljen e bimëve dhe luleve me qëllim rritjen e ushqimit për bletët të cilat sjellin prodhimin e mjaltit si dhe nxitjen e polezimit të bimëve. Në këtë mënyrë, kontribuohet jo vetëm në përhapjen dhe zhvillimin e bimësisë në qytet, por edhe në mbështetjen e biodiversitetit urban nëpërmjet ndihmës që bletët ofrojnë për ekosistemet natyrore.

➤ Dita Ndërkombëtare e Veprimit mbi Klimën

Në kuadër të zbatimit të **Planit Vendor për Ndryshimet Klimatike**, Drejtoria e Bujqësisë, Mbrojtjes së Mjedisit, Veterinarisë, Pyjeve dhe Kullotave ka nisur zbatimin e një prej pikave kyçe të tij si **ndërgjegjësimin e komunitetit për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit**. Një nga elementët më të rëndësishëm të kësaj nisme është përfshirja aktive e brezit të ri, duke nisur me sensibilizimin në shkolla dhe më pas zgjerimin e ndikimit në komunitetin e gjerë.

Në këtë kuadër, Drejtoria ka organizuar aktivitete edukuese dhe ndërgjegjësuese në institucionet arsimore të qytetit, ku nxënësit janë njohur me sfidat që sjell ndryshimi i klimës dhe mënyrat se si mund të kontribuojnë për mbrojtjen e mjedisit. Përmes prezantimeve, diskutimeve dhe materialeve informuese, të rinjtë janë motivuar të bëhen pjesë aktive e iniciativave mjedisore. Ky angazhim është një hap konkret drejt një **qyteti më të pastër, më të gjelbër dhe më të qëndrueshëm**, në përputhje me objektivat afatgjata të planit vendor për ndryshimet klimatike.

3. SEKTORI I VETERINARISË

Njësia e Veterinarisë ushtron funksionin në zbatim të ligjit Nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, neni 27, 45 dhe 46, ligji 9863, datë 23.01.2008 “Për ushqimin” dhe ligjin Nr. 87/2012 “Për miratimin e Aktit Normativ Nr. 4, datë 16.08.2012” “Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregëtimin e mishit të tyre” si dhe V.K.M-së Nr. 230, datë 20.03.2013 “Për përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe strukturat e shërbimit veterinar të qeverisjes vendore”. dhe “Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë Nr. 451, datë 24.10.2017 “Per koordinimin e punës në kontrollin e therjes së kafshëve dhe tregëtimit të mishit të tyre” si dhe rregullores së brendshme miratuar me V.K.B-në Nr. 11, datë 29.03.2012, me qëllim garantimin e sigurisë ushqimore dhe produkteve me origjinë shtazore.

VKM Nr. 230, datë 20.03.2013 është shfuqizuar dhe në mbështetje të ndryshimeve ligjore në ligjin “Per shërbimin veterinar në R.SH, dhe ka dalë VKM nr. 475, datë 30.07.2021 “Bashkëpunimi i Njësive të Vetëqeverisjes Vendore me Shërbimin Veterinar”.

Gjatë gjithë vitit 2024, Njësia e Veterinarisë ka kryer 69 akt-konstatime bazuar në ankesat e ngritura nga qytetarët.

Nga konstatimet janë vënë re prezenca e mbajtjes së kafshëve të ndryshme si:

- Shpend - 177 krerë
- Qen - 114
- Të imta - 155
- Një thundërak - 1
- Gjedh - 8
- Derra - 20

Njësia e Veterinarisë Janar - Dhjetor 2024 ka groposur në varrezat e kafshëve kadavrat:

- 1 lopë

Në periudhën Janar - Dhjetor 2024 ka bashkëpunuar me Spitalin Rajonal Vlorë në nxjerrjen e rasteve të qytetarëve të sulmuar nga qentë agresiv, me pasoja fizike, të paraqitur për ndihmë mjekësore në SRV. Të dhënat janë si më poshtë:

Nr.	Muaji	Kafshime
1	Janar	23
2	Shkurt	22
3	Mars	11
4	Prill	28
5	Maj	25
6	Qershor	34
7	Korrik	24
8	Gusht	14
9	Shtator	19
10	Tetor	19
11	Nëntor	13
12	Dhjetor	12
	Poliklionikë	64
	Totali	313

Ka marrë pjesë në komisionin për kolaudimin e ushqimeve tek Qendra Ekonomike e bashkisë, të destinuara për kopshtet dhe çerdhet e qytetit. Kontrolli bëhet në lidhje me sigurinë ushqimore sipas kushteve teknologjike të përcaktuara në kontratë, që ushqimet të jenë të ambalazhuara dhe të transportuara sipas standarteve të miratuara, duke plotësuar kushtet higjieno-sanitare.

Nuk ka patur shqetësime të natyres së sigurisë ushqimore.

Në vazhdimësi meren analizat e ushqimeve sipas llojit të tyre dhe skadencës ku mbahet një evidencë për çdo ushqim me origjinë shtazore për datat e skadencës së tyre .

Njësia e Veterinarisë gjatë vitit 2024 ka monitoruar projektin “Asistencë dhe mbrojtje e qenve në situatë rruge për një jetë dhe mjedis të sigurt në qytetin e Vlorës” nga i cili u kryen 250 sterilizim/kastrime si dhe vaksinimi i tyre.

Përmbledhje Ekzekutive

Njësia e Auditimit të Brendshëm, ushtron veprimtarinë e saj bazuar në Ligjin Nr.114 datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm ne sektorin publik”, i ndryshuar, Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, dt. 25.10.2016 “Per miratimin e manualit te auditimit te brendshem ne sektorin publik”, i ndryshuar, Kodin e Etikës dhe Kartës së Auditimit të Brendshëm Publik, Ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”i ndryshuar. Njësia e Auditimit të Brendshëm është organizuar në nivel sektori me strukturë 1 përgjegjës dhe 2 inspektorë.

Njësia e Auditimit të Brendshëm për vitin 2024 ka planifikuar 8 auditime për evadim.

Misioni i auditimit të brendshëm

Misioni i Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Vlorë është të japë siguri objektive dhe të pavarur si dhe shërbime konsulence, i krijuar që të shtojë vlerën dhe të përmirësojë funksionimin e Institucionit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm ndihmon Institucionin të përmbushë objektivat e veta duke ofruar një trajtim sistematik dhe të disiplinuar, për vlerësimin dhe përmirësimin e efektivitetit të proceseve të menaxhimit të riskut, kontrollit dhe qeverisjes në drejtoritë dhe njësitë e varësisë.

Analiza e misioneve të auditimit për periudhën 01.01.2024 deri në 31.12.2024

Veprimtaria audituese është bazuar në vlerësimin e përshtatshmerisë dhe efektivitetin e sistemeve të kontrollit duke u fokusuar kryesisht në:

- Identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësisë publike
- Përputhshmërinë e veprimtarisë së njësisë publike me kuadrin regullator
- Besueshmerinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional
- Kryerjen e veprimtarisë së njësisë publike me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet

- Dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike.

Duke u bazuar në programin vjetor të auditimit të ndyshuar dhe planin strategjik për këtë periudhë janë audituar:

1. Zbatimin e rekomandimeve të lëna
2. Sektori i bordit të kullimit (Ndërmarrja e shërbimeve publike)
3. Policia Bashkiake
4. Drejtoria e Bujqësisë, Mbrojtjes së Mjedisit dhe Veterinarisë (në proces evadimi)
5. Ndërmarrja e Shërbimeve Publike
6. Qendra e kulturës
7. Detyrimet e prapambetura
8. Teatri “Petro Marko” (në proces evadimi)

Në ushtrimin e funksionit të tyre, strukturat e auditimit, kanë nxjerrë në pah hallkat më të dobëta dhe jo funksionale të sistemit, dhe ka punuar për përmirësimin e tyre. Rekomandimet janë pranuar nga titullaret e institucioneve dhe janë përcaktuar dhe afatet e realizimit të tyre. Për 7 auditimet e kryera për këtë periudhë janë lënë gjithësej 22 rekomandime,

Gjetjet e konstatuara nga strukturat e auditimit të me baze sistemi paraqiten si më poshtë:

- Sistemi i kontabilitetit dhe rap.financiar 8
- Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit 6
- Sistemi i planifikimit dhe buxhetimit 2
- Sipas qëllimit të institucionit 1
- Sistemi i prokurimeve, blerjeve & investimeve 3

- Te ardhurat dhe shpenzimet

2

Auditimi në Teatrin “Petro Marko” është në proces evadimi.

Veprimtaritë kryesore të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit bazuar në planin e masave 2024.

STATISTIKA

Grumbullimi i të dhënave për strukturat akomoduese, agjensi turistike dhe subjekte të tjera turistike. Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave për numrin e turistëve në bashkëpunim me DAV, Drejtorinë e Tatimeve Rajonale, Agjensinë e Zonave të Mbrojtura, Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Emigracionit, Muzeu Historik, Etnografik dhe i Pavarësisë, dhe Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore.

STATISTIKA

Grumbullimi i të dhënave për strukturat akomoduese, agjensi turistike dhe subjekte të tjera turistike. Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave për numrin e turistëve në bashkëpunim me DAV, Drejtorinë e Tatimeve Rajonale, Agjensinë e Zonave të Mbrojtura, Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Emigracionit, Muzeu Historik, Etnografik dhe i Pavarësisë, dhe Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore.

EVENTET

Koordinimi i kalendarit të bashkisë mbi ngjarjet tradicionale, aristike dhe kulturore. Hartimi i kalendarit të festave lokale 2024. Promovimi i kalendarit kombëtar të eventeve TEA

1. PJESËMARRJA NË AKTIVITETE TË NDRYSHME:

- 1- Puna në grup nga muaji shtator 2023 për “Inventarizimin dhe Arkivimin e dokumentacionit të Sektorit të Prokurimeve”, me urdhër Nr 329, datë 27.09.2023 e në vijim.
- 2- Puna në grup në komisionin e prokurimit të njoftimeve dhe kronikave televizive. Mbështetur në nenin 7, pika 5, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), V.K.M nr 1195, datë 05.08.2008, kreu II, pika 6: “ Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve, reklamave për transmetimin nga operatorët radioteleviziv ose botimin në median e shkruar dhe për kontratat për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore”.

- 3- Puna në grup me urdhër të brendshëm Nr 316, dt 20.09.2023. Për ngritjen e komisionit të prokurimit për procedurat e financimit të projekteve dhe veprimtarive artistike, kulturore e në vijim.
- 4- Puna për përgatitjen dhe pjesëmarrjen dinjtoze në panair. 31.01 – 1.02.2024. Panairi i Turizmit në Pallatin e Kongreseve "Tourism&Travel Show Albania".
- 5- Puna për përgatitjen dhe pjesëmarrjen dinjtoze në panair. 26 – 29.02.2024. Panairi i Turizmit në Bari (Itali).
- 6- Puna për përgatitjen dhe pjesëmarrjen dinjtoze në panair. 04 – 7.03.2024. Panairi i Turizmit në ITB Berlin (Gjermani).
- 7- Puna për përgatitjen dhe pjesëmarrjen dinjtoze në panair. 11 – 13.02.2024. Panairi i Turizmit në Prishtinë (Kosovë).
- 8- Pjesëmarrja në konferencën "THE FUTURE OF THE ADRIATIC PAST" Kotor, Mali i Zi, 13 Prill 2024.
- 9- Puna në grup për "Masat e Sezonit Turistik 2024". Urdhër nr 72, dt 20.03.2024.
- 10- Puna në grup për "Ngritjen e Komisionit të Asgjësimit" me Urdhër nr.403 datë 30.09.2024.
- 11- Puna në grup për "Kryerjen e Procesit të Përpunimit, Inventarizimit dhe Dorëzimit të Dokumenteve me Afat Ruajtje Përgjithmonë" me Urdhër nr.399 datë 26.09.2024.
- 12- Puna për përgatitjen e panairit dhe hapjen e Sezonit Turistik datë 10.05.2024 .
- 13- Kthim përgjigje për çdo shkresë dhe dokument të dërguar në drejtori, si nga emaili dhe nga protokolli.
- 14- 9-10-11 Maj 2024. Shkolla pranverore "Përmirësimi i shërbimeve në nivel lokal për të rinjtë dhe kontributi i tyre në komunitet". Prezantimi i zyrës me temën: Bashkëbisedim me të rinjtë për promovimin e Vlorës si qytet turistik. Pallati i Kulturës "Labëria".
- 15- Në datë 30 maj 2024, Kolegji Universitar Qiriazi, në bashkëpunim me partnerët e tij, organizoi një konferencë ndërkombëtare mbi turizmin dhe hotelerinë. Me këtë rast, u zhvillua një prezantim online.
- 16- Në datë 30 Maj 2024, ora 09:00- 15:30, te Vlora International Hotel, pjesëmarrja në trajnimin me temë "Higjiena kibernetike dhe praktikat më të mira të sigurisë". Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) në bashkëpunim me CRDF Global dhe me mbështetjen e Departamentit Amerikan të Shtetit, organizuan në Vlorë këtë trajnim.
- 17- Trajnimi i trajnerëve u zhvillua në Trieste (Itali) dhe në Piran (Slloveni) nga data 10 deri në 14 qershor 2024. Projekti TRUE BLUE, bashkëfinancuar nga OGS dhe Iniciativa e Evropës Qendrore - CEI, përmes Programit të Shkëmbimit të Njohurive (KEP), i cili është një instrument mbështetës i projekteve dhe programeve të fokusuara në transferimin e njohurive dhe praktikave më të mira nga Shtetet Anëtare të BE-së në CEI jo të BE-së. Ky projekt financohet me kontributin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Cooperazione Internazionale të Republikës Italiane.

- 18- Trajnimet nga ASPA QERSHOR 2024.
- 19- Përgatitja e materialeve për mbledhjen e Prefekturës (Përgatitja e dokumentacionit për të gjitha drejtoritë e bashkisë).
- 20- Pjesëmarrja dhe ndihmesa në organizimin e Show Veror në Orikum, 7 Gusht.
- 21- Pjesëmarrja dhe mbështetje logjistike në organizimin e koncertit nga DJ Steve Aoki në Lungomare, në datën 17 gusht 2024.
- 22- Pjesëmarrja dhe ndihmesa në organizimin e aktiviteteve dhe eventeve të tjera të Bashkisë Vlorë gjatë sezonit turistik veror 2024.
- 23- Përgatitja për materialet promovuese të qytetit dhe grumbullimi i të gjithë dokumentacionit të domosdoshëm, që do të shërbejë për të rinovuar faqen e Bashkisë, sektorin e turizmit.
- 24- Grumbullimi i të dhënave statistikore mbi numrin e turistëve, që kanë vizituar Bashkinë Vlorë gjatë gjithë vitit.
- 25- Pjesëmarrja në eventet e organizuara nga Bashkia Vlorë.
- 26- Mbledhja e materialeve informuese dhe promovuese së trashëgimisë kulturore, zonave të mbrojtura, muzeut Etnografik dhe Historik dhe muzeut të Pavarësisë në institucionet përkatës.
- 27- Përpunimi dhe redaktimi i informacionit të mbledhur.
- 28- Ndërtimi i bazës së të dhënave për të gjithë strukturat hoteliere në qytetin e Vlorës.
- 29- Mbledhja e statistikave për turistët vendas dhe të huaj nga Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore, Porti Vlorë, Agjensia e Zonave të Mbrojtura, Muzeu Kombëtar i Pavarësisë, Muzeu Historik Arkeologjik dhe Muzeu Etnografik.
- 30- Kontaktim me START-UP e qytetit të Vlorës për të aplikuar dhe përfituar financim nëpërmjet granteve dhe masave mbështetëse 2025 nga Ministria për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit.
- 31- Krijimi i librit promovues të turizmit "Vlora The City Planning The Future" për të zbuluar thesaret e Vlorës, monumentet, sitet më të rëndësishme arkeologjike, atraksionet turistike, zonat e mbrojtura dhe produktet tradicionale të Vlorës. Përkthimi i librit në gjuhën angleze.
- 32- Krijimi i fletëpalosjeve promovuese me pikat kryesore turistike dhe përkthimi në gjuhën angleze.
- 33- Përfshirja e produkteve tradicionale vendase dhe materialeve promovuese të vendosura në funksion të promovimit të qytetit të Vlorës.
- 34- Realizimi i relacioneve për festat e muajit Nëntorit 2024, realizmi i eventit në Athinë, Greqi në 17 Nëntor 2024, përgatitja e grupit të punës që do të jenë pjesëmarrës në eventin e Vienës.
- 35- Përpunimi i materialeve për infrastrukturën ndihmëse, ndërhyrjet konservuese dhe restauruese që propozohen për monumentet e trashëgimisë kulturore në qytetin e Vlorës.
- 36- Krijimi i bazës së të dhënave për mbledhjen e statistikave nga institucioni i Drejtorisë Rajonale së Trashëgimisë Kulturore, Agjensia e Zonave të Mbrojtura, Porti Vlorë, Muzeu Etnografik dhe Historik, Muzeu Kombëtar i Pavarësisë.
- 37- Hartimi i një plan buxheti për vitin 2025 mbi veprimtarinë e DZHET.
- 38- Realizimi i spotit publicitar në kuadër të festave të fundvitit për qytetin e Vlorës në bashkëpunim me bankën CREDINS.

Drejtoria e Projekteve të Huaja Integrit Evropian dhe Diasporës

Në përgjigje të shkresës me Nr. 635 Prot. datë 15.01.2025 me lëndë “Mbi analizën e punës për periudhën 01.01.2024-31.12.2024” ju raportojmë se Drejtorja e Projekteve të Huaja Integrit Evropian dhe Diasporës, bazuar në V.K.M-në Nr. 450, datë 16.07.2018 “Për Bashkërendimin dhe Koordinimin e procesit të Integrit Evropian ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore”, Vendimit Nr.53, datë 23.07.2021 Për një ndryshim në vendimin nr. 101, datë 11.09.2018 “Për miratimin e rregullores së organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të administratës së Bashkisë Vlorë” kryen në vijmësi detyrat si më poshtë vijon:

39-

40- Detyrat e drejtorisë gjatë kësaj periudhe kanë konsistuar në realizimin e aktiviteteve të projekteve në proces zbatimi, trajnimeve, aplikimeve, bashkaplikimeve dhe shprehjeve të interesit në partneritet me institucione ndërkombëtare si dhe në bashkërendim dhe koordinim me strukturat e bashkisë për përfshirjen sipas nevojave dhe thirrjeve të donatorëve dhe fondeve.

Projektet në zbatim:

1. **Projekti “ART4SEA”**- art për detin “ Melting Art, Creativity and Marine Sciences to foster Ocean Literacy in the Mediterranean area” nga programi Evropa Krijuese, financuar nga Bashkimi Evropian, është me një kohëzgjatje 36 muaj, me Lider 3D RESEARCH SRL, Itali dhe Bashkia Vlore si nje ndër shtatë partnerët e përfshirë.
2. **Projekti “Support towards employment and education members for the Roma and Egyptian minority in municipality of Vlora”**, mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, OSFA. Synimi i përgjithshëm i këtij projekti është integrimi i qëndrueshëm në tregun e punës të 14 anëtarëve të minoritetit Rom dhe Egjiptian dhe nxitja e frekuentimit të procesit arsimor duke ofruar mbështetje me bursa për 30 nxënës frekuentues të shkollave të arsimit 9-vjeçar në territorin e Bashkisë Vlorë
3. **Projekti WRECKS4ALL**- Programi i BE, IPA III CBC me titull “ Kapitalizimi duke transferuar në territore të reja modelin për mbrojtjen e trashëgimisë nënujore përmes dixhitalizimit dhe valorizimit të tij si një ofertë e re turistike” me lead partner Universitetin e Malit te zi.

Nëpërmjet sinergjisë së programit Interreg, projekti do të synojë: nxitjen dhe përmirësimin inovativ kulturor dhe turistik si një pikë e fortë drejt zhvillimit lokal drejtuar në përmirësimin ekonomik të zonave bregdetare.

Ky projekt do të zbatohet përgjatë vitit 2024 dhe Bashkia Vlorë përmes aktiviteteve të parashikuara si partnere, do të përfitojë nga rezultatet kryesore të WRECKS4ALL të tilla si plani i veprimit dhe qasje të re për aksesin publik në trashëgiminë kulturore nënujore.

4. Projekti CIRCUS- Programi INTERREG IPA-ADRION

Strategjitë e ekonomisë qarkulluese, planet e veprimit dhe zgjidhjet për tranzicionin e sistemeve agroushqimore në komunitetet bregdetare të zonës ADRIO (Circular economy Strategies, action plans, and Solutions for agrifood systems transition in ADRION coastal communities) Lead partner- Instituti Agronomik Mesdhetar Bari-Itali, Bashkia Vlore është partnere

5. **Projekti PREVENT- Programi INTERREG IPA** _Reduktimi i ndotjes dhe paralajmërimi i hershëm për ekosistemet vulnerabël në territoret Adriatik-Jon.

Projekti trajton sfidën e përbashkët të ndotjes detare në rajonin Adriatiko-Jonian. Kjo sfidë përkeqësohet nga ndryshimet klimatike dhe përbën një kërcënim të konsiderueshëm për rajonin, ekosistemet, komunitetet dhe ekonominë. Projekti synon të zhvillojë mjete inovative dhe metodat për zbulimin e hershëm, parandalimin dhe menaxhimin e mbeturinave detare.

6. Projekti Resilienza marxhinale – Hartimi i Planit për Vlerësimin e Potencialëve Territoriale të Qarkut Vlorë. Promovimi i politikave të orientuara drejt zhvillimit që mbështesin aktivitetet produktive, krijimin e vendeve të punës të denjë, sipërmarrjen, kreativitetin dhe inovacionin, dhe inkurajojnë formalizimin dhe rritjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, gjithashtu përmes aksesit në shërbimet financiare.

7. Projekti “Qendër Multifunksionale në Njësinë Administrative Shushicë në shërbim të të rinjve të komunitetit Rom dhe Egjiptian.

Qëllimi i projektit është të sigurojë një vend të përshtatshme social-kulturor-arsimor për fëmijë dhe të rinjtë e komunitetit Rom dhe Egjiptian dhe familjet në nevojë me parimin e gjithëpërfshirjes dhe luftës kundër diskriminimit, duke i ndihmuar në aksesin në shërbimet dixhitale.

Janar

- Urdhër pune në komisionin për vlerësimin e aplikimeve për “30 bursa shkollore të nxënësve nga Komuniteti Rom dhe Egjiptian”

Shkurt

- Trajnim me temë “Ngritje kapacitetesh mbi menaxhimin e fondeve IPA II dhe IPA III.
- Trajnim i organizuar nga ASPA dhe projekti “Bashkitë për në BE” me temë “Rregullat e procedurave të prokurimit dhe kushtet e kontratës”
- Trajnim i organizuar nga ASPA dhe projekti “Bashkitë për në BE” me temë “Rrugëtimi drejt një shkrimi të suksesshëm sipas ciklit PCM”
- Aplikime dhe shprehje interesi për partneritet me Bashkitë Greke në kuadër të programit “Interreg –IPA, CBC –Greece –Albania 2021-2027.

Mars

- Pjesëmarrje në sesion informues në kuadër të thirrjes së parë për projekt propozime për programin Interreg –Shqipëri 2021-2027 të organizuar nga SASPAC.
- Takim me temë “Gruaja, paqa dhe siguria “

Prill

- Takim informues nga shoqata “Internacionale për solidaritetin(SHIS) me titull “Promovimi i edukimit gjithëpërfshirës përmes edukimit të kombinuar për nxënësit Rom dhe Egjiptian “ në Bashkinë Vlorë.
- Takim online në kuadër të aktiviteteve aktuale dhe të planifikuara për objektivat specifike të subgranteve në kuadër të projektit në zbatim “Mbështetja me bursa dhe punësim për anëtarët e komunitetit Rom dhe Egjiptian.
- Pjesëmarrje në aktivitet për prezantimin e draft planit të përshtatjes klimaterike nga “UNDP”
- Vizitë në Kotor në kuadër të hapjes së projektit “WRECKS4ALL” në të cilën Bashkia është partnere.

Maj

Shkolla pranverore: Përmirësimi i shërbimeve në nivel lokal për të rinjtë dhe kontributi i tyre në Komunitet me shkollat e mesme të qytetit në kuadër të javës Evropiane 9,10,11 Maj.

Qershor

Takim informues në kuadër të thirrjes për projekt propozime, për projekte standarte me qëllim që parterët të njihen me kushtet dhe afatet e aplikimit ,fushat specifike dhe buxhetet sipas pjesëmaries së partnerëve, në kuadër të këtij programi 10 Qershor 2024

Pjesëmarrje në aktivitet me temë: tryezë konsultative e Bashkive për çështjet e Diasporës dhe Migracionit të organizuar në 26.06.2024 Vlorë.

Pjesëmarrje e Albana Naçi si koodinatore e Konsultimit Publik në konferencën për të drejtën e informimit të organizuar në Tiranë në datën 26.06.2024.

Korrik

Pjesëmarrje në tryezën e parë të rumbullakët Ndër-Institucionale për arsimin gjithpërfshirës 9 Korrik 2024.

Pjesëmarrje në seminarin e parë për programin e punëve publike në komunitet 11 korrik 2024

Aktivitet në kuadër të projektit “Wreck for all” Lece Itali, 17-19 korrik 2024

Gusht

Pjesëmarrje në trajnimin “Më shumë mundësi arsimimi dhe punësimi për anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian në Bashkinë Vlorë”

Shtator

Pjesëmarrje në sesionin informues - skema e granteve -BE për përfshirjen në Tregun e Punës

Pjesëmarrje në takimin e projektit Art4Sea në Ustica, Palermo 20-24 shtator 2024

Pjesëmarrje në trajnimin “Struktura e Integritimit Evropian, komunikimi dhe roli në procesin vendor, Tiranë në datat 25-26-27 shtator 2024

Tetor

Trajnim me temë “Roli i bashkive në procesin e Integritimit Evropian në Tiranë në 25 tetor.

Raportim Sekretariatit të Integritimit Evropian pranë Kryeministrit të pyetësorit gjysëm i strukturuar për kapacitetet e Integritimit Evropian në qeverisjen vendore në datën 11.

Nëntor

Sesion trajnues për thirrjen nën Horizon Europe në datën 11.

Trajnim në 19 me titull “Konferenca Kombëtare ,transparenca dhe përgjegjësia në nivel vendor në Tiranë.

Trajnimi i udhezimit nr 10 datë 12.07.2024 të Ministrisë së Financës në 20 nëntor

Trajnim në 21 me teme”Bashkitë në rrugëtimin e shqipërisë drejt integritimit në BE”

Dhjetor

Konferenca në kuadër të projektit Week4all “Capitalizacion by transferring to new territories the wrecks4alln model for the protection of underwater haritage throught its digitalization and valorization as a novel touristic offer” në datën 6 dhjetor

Trajnim në kuadër të projektit “Bashki të Forta”me temë”Burime Njerëzore dhe Integritimit Evropian”.

Aplikime të bëra nga drejtorja dhe shkrim projekti.

-Asistencë në bashkëaplikim me mbështetjen e fondeve të BE dhe SOROS –Punësimi dhe arsimi i romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri.

-Përgatitje për aplikim në kuadër të Programit CERV –Town twinning me fonde të BE me qëllim krijimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të eksperincave kulturore e turistike me Bashkinë e Xylokastros në Greqi dhe Aplikim në këtë thirrje.

- Shprehje intersi për partneritet në kuadër të thirrjes IPA Cross Border bashkive të Greqisë

- Shprehje intersi për partneritet dhe asistencë në kuadër të thirrjes Adrion.
- Përgatitje për aplikim në kuadër të thirrjes për grante për shërbime shoqërore me bazë komunitare nga AKR
- Shkrim projekti në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimit Social për fondin social të zhvillimit për krijimin e një qendre ditore për të moshuarit.

Detyra të tjera sipas Urdhrave të Brendshëm:

1.Zbatimi i detyrave të përcaktuara në Urdhrin e Brendshëm me nr. 81-datë 03.04.2024 “Për krijimin e komisionit të Bashkisë Vlorë për marrjen në dorëzim të dosjeve të Drejtorisë së Aseteve nga znj. Sonela Haxhiraj” dhe Inventarizimi e dorëzimi i tyre të z. Dorian Demiri. Anëtare e komisionit Daniva Jaupaj.

2.Zbatimi i detyrave të përcaktuara në Urdhrin e Brendshëm me nr.473 datë 26.12.2023 “Mbi ngritjen e grupit të punës për inventarizimin dhe arkivimin e dokumentacionit të sektorit të prokurimeve”. Anëtare e Komisionit Albana Naçi, Daniva Jaupaj.

3.Zbatimi i detyrave të përcaktuara në Urdhrin e Brendshëm nr 218 datë 14.06.2024”Mbi krijimin e grupit të punës për zbatimin e rishikimit të programit të transparencës të Bashkisë Vlorë”. Pjesë e këtij grupi Albana Naci si Koordinatore e Konsultimit Publik.

4.Zbatimi i detyrave të përcaktuara në Urdhrin e Brendshëm nr 200 datë 06.06.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit të Integritetit. Pjesë e këtij grupi Albana Naci si Koordinatore e Konsultimit Publik.

5- Platforma bashkëqeverisjes. Pika e kontaktit të Bashkisë Vlorë në kuadër të platformës së Bashkëqeverisjes në Kryeministri lidhur me trajtimin e ankes/kërkesave të cilat regjistrohen në portalin e Bashkëqeverisjes. Pika e kontaktit të Bashkisë Vlorë Daniva Jaupaj.

Matrica (Raporti i vlerësimit të performancës.

Me iniciativë të Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendor, AMVV në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, bën procesin e përvitshëm të vlerësimit të ecurisë së bashkive në drejtim të përmbushjes të detyrimeve në kuadër të kriterëve politike, ekonomike dhe standardeve që lidhen me integrimin evropian duke hartuar raportin vjetor “Bashkitë në Procesin e Integritetit Evropian të Shqipërisë”. AMVV-ja gjithashtu harton raportin e zbatimit të projekteve të financuara nga donatorët dhe të zbatuara nga bashkitë, i cili synon të prezantojë kapacitetet e bashkive në drejtim të aksesit të financimeve të huaja dhe të ofrojë transparencën lidhur me financimet e huaja në nivelin vendor. Këtë vit procesit të përthithjes së fondeve ju

- Shprehje intersi për partneritet dhe asistencë në kuadër të thirrjes Adrion.
- Përgatitje për aplikim në kuadër të thirrjes për grante për shërbime shoqërore me bazë komunitare nga AKR
- Shkrim projekti në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimit Social për fondin social të zhvillimit për krijimin e një qendre ditore për të moshuarit.

Detyra të tjera sipas Urdhrave të Brendshëm:

1.Zbatimi i detyrave të përcaktuara në Urdhrin e Brendshëm me nr. 81-datë 03.04.2024 “Për krijimin e komisionit të Bashkisë Vlorë për marrjen në dorëzim të dosjeve të Drejtorisë së Aseteve nga znj. Sonela Haxhiraj” dhe Inventarizimi e dorëzimi i tyre të z. Dorian Demiri. Anëtare e komisionit Daniva Jaupaj.

2.Zbatimi i detyrave të përcaktuara në Urdhrin e Brendshëm me nr.473 datë 26.12.2023 “Mbi ngritjen e grupit të punës për inventarizimin dhe arkivimin e dokumentacionit të sektorit të prokurimeve”. Anëtare e Komisionit Albana Naçi, Daniva Jaupaj.

3.Zbatimi i detyrave të përcaktuara në Urdhrin e Brendshëm nr 218 datë 14.06.2024”Mbi krijimin e grupit të punës për zbatimin e rishikimit të programit të transparencës të Bashkisë Vlorë”. Pjesë e këtij grupi Albana Naci si Koordinatore e Konsultimit Publik.

4.Zbatimi i detyrave të përcaktuara në Urdhrin e Brendshëm nr 200 datë 06.06.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit të Integritetit. Pjesë e këtij grupi Albana Naci si Koordinatore e Konsultimit Publik.

5- Platforma bashkëqeverisjes. Pika e kontaktit të Bashkisë Vlorë në kuadër të platformës së Bashkëqeverisjes në Kryeministri lidhur me trajtimin e ankes/kërkesave të cilat rregjistrohen në portalin e Bashkëqeverisjes. Pika e kontaktit të Bashkisë Vlorë Daniva Jaupaj.

Matrica (Raporti i vlerësimit të performancës.

Me iniciativë të Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendor, AMVV në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, bën procesin e përvitshëm të vlerësimit të ecurisë së bashkive në drejtim të përmbushjes të detyrimeve në kuadër të kriterëve politike, ekonomike dhe standardeve që lidhen me integrimin evropian duke hartuar raportin vjetor “Bashkitë në Procesin e Integritetit Evropian të Shqipërisë”. AMVV-ja gjithashtu harton raportin e zbatimit të projekteve të financuara nga donatorët dhe të zbatuara nga bashkitë, i cili synon të prezantojë kapacitetet e bashkive në drejtim të aksesit të financimeve të huaja dhe të ofrojë transparencën lidhur me financimet e huaja në nivelin vendor. Këtë vit procesit të përthithjes së fondeve ju

shtuan dhe aplikimit të bashkive në kuadër të thirrjeve të shpallura nga ministritë dhe agjensitë qendrore. Hedhja e të dhënave u krye on-line nga Drejtoria e Integritit Evropian nga informacioni i mbledhur nga drejtoritë nëpërmjet sistemit që Agjensia menaxhon me mbështetjen e Projektit “Bashkitë për në Evropë” të financuar nga Bashkimi Evropian.

KRYETAR

Ermal Dredha

